



*“Me të vërtetë, ky Kur'an udhëzon kah ajo  
që është më e drejtë “*  
*(Kur'an:17:9)*

*Rashit Zylfiu*

---

*Ajka e kuptimit  
të dhjetë sureve  
të fundit të Kur'anit*

*Titulli:*

“Ajka e kuptimit të dhjetë sureve të fundit të Kur'anit”

*Autori:*

Rashit Zylfiu

*Recensent:*

Sabri Bajgora

*Redaktor fetar:*

Alaudin Abasi

*Korrektor letrar:*

Arjan Koçi

*Radhitja kompjuterike:*

Avni G. Gashi

*Ballina:*

Dorlir Kraja

*Boton:*

KBI-Gjilan

*Adresa:*

Zija Shemsiu 118,60000, Gjilan

*Tirazhi:*

1000 copë

*Botimi i parë:*

Ramazan 1436/Korrik 2015

*Të gjitha të drejtat të rezervuara për autorin.*

*Info: [rashitzylfiu@gmail.com](mailto:rashitzylfiu@gmail.com)*

### *Përkushtim*

*Këtë libër ia kushtoj mësuesit të abetares, hoxhallarëve që më ndihmuan rrugës për nxënien e diturisë, profesorëve të mi, këshillat dhe udhëzimet e të cilëve ishin fanar për jetën time, prindërve dhe familjes sime, përkrahja e të cilëve nuk më mungoi, që të punoj për rrugën e paqes, Islamin.*

*Allahu ua shpërbleftë me të mirat e Tij!*

*El Imad Esbehanij thotë: “Kam parë se nuk ka njeri që shkruan diçka gjatë ditës, veçse të nesërmen do të thotë sikur kjo të ndryshohej do të ishte më mirë, sikur të shtohej kjo do të bëhej më mirë, sikur kjo të shkruhej në rreshtat e parë do të ishte më e vlefshme, sikur kjo të lihej do të ishte më bukur. Kjo është nga mësimet më madhështore dhe faktet se mangësia dominon të gjitha qeniet njerëzore.”*

## FJALA E RECENSENTIT

Kur'ani Famëlartë është ndër librat më të lexuar e të komentuar në historinë e njerëzimit. Ky nderim dhe lartësim i tij vjen për faktin se është Fjala e Allahut, së cilës nuk mund t'i mvishet e pavërteta as nga para e as nga prapa. Duke analizuar tekstin dhe përmbajtjen e Kur'anit, shohim në të një forcë magjepsëse, nga e cila rrezaton përherë dritë, që ndriçon mendjet dhe shpirtrat tanë. Ky libër i shenjtë për besimtarët paraqet vizionin e së ardhmes së tyre, ndërkohë që edhe jomuslimanët mbeten të mahnitur nga madhështia e fjalëve të tij sepse edhe ata duke hulumtuar në sekretet dhe urtësitë e tij arrijnë të kapin dimensionet e kësaj urtësie.

Kur'ani nuk është thjesht vetëm një libër lutjeje e adhurimi, por është edhe libër i cili na nxit për meditim të thellë. Ai si një udhërrëfyes drejt së vërtetës ka këto synime kryesore: të argumentojë dhe demonstrojë ekzistencën dhe njëshmërinë e Allahut, të argumentojë vërtetësinë e misionit të të Dërguarve të Allahut dhe të argumentojë e vërtetojë ringjalljen dhe jetën e përhershme në botën tjetër. Kur të jenë realizuar këto synime sublime, atëherë rruga drejt adhurimit të drejtë të Allahut do të jetë trasuar në formën më të mirë të mundshme.

I Lartmadhërishtë është betuar në Kur'anin Fisnik duke e cilësuar atë si libër plot me urtësi, sepse

urtësia është e vërteta dhe esenca e tij. Kur'anit me urtësinë e tij shpeshherë i drejtohet mendjes dhe zemrës sonë, duke na vënë në dijeni për misionin që kemi në këtë jetë. E, ky mision i shenjtë na obligon që të përhapim gjithandej urtësitë e tij. Pikërisht, duke u nisur nga këto parime fisnike, shumë prej dijetarëve muslimanë nëpër shekuj i janë qasur komentimit të Kur'anit për të përafuar sa më shumë tek njerëzit kuptimet dhe domethëniet e tij. Edhe populli shqiptar pati në gjirin e tij dijetarë të kalibrit botëror, të cilët me komentimin e tyre përjetësuan deri në amshim emrat e tyre në këtë aureolë të nderit e fisnikërisë. Të tillë ishin Hfz. Ibrahim Dalli, Hafiz Ali Korça e shumë të tjerë. Megjithatë, copëtimi i trojeve shqiptare nga ana e okupatorëve sllavo-grek ndali ritmin e përparimit dhe zhvillimit të shkencave islame ndër shqiptarët, e ndër to edhe të tefsirit. Por ja, fatmirësisht, decenieve të fundit, pothuajse në të gjitha trojet tona etnike, sidomos në Kosovë, ka filluar një rilindje e vërtetë e këtyre shkencave kur'anore. Vitet e fundit janë botuar disa dhjetëra libra në lëmin e tefsirit apo të komentimit të sureve të caktuara kur'anore, andaj edhe ky libër, të cilin lexuesit tanë do ta kenë në duar gjatë këtij muaji të bekuar të Ramazanit, është një përpjekje e tillë shpresëdhënëse se drita e Librit të Allahut ka filluar të përhapet gjithandej në mesin e besimtarëve tanë. Shqiptarët dalëngadalë po rikthehen aty ku edhe në fakt e

kanë vendin, në mesin e ajkës botërore të dijetarëve muslimanë, aty ku bashkëkombësit tanë kanë lënë emër të pashlyeshëm në shkencat islame, sidomos në atë të hadithit, siç janë Shejh Abdulkadër Arnauti, Shejh Nasruddin Albani dhe Shejh Shuajb Arnauti, i cili akoma vazhdon të na nderojë me punën dhe emrin e tij.

Unë e përgëzoj nga zemra autorin e këtij libri, Rashit ef. Zylfiun, i cili na ka ofruar vërtetë Ajkën e dhjetë sureve të fundit të radhitura në mus'haf, sure që siç e ka cekur edhe ai, na janë mbjellë në mendje e në zemra që nga fëmijëria. Nga perspektiva kohore, dëshiroj ta inkurajoj ef. Rashitin që të mos ndalet vetëm me këtë projekt modest, por të vazhdojë që edhe në të ardhmen të na freskojë me puhiza të tilla të flladit kur'anor sepse komentimi i Kur'anit Famëlartë i ngjan një oqeani të thellë, ku secili e ka hisen e vet pa i munguar asgjë tjetrit në hisen e tij.

Allahu na mundësoftë që të jemi në shërbim të sinqertë të Fjalës së Tij, vetëm tek Ai shpresojmë mëshirën dhe vetëm Atij ia atribuojmë çdo sukses tonin.

*Sabri Bajgora*

*Kryeimam i Kosovës*

*Prishtinë, 13 qershor 2015*

## HYRJE

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të zgjedhurin e Pejgamberëve, Profetin tonë Muhamed, mbi familjen dhe mbi shokët e tij.

Kur'ani është fjala e Allahut të Madhëruar.

إِنَّهُ لَقُرْآنٌ كَرِيمٌ

*“Ky është vërtet një Kur'an i nderuar<sup>1</sup>.”*

Në komentimin e ajetit Ibn Sadi thotë: “Shumë i dobishëm, pasi çdo e mirë dhe dituri përfitohet nga libri i Allahut<sup>2</sup>.”

Kur'ani është shpallur nga Krijuesi i botëve, urtia e tij shihet në përmbajtjen e dispozitave, urdhëresave, ndalesave dhe rrëfimet. Kuptimet e tij janë shumë të gjera, frytdhënëse, ai përmbledh diturinë e të parëve dhe të të fundmëve. Është përkujtues për njerëzit për atë që u bën dobi në jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër. Kur ndalemi dhe shohim gjendjen e muslimanëve sot pa dallim në raport me librin e Allahut, si në mësim-leximin, memorizimin, meditimin, të

---

<sup>1</sup> Kur'an, Uakija: 77.

<sup>2</sup> Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan, f. 776.



vepruarit, të gjykuarit dhe shërimit me të, do të shohim se ata dhe Kur'ani janë larg njëri-tjetrit, edhe pse për këtë gjendje të hidhur Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) iu ankua Allahut për umetin e tij.

وَقَالَ الرَّسُولُ يَا رَبِّ إِنَّ قَوْمِي اتَّخَذُوا هَذَا الْقُرْآنَ مَهْجُورًا

***“Dhe i Dërguari do të thotë: “O Zoti im! Populli im e shpërfilli Kur'anin, si (diçka) të urryer...<sup>3</sup>”***

Ky qe edhe motivi kryesor për botimin e këtij studimi modest, “Ajka e kuptimit të dhjetë sureve të fundit të Kur'anit”, duke i ofruar lexuesit komentimin e këtyre sureve, të cilat janë nga të parat që mëson çdo musliman në fëmijërinë e tij, mbajnë në vetvete kujtime të veçanta dhe lexohen thuajse në çdo kohë namazi.

Lexuesi në këtë libër do të hasë atë që është thelbësore, e cila ngjall kureshtjen e tij për të ditur më shumë rreth këtyre sureve: emrin, shkakun e zbritjes, kuptimin e ajeteve- që është zemra e studimit dhe ajo që ne duhet të marrim- mësimet dhe mesazhet nga këto kaptina kur'anore.

Punimi në fjalë është një përmbledhje e brendësisë së mbi pesëmbëdhjetë librave të tefsirit. Jemi munduar t'i sjellim lexuesit tematikën dhe analizën e këtyre

---

<sup>3</sup> Kur'an, Furkan: 30.

kaptinave që ta ketë më të lehtë për të krijuar një kuptim më të qartë për atë që përcjellin këto kaptina dhe që më pas ta ketë më të lehtë që edhe gjatë namazit të jetë më i përkushtuar.

Allahu është Ai që ka mundësi ta ngjallë tokën pas shiut dhe ka mundësi gjithashtu t'i ngjallë zemrat me Kur'an.

Lus të madhin Allah që ta pranojë këtë vepër, të na bëjë prej atyre të cilët në jetën e kësaj bote thonë të vërtetën dhe e pasojnë atë dhe që ky libër të jetë fanar për çdo lexues e t'ia ndriçojë zemrën, që ta shohë të vërtetën dhe ta pasojë atë.

Lexim të mbarë!

## KOMENTIMI I “EL-ISTIADHETU” DHE “BESMELE-S”

أَعُوذُ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

*Kërkoj mbështetje tek Allahu nga djalli i mallkuar!*

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

Ky tekst nëpërmjet të cilit njeriu kërkon ndihmën e Allahut për t’u mbrojtur nga shejtani i mallkuar vesveset, cytjet dhe hutimi që vjen prej tij quhet “el-istiadhetu”.

### Sqarimi i fjalëve

Eudhu<sup>4</sup>: Fjala e parë e përdorur në këtë tekst është “eudhu”, që rrjedh nga folja “avdhe”, e cila në aspektin gjuhësor do të thotë vrapon, drejtohet drejt dikujt ose diçkaje, kundër dikujt apo diçkaje, thërret, kërkon ndihmë nga dikush kundër dikujt, kërkon ndihmë, mbrojtje, strehim<sup>5</sup> etj..

---

<sup>4</sup>Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i istiadhes, el-besmele dhe i suretu-l-Fatihase".

<sup>5</sup>Sylejman Tomçini, Fjalori Arabisht-Shqip, fq. 636.

Allah<sup>6</sup>: Emri Allah është emri më kulmor dhe më i madh i Allahut. Emri i Krijuesit të gjithësisë, askush nuk është emërtuar me të në këtë botë.

Për këtë sinjalizon Kur'ani i Madhëruar<sup>7</sup>:

هَلْ تَعْلَمُ لَهُ سَمِيًّا

***“A njeh ti ndokënd që ka emrin e Tij<sup>8</sup>?!”***

“Allah”, Krijuesi, i Plotfuqishmi, i Gjithëdijshmi për çdo gjë. Zoti i të parëve dhe të fundmëve<sup>9</sup>.

Ky është emri bazë. Të gjithë emrat e tjerë vijnë si pasues të tij<sup>10</sup>.

Meqenëse deri më tani askush nuk është emërtuar me këtë emër të Zotit të Madhërishëm, konform citatit të mësipërm, atëherë në bazë të këtij citati faktik emri Allah nuk mund të fitojë as dysinë<sup>11</sup> as shumësin. Ky emër kulmor shërben si bazë dhe pikëmbështetje e të gjitha atributeve të tjera të Tij.

Allahu, si i tillë, është i vetmi dhe absoluti që i meriton të gjitha adhurimet, lëvdatat dhe falënderimet që njeriu duhet t’ia shprehë Atij<sup>12</sup>.

---

<sup>6</sup> Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i istiadhes, el-besmeles dhe i suretu-l-Fatihase", f. 13.

<sup>7</sup> Po aty.

<sup>8</sup> Kur'an, Merjem: 65.

<sup>9</sup> Xhezairi, "Ejser Tefasir", vëll. I, fq. 10.

<sup>10</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi amme", fq. 10.

<sup>11</sup> Në gramatikën e gjuhës arabe krahas numrit njëjës dhe shumës të emrave, kemi edhe dysinë.

<sup>12</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an". vëll. I, fq. 102.

Emri “Allah” është me prejardhje arabe. Allahun e kanë pranuar si krijues absolut dhe të vetëm të mbarë ekzistencës edhe idhujtarët arabë me gjithë besimin e tyre në shumë zota të tjerë. Këtë qëndrim të tillë të tyre e përshkruan edhe Kur'ani i Madhërisëm.

وَلَيْن سَأَلْتَهُمْ مَنْ خَلَقَ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ وَسَخَّرَ الشَّمْسَ وَالْقَمَرَ  
لَيَقُولُنَّ اللَّهُ ۗ فَأَنَّى يُؤْفَكُونَ

*“Nëse ti (Muhamed) i pyet ata se kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe kush i ka nënshtruar (të rrotullohen) Diellin e Hënën, me siguri që ata do të të thonë “Allahu!” Atëherë, si po largohen (nga rruga e drejtë)?<sup>13</sup>”*

Emri Allah është emër i përveçëm, i dedikuar ekskluzivisht vetëm për Të. Ai nuk rrjedh prej ndonjë fjale tjetër. Këtë mendim e preferojnë dhe e mbrojnë një numër i madh dijetarësh. Dijetarët muslimanë mbajnë qëndrim unanimit se dëshmia islame: “S’ka të adhuroar me të drejtë pos Allahut” realizon teuhidin e pastër të Allahut vetëm nëpërmjet këtij emërtimi të Tij kulmor.

Shejtani<sup>14</sup>: Fjala vijuese “esh-shejtan” e përdorur në istiadhe është emër që i dedikohet Iblisit, armikut të Allahut dhe të njeriut. Fjala “esh-shejtan”, shumësi “shejatin”, rrjedh nga folja “shetane”, që do të thotë

<sup>13</sup> Kur'an, Ankebut: 61.

<sup>14</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”.vëll. I, fq. 45. Emin Bahrami, “Përktimi dhe komentimi i istiadhes, el-besmeles dhe i suretu-l-Fatihase”, f.13.

ai që është shmangur dhe larguar nga rruga e drejtë, pa marrë parasysh a është njeri apo xhind. Disa kanë thënë se kjo fjalë rrjedh prej foljes “shata”, djegie dhe shkatërrim, sepse shejtani është krijuar prej zjarri. Megjithatë disa të tjerë kanë thënë se dy versionet janë të sakta në kuptim, por i pari është më i saktë. Sibevejhi, njëri nga gjuhëtarët më të shquar arabë, thotë: “Arabët thonë ‘teshejtane fulan’ (është bërë shejtan filani) kur bën veprimesh djallëzore. Nisur nga kjo, secili që rebelohet nga xhindët, njerëzit, kafshët quhet shejtan.

Shejtani është quajtur “shejtanen” për shkak të largësisë së tij nga e vërteta dhe rebelimit të tij. Arabët e quajnë edhe litarin ‘shtene’ për shkak të gjatësisë dhe largësisë së dy anëve që ka. Thuhet “b’iru shatun”, pus i thellë.<sup>15</sup>

Çdo njeri ka të autorizuar djallin e tij nga njerëzit apo xhindët. Këta na e argumentojnë Kur'ani dhe Suneti.

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا شَيَاطِينَ الْإِنْسِ وَالْجِنِّ يُوحِي بَعْضُهُمْ  
إِلَىٰ بَعْضٍ زُخْرُفَ الْقَوْلِ غُرُورًا ۗ وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ مَا فَعَلُوهُ ۗ فَذَرْهُمْ  
وَمَا يَفْتَرُونَ

***“Kështu, çdo Profeti Ne i kemi caktuar armiq  
djajtë e njerëzve dhe të xhindëve, të cilët e frymë-  
zojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe të zbukuruara për***

---

<sup>15</sup> Emin Bahrami, "Përkhimi dhe komentimi i istiadhes, el-besmeles dhe i suretu-l-Fatihasë".

*mashtim. Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënin kështu, prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre.*<sup>16</sup>”

Në një hadith autentik theksohet: "Çdonjëri nga ju e ka shoqëruesin e tij (nga shejtanët)". Disa e pyetën: "Edhe ti, o i Dërguari i Allahut?" Tha: "Po, edhe unë e kam shoqëruesin e tillë, por Allahu më ndihmoi ta mund dhe kaloi në Islam. Ai më urdhëron vetëm për mirë."<sup>17</sup>

Ibn Xheriri transmeton se Omeri ibn Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, hipi mbi një pelë, e cila filloi të ecte me krekosje. Sa më shumë e godiste ai, aq më shumë e shtonte pela krekosjen. Omeri zbriti dhe tha: "Më keni hipur mbi një shejtan, nuk zbrita derisa m'u duk vetja ndryshe." Zinxhiri i transmetuesve është i saktë<sup>18</sup>.

Arabët me emrin shejtan emërtojnë gjarprin për shkak të pamjes së tij të trishtueshme. Po me këtë ata emërtojnë edhe frutat dhe pemët e pakëndshme.

Si për ilustrim të kësaj vlen ta përmendim ajetin kur'anor.

إِنَّهَا شَجَرَةٌ تَخْرُجُ فِي أَصْلِ الْجَحِيمِ (٦٤) طَلْعَهَا كَأَنَّهُ رُءُوسُ الشَّيَاطِينِ

*"Njëmend, kjo pemë del nga fundi i zjarrit flakërues dhe frutat e saj janë si kokat e djajve."*<sup>19</sup>

<sup>16</sup> Kur'an, En'Amë: 112.

<sup>17</sup> Muslimi, vëll. IV, fq. 2167.

<sup>18</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an". vëll. I, fq. 111.

<sup>19</sup> Kur'ani, Safat: 64-65.

Raxhim<sup>20</sup>: Fjala “raxhim” rrjedh nga fjala arabe “rexheme”, gjuajtje me gurë, mallkim, sharje, dëbim, i larguar nga çdo e mirë, etj.

Allahu në Kur'an thotë:

قَالُوا لَئِن لَّمْ تَنْتَهَ يَا نُوحُ لَتَكُونَنَّ مِنَ الْمَرْجُومِينَ

*“Ata thanë: “Nëse nuk tërhiqesh nga këto, o Nuh, me siguri, do të gurëzohesh.”<sup>21</sup>”*

قَالَ أَرَأَيْبُ أَنْتَ عَنِ الْهَيْتِي يَا إِبْرَاهِيمُ لَئِن لَّمْ تَنْتَهَ  
لَأَرْجُمَنَّكَ ۖ وَاهْجُرْنِي مَلِيًّا

*“Ai u përgjigj: “O Ibrahim! Si guxon t'i hedhësh poshtë zotat e mi?! Nëse nuk heq dorë, unë do të të mbys me gurë; andaj, largohu prej meje për një kohë të gjatë!”<sup>22</sup>”*

Këtë fjalë Kur'ani i Madhërisëm nganjëherë e përdor edhe në kuptim të të folurit me hamendje, siç është rasti i ajetit:

رَجْمًا بِالْغَيْبِ

*“... duke hamendësuar për atë që është e fshehtë...”<sup>23</sup>”*

## Kuptimi i istiadhes

Kërkoj ndihmë, mbështetje, mbrojtje, strehim tek Allahu nga djalli i mallkuar, i cili mbjell hutim dhe

<sup>20</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”. vëll. I, fq. 45. Emin Bahrami, “Përktimi dhe komentimi i istiadhes, el-besmeles dhe i suretu-l-Fatihase”,

<sup>21</sup> Kur'an, Esh-Shuara: 116.

<sup>22</sup> Kur'an, Merjem: 46.

<sup>23</sup> Kur'an, Kahf: 22.



dyshime! Istiadhja është strehim tek Allahu dhe kërkim i mbrojtjes nga Ai prej të këqijave të çdo keqbehëresi. Kërkimi i mbrojtjes bëhet për ta larguar të keqen, kurse strehimi është për të kërkuar të mira<sup>24</sup>.

## Përmendja e istiadhes në Kur'an

Istiadhja është përmendur në këto sure të Kur'anit:

وَأِمَّا يَنْزَغَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ إِنَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ

*“Nëse djalli përpiket të të shtyjë drejt së keqes, kërko strehim tek Allahu, se vërtet, Ai dëgjon dhe di gjithçka.”<sup>25</sup>*

فَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ مِنَ الشَّيْطَانِ الرَّجِيمِ

*“Kur dëshiron të lexosh Kur'anin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër djallit të mallkuar...”<sup>26</sup>*

وَأِمَّا يَنْزَغَنَّكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ  
إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

*“Nëse djalli fillon të të joshë, kërko mbështetje te Allahu. Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha.”<sup>27</sup>*

<sup>24</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, vëll. I, fq. 45.

<sup>25</sup> Kur'an, Araf: 200.

<sup>26</sup> Kur'an, Nahl: 98.

<sup>27</sup> Kur'an, Fusilet: 36.

إِنَّ الَّذِينَ يُجَادِلُونَ فِي آيَاتِ اللَّهِ بِغَيْرِ سُلْطَانٍ أَتَاهُمْ ۖ إِنَّ فِي صُدُورِهِمْ إِلَّا كِبْرٌ مَّا هُمْ بِبَالِغِيهِ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ ۗ إِنَّهُ هُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ

*“Ata që polemizojnë për shpalljet e Allahut, pa pasur kurrfarë prove, kanë në zemrat e tyre vetëm mendjemadhësi, e cila nuk do t’i shpjerë në qëllimin e tyre. Prandaj kërko mbrojtje prej Allahut! Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”<sup>28</sup>”*

Mësim<sup>29</sup>

Dispozita e istiadhes<sup>30</sup>

---

<sup>28</sup> Kur'an, Gafir: 56.

<sup>29</sup> Sherif ef Ahmeti, “Kur’ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe”; Prof. Hasan I. Nahi “Kur’ani i madhërisëm”, (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur’an El-adhim”; El-Kurtubi, “El-Xhami Liahkam El-Kur’an”; Taberij, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur’an”; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, “Tefsiru El-Xhelalejn”; Imam El-Bagauij, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanijij, “Fethu El-Kadir”; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, “Ed’uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur’an bi El-Kur’an”; Nasir Es-Sadij, “Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan”; Salih El-Uthejmin, “Tefsir El-Kur’an El-Kerim Xhuzi Amme”; Muhamed Sulejman El-Eshkar, “El-Kur’ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir”; Ebij Bekër El-Xhezairij, “Ejser Et-Tefasir Likelam el-Alij El-Kebir”; Uehbe Ezuhejli, “Et-Tefsir El-Munir”; Dr. Aid El-Karni, “Et-Tefsir El-Mujeser”; El Vahidij, “Esbabul En-Nuzul”; Muhamed El-Gazali, “Komenti tematik i Kur’anit Famëlartë”; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, “Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur’an El-Adhim”; Seid Kurtb, “Fi Dhilali-l Kur’an”; Ebij El-Izi Eddimeshkij, “Sherh Akide Et-Tahaujje”; Shejh Islam ibn Tejmije, “Ubudije”; Ibn Kajim El-Xhevzijekh, “Zadul Mead”; Ibn Kajim El-Xhevzijekh, “Feuaid”; Emin Bahrami, “Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase”.

<sup>30</sup> Leximi i istiadhes para këndimit të Kur’anit jashtë namazit është sunet. Kështu mendon shumica absolute e dijetarëve muslimanë, të cilët kanë parë se Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk ka ngulur këmbë që ajo të lexohet në mënyrë sistematike para këndimit të Kur’anit të Madhërisëm. Për këtë arsye, ata ofrojnë argumente të shumta. Këtë traditë të Muhamedit (paqja dhe

Shumica e dijetarëve janë të mendimit se istiadhja nuk është pjesë e Kur'anit, por e shohin si të pëlqyeshme që të fillohet me të leximi i Kur'anit duke u bazuar në fjalën e Allahut: “Kur dëshiron të lexosh Kur'anin, kërko mbrojtjen e Allahut kundër djallit të mallkuar”<sup>31</sup>, që ka kuptimin se nëse do të lexosh Kur'an, kërko mbrojtje tek Allahu nga djalli i mallkuar.

### Prej dobive të istiadhes

- Nevoja jonë për Allahun e Madhëruar.
- Vërtetimi i varfërisë së plotë të njeriut karshi madhërisë së Allahut.
- Vërtetimi i fuqisë së Allahut për të sjellë të dobishmen dhe larguar të dëmshmen.
- Konfirmimi se djalli është armik i përбетuar i njeriut.

---

bekimet e Allahut qofshin mbi të) pastaj e kanë vazhduar edhe shumë sahabë dhe tabi'inë. Nëse Kur'anin e lexojnë për një kohë një grup njerëzish kaptinë pas kaptinë dhe pandërprerë, në raste të tilla mjafton që istiadhen me zë ta lexojë vetëm i pari prej tyre, ndërsa të tjerët në vazhdim e lexojnë fshehurazi.

Ebu Lejth es-Sarmakandi ka përcjellë nga disa komentatorë të Kur'anit se istiadhja është farz (obligative)dhe nëse e harron duke lexuar Kur'an, fillon nga fillimi, kurse disa të tjerë kanë thënë se fillon nga vendi ku e ke ndërprerë.

Dijetarët kanë rënë në mospajtime për leximin e saj në namaz, se a është obligim apo jo. Nukashi përcjell nga A'tau se istiadhja në namaz është obligim. Ibn Sirijni dhe Nehaiu e lexonin istiadhen në çdo rekate të namazit për ta respektuar urdhrin e Allahut për istiadhen. Ebu Hanife dhe Shafiu mendojnë se duhet të lexohet në rekatën e parë të namazit, ngase shohin se leximi i namazit është një lexim.

Ndërsa sipas variantit tjetër të mëvonshëm të Imam Shafiu, ai mendon se kjo formulë lexohet në të gjitha rekatet.

Imam Maliku nuk e sheh leximin e istiadhes në namazet farz (obligative). Ajo gjen vend vetëm në namazet nafle, gjatë Ramazanit. Kështu kishte vepruar i Dërguari i Allahut, thotë ai.

<sup>31</sup> Kur'an, Nahl: 98.

- Allahu është i vetmi mbrojtës dhe strehimi duhet kërkuar tek Ai.
- Ibli si gjithnjë i paraqitet njeriut vetëm nga anët të cilat e sheh të dobët dhe të paaftë në zbatimin e programit të Allahut<sup>32</sup>.
- Kërkimi i ndihmës së Allahut për t'u ruajtur nga të ligat që shejtani mund t'i shkaktojë njeriut është kërkesë dhe detyrë islame.
- Istiadhja pastron gojën nga fjalët e kota dhe të ndyra dhe e bën gojën e këndshme për të lexuar fjalën e Allahut.
- Istiadhja është për të kërkuar ndihmë prej Allahut, ta pranosh se Ai është i fuqishëm, kurse njeriu i dobët dhe i paaftë t'i rezistojë këtij armiku të brendshëm shejtanit. Këtë armik mund ta largojë vetëm Allahu që e ka krijuar.
- Kjo shprehje shpalos se shejtani është armiku që nuk pranon bashkëveprim dhe nuk mund të fitohet përmes mirësisë, për dallim prej armikut njerëzor.
- Dobia madhore e istiadhes fshihet në atë se melekët zbresin për ta mbrojtur njeriun nga armiku. Ai që vritet nga armiku i dukshëm njerëzor është shehid, dëshmor, por ai që vritet nga armiku i padukshëm, shejtani, është i larguar nga mëshira. Atë që e mund armiku i dukshëm, shpërblehet, ndërsa atë që e mund armiku i padukshëm, shejtani, bie në sherr dhe ndëshkohet.

---

<sup>32</sup> Imam Sharavi.

- “Eudhu bil-lahi minesh-shejtani-raxhim” do të thotë kërkohet mbrojtjen e Allahut xh.sh. nga shejtani i mallkuar, që të mos më dëmtojë në fenë time apo në këtë botë, pra të mos më pengojë nga zbatimi i asaj që më është urdhëruar e të mos më nxisë në bërjen e asaj që më është ndaluar. Shejtanin nuk mund ta largojë askush prej njeriut, përpos Allahut xh.sh. Nisur nga kjo, Allahu i Lartmadhëri i urdhëroi që të komunikohet me shejtanët njerëz duke iu bërë mirë me qëllim që natyra e mirë t’i largojë ata nga të këqijat që bëjnë. Nga ana tjetër, urdhëroi të kërkohet mbrojtja e Tij prej shejtanëve xhindë sepse ky shejtan nuk pranon ryshfet dhe nuk ndikohet nga mirësia e njeriut, për shkak se natyra e tij është ekskluzivisht e mbrapshtë dhe këtë nuk mund ta largojë askush tjetër pos Atij që e ka krijuar<sup>33</sup>.
- Shejtani ka forcë dhe mundësi që ta shohë njeriun dhe që ta dijë se ku është ai, përkundër njeriut, i cili as nuk e sheh shejtanin dhe as nuk e di vendin se ku qëndron ai. Kjo është kështu në pajtim me ajetin vijues.

يَا بَنِي آدَمَ إِمَّا يَأْتِيَنَّكُمْ رُسُلٌ مِّنكُمْ يَقُصُّونَ عَلَيْكُمْ آيَاتِي  
فَمَنِ اتَّقَىٰ وَأَصْلَحَ فَلَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

***“O bijtë e Ademit, le të mos ju mashtrojë kurrsesi djalli, ashtu si i nxori prindërit tuaj nga xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t’u dukur vendet e turpshme! Ai dhe shpura e tij ju sheh, prej nga ju nuk i***

<sup>33</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur’an El-adhim”, vëll. I, fq. 45.

*shihni ata. Ne i kemi bërë djajtë roje të atyre që nuk besojnë.*<sup>34</sup>”

- Mashtrimet dhe cytjet e shejtanit bënë që babai i njerëzimit, Ademi alejhi selam, dhe bashkëshortja e tij të mëkatojnë dhe ky mëkat solli dëbimin e tyre nga xheneti në tokë.
- Shejtani i krijoi hutim Ademit në dy aspekte: së pari, i tha se kush ha nga ajo pemë e ndaluar do të bëhet melek ose i përjetshëm; së dyti, krahas përjetësisë do të fitojë dhe pushtet të pafund. Këtë na rrëfen Kur'ani.

فَوَسْوَسَ إِلَيْهِ الشَّيْطَانُ قَالَ يَا آدَمُ هَلْ أَدُلُّكَ عَلَى شَجَرَةِ الْخُلْدِ وَمُلْكٍ لَّا يَبْلَىٰ

*“Por djalli e cyti: “O Adem, a do të të tregoj pemën e përjetësisë dhe të një mbretërimi që nuk zhduket?”*<sup>35</sup>”

### Metodat mashtruese të shejtanit<sup>36</sup>

- a. Krijimi i hutimit dhe pëshpëritjes nëpërmjet zbukurimit të veprave të këqija.

---

<sup>34</sup> Kur'an, Araf: 27.

<sup>35</sup> Kur'an, Taha: 120.

<sup>36</sup> Emin Bahrami. "Përkthimi dhe komentimi i istiadhes, el-besmeles dhe i suretu-lFatihasë". Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil, vëll. I, fq. 46. Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. I, fq. 87.

- b. Krijimi i hamendjes dhe i hutimit nëpërmjet harresës.
- c. Krijimi i hutimit nëpërmjet ngacmimeve djallëzore.
- d. Krijimi i hutimit nëpërmjet frikësimit.
- e. Hutimi me anë të krijimit të armiçësisë në mes një rëzve.
- f. Mbjellja e hutimit nëpërmjet nxitjes.

### **Mënyra të tjera të istiadhes sipas haditheve autentike**

- a. “Eudhu bilahi Semiji-l Alijim mine shejtani rrahim”. “Kërkoj strehim tek Allahu, i Gjithëdëgjueshmi, i Gjithëdijshti, nga shejtani!”
- b. “Eudhu bilahi Semiji-l Alijim min shejtani raxhim min hemzi-hi ue nefh-hi ue nefthi<sup>37</sup>.”  
“Kërkoj strehim tek Allahu nga shejtani i mallkuar, nga çmenduria e tij, nga arroganca e tij dhe nga poezia e tij!”

### **Komentimi i “Besmele-s”**

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

***Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!***

Fjala e sipërsënuar quhet “besmele”.

---

<sup>37</sup> Shënon Ebu Davudi, 1/206, nr. 775.

Nëse “istiadhja” e përmendur më parë shërben si mjet mbrojtjeje nga veset dhe të ligat e shejtanit të mallkuar nëpërmjet kërkimit të ndihmës së Allahut dhe nëse merret si simbolikë me anë të së cilës besimtari shpreh sinqeritetin e vet se është i gatshëm për t’u larguar nga të gjitha të këqijat e tjera që dëmtojnë në çështjet e fesë dhe të jetës, atëherë besmelja merret si pikënisje nga e cila besimtari synon përkryerjen e vlerave të mirëfillta të moralit islam si dhe vendos që e tërë veprimtaria e jetës së tij të jetë brenda suazave dhe kornizave të programit të Allahut.

## **Sqarimi i fjalëve**

“Bi”: Fjala e parë në besmele është pjesëza *bi*, e cila ka mbi pesëmbëdhjetë kuptime. Versioni më i përshatshëm kuptimor i kësaj pjesëze, në këtë rast, është domethënia e saj në kuptim të kërkimit të ndihmës, domethënie të cilën e preferon komentuesi i njohur i Kur'anit, Alusi, si dhe shumë komentues të tjerë të Kur'anit<sup>38</sup>. Përkthimi i pjesëzës *bi* sipas këtij interpretimi do të ishte si vijon: e filloj leximin, punën, ngrëniën, studimin, etj., duke kërkuar ndihmën e Allahut<sup>39</sup>.

---

<sup>38</sup> Nurudin, "Tefsir suretu Fatiha", I, fq. 50.

<sup>39</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim". vëll. I, fq. 49. Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhesë, el-besmeles dhe i suretul-l-Fatihasë".



Fjala e dytë në besmele është *ismu*, e cila vjen në kuptim të emrit. Rreth prejardhjes dhe qëllimit të saj dijetarët islamë mbajnë dy qëndrime. Dijetarët e Basrës mendojnë se kjo fjalë rrjedh nga “sumuv-vi”, në kuptimin e ngritjes dhe të lartësimit të të emëruarit nëpërmjet emrit të dedikuar enkas për të. Ndërsa sipas dijetarëve të Kufës, kjo fjalë rrjedh nga “simetu” që ka qëllimin e shenjës, e cila shërben si argument për atë e cila është emërtuar ashtu.

Mendimin e parë e mbështet si më të fuqishëm edhe komentuesi Kurtubiu<sup>40</sup>.

Fjala e tretë në besmele është emri kulmor i Krijuesit të gjithësisë, Allah. Shpjegimi i tij është bërë më lart tek istiadhja. Formula e besmeles përfundon duke përmendur edhe dy attribute dhe në të njëjtën kohë dy emra nga emrat e bukur të Allahut: “Err-Rahman-I Gjithëmëshirshmi” dhe “Err-Rahim-Mëshirëploti”. Këto attribute të Allahut rrjedhin nga fjala arabe “Err-rahmetu”, mëshirë.

Rahman ka kuptim (gjithëpërfshirës) se Rahim, sipas Ibn Xheririt. Nga kjo kuptohet se për këtë kanë arritur pëlqim dijetarët<sup>41</sup>.

Kurtubiu thotë: “Ebu Ubejde pohon se të dy emrat kanë të njëjtin kuptim.

Ebu Alijj el-Farisiu thotë: “Er-Rahman është emër i përgjithshëm që i përfshin të gjitha llojet e mëshirës,

---

<sup>40</sup> Kurtubiu, “El-Xhami Liahkam El-Kur'an”, vëll. I, fq. 88.

<sup>41</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, vëll. I, fq. 56.

të cilat janë veçori vetëm të Allahut të Lartmadhërishtëm, ndërkaq “Er-Rahim” u referohet besimtarëve në veçanti.”

Ibn Abasi thotë: “Këta janë dy emra të butë, njëri është më i butë se tjetri, gjegjësisht është më i mëshirshëm<sup>42</sup>.”

Emri “Er-Rahman” është emër i përveçëm i Allahut xh.sh., me të cilin nuk ka emërtuar askënd. Allahu xh.sh. thotë:

قُلْ ادْعُوا اللَّهَ أَوْ ادْعُوا الرَّحْمَنَ ۖ أَيًّا مَا تَدْعُوا فَلَهُ الْأَسْمَاءُ  
الْحُسْنَىٰ ۗ وَلَا تَجْهَرُوا بِصَلَاتِكُمْ وَلَا تَخَافُوا بِهَا وَابْتَغِ بَيْنَ ذَلِكَ سَبِيلًا

***“Thuaj: “Thirrni Allahun ose thirrni të Gjithëmëshirshmin, me cilindo emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur<sup>43</sup>.”***

Kur doli haptazi Musejleme gënjeshtari dhe ia lejoi vetes të quhet “Rahmanu-l-Jemame”, apo “I Gjithëmëshirshmi i Jemenit”, Allahu i Madhërishtëm ia veshi gunën e gënjeshtres dhe e shpalli për gënjeshtar në mesin e njerëzve. Kështu atij nuk i thuhet ndryshe pos Musejleme el-kedhab ose Musejleme gënjeshtari dhe merret si shembull i gënjeshtarit nga të gjithë.

Sa i përket atributit të fundit të Allahut, “Err-Rahim”, që përmendet në besmele, me atë vlerë është e mundshme që të cilësohet edhe njeriu, mirëpo ai

---

<sup>42</sup> Kurtubiu, “El-Xhami Liahkam El-Kur'an”, vëll. I, fq. 105.

<sup>43</sup> Kur'an, Isra: 110.

kursesi, nga aspekti i besimit, nuk mund të cilësohet dhe as të mbajë emrin e Allahut “Err-Rahman”, ndërkohë që as nuk mund të flitet për mundësinë e emërimit me këto dy attribute si të pandashëm<sup>44</sup>.

Pra, thënë shkurt, ka disa emra të Allahut xh.sh. me të cilët emërtohen edhe të tjerët, përveç Allahut xh.sh., kurse disa emra të Tij nuk mund t’u jepen të tjerëve, si për shembull emri Allah, Er-Rahaman (I Gjithëmëshirshmi), El-Halik (Krijuesi), Er-Razik (Furnizuesi) e të ngjashëm me ta<sup>45</sup>.

Ibn Kajimi sqaron se “Err-Rahman” ka të bëjë me një cilësi qenësore dhe me një mbiemër të përveçëm të Allahut nga i cili rrjedh dhe ka burimin dhuntia dhe bamirësia e Tij. Atributi i dytë “Err-Rahim” ka të bëjë me një cilësi praktike dhe faktike të Allahut, pra me dërgimin e të mirave tek ata që i gëzojnë ato<sup>46</sup>.

## Kuptimi i besmeles

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Përmendja e fjalës “bismilah” në Kur'an

Të gjithë dijetarët muslimanë janë unanimesisht se besmelja është pjesë e ajetit 30 të sures Neml:

---

<sup>44</sup> Seid Kutb, “Fi Dhilali-l Kur'an” I, fq. 14.

<sup>45</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”. vëll. I, fq. 56.

<sup>46</sup> “Tefsir Ajjatul-ahkam”, vëll. I, fq. 17.

إِنَّهُ مِنْ سُلَيْمَانَ وَإِنَّهُ بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

**“Ajo është nga Sulejmani dhe është: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit”<sup>47</sup>!”**

Mësimë

## Vlera e besmeles

Imam Ahmed ibn Hanbeli transmeton në “Musne-din” e tij prej shoqëruesit të të Dërguarit të Allahut që thotë: “E gjeta të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe i thashë: -U mjerofte shejtani! Atëherë i Dërguari i Allahut më tha: “Mos thuaj u mjerofte shejtani, sepse kur t'i thua u mjerofte shejtani, ai fryhet dhe thotë: “Me fuqinë time e mposhta”. E nëse thua bismilah (Me emrin e Allahut), ai zvogëlohet aq sa bëhet sa një mizë.”<sup>48</sup> Kjo është prej ndikimit të fjalës bismilah.

## Besmelja pëlqehet të thuhet në fillim të çdo pune

A është besmelja ajeti i parë i sures Fatiha dhe i çdo sureje tjetër apo jo?

Dijetarët kanë rënë në mospajtim se a është besmelja apo jo ajeti i parë i sures Fatiha dhe fillimi i sureve të tjera. Këto mendime mund t'i rumbullakosin në pikat si vijojnë pa përmendur argumentet e tyre:

---

<sup>47</sup> Kur'an, Neml: 30.

<sup>48</sup> Ahmedi, vëll. V, fq. 59.

Besmelja është ajeti i parë i sures Fatiha si dhe i çdo sureje tjetër me përjashtim të sures Teube. Këtë mendim e mbrojnë nga sahabët: Ibn Abasi, Ibn Omeri, Ibn Ez-Zubejri, Ebu Hurejra dhe Aliu r.a., nga tabi'inët janë Atau dhe Tavusi, kurse nga dijetarët janë Shafiu, Ahmed ibn Hanbeli<sup>49</sup>, ekspertët e Mekës dhe të Kufës mbi të kënduarit e Kur'anit dhe juristët e tyre.

Besmelja nuk është ajet as i sures Fatiha e as i sureve të tjera. Ajo si e tillë vetëm ka ardhur për të shprehur dhe për të kërkuar bekimin dhe bereqetin e Allahut të Madhërishëm. Këtë mendim e mbështet Imam Maliku.

Mendimin e tretë për besmelen e përfaqëson Ebu Hanifja, i cili mendon se shkrimi i saj në Kur'an dëshmon se ajo është Kur'an, por jo edhe ajet i çdo sureje. Ndërsa hadithet e transmetuara të cilat flasin për mosleximin haptazi të besmeles gjithashtu dëshmojnë se ajo nuk i përket kësaj sureje si ajet i mëvetësishëm. Në mbështetje të të gjitha këtyre argumenteve, ata kanë ardhur deri në përfundimin se besmelja përveçse si pjesë e ajetit 30 të sures Neml, është ajet i plotë i Kur'anit, i cili ka zbritur për t'i ndarë suret mes tyre. Mendimi më i përafërt me argumente është qëndrimi i fundit. Allahu e di më së miri<sup>50</sup>.

---

<sup>49</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. I, fq. 49.

<sup>50</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi amme", fq. 12-14.

## **Leximi i besmeles në namaz**

Rreth leximit apo mosleximit të besmeles në namaz, dijetarët muslimanë kanë qëndrime të ndryshme, varësisht nga këndvështrimet se a është apo nuk është ajeti i parë i sures Fatiha.

Shafiu mendon se leximi i besmeles në namaz është vaxhib; në namazet me zë edhe ajo lexohet me zë, ndërsa në ato pa zë lexohet po ashtu pa zë.

Maliku e ndalon leximin e saj në namaz, pa marrë parasysh a janë namaze me zë apo jo. Leximi i saj mund të bëhet vetëm në namaze nafile.

Ebu Hanifja në anën tjetër mendon se leximi i besmeles duhet të bëhet pa zë në çdo rekat, para sures-l-Fatiha, por nëse kështu veprohet edhe para çdo sureje tjetër, atëherë as për këtë nuk ka vërejtje. Leximi i saj është sunet<sup>51</sup>.

## **Shprehja e besmeles para therjes dhe gjuetisë**

Shumica e shkollave juridike<sup>52</sup> mendojnë se nuk është e lejuar ngrënia e kafshës së therur apo gjuetia nëse është lënë qëllimisht, por nëse është bërë me harresë, është e lejuar ngrënia e mishit të tillë.

Shafiitë mendojnë se në rast të therjes apo gjuetisë besmelja është sunet, që do të thotë se edhe nëse lihet

---

<sup>51</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. I, fq. .49.

<sup>52</sup> Dijetarët e medhhebit maliki, hanefi dhe hanbeli.

qëllimisht, lejohet ngrënia e mishit qoftë nga therja apo gjuetia.

### **Besmelja para marrjes së abdestit**

Leximi i besmeles para abdestit është sunet sipas mendimit të shumicës së shkollave juridike, pos tek medhhebi hanbeli, që e shohin si vaxhib, që do të thotë se kush nuk thotë besmelen para marrjes së abdestit, nuk ka abdest. Thënia e besmeles para abdestit është sunet. Allahu e di më së miri.

### **Disa raste ku thuhet besmelja**

Fillimi i ligjëratave, i fjalimeve, i hutbeve të xhumasë, para ngrënies, pirjes, shtrirjes për të fjetur, para marrëdhënieve intime bashkëshortore, kur të hysh dhe të dalësh nga shtëpia, para hyrjes në banjë, para udhëtimit si dhe para çdo pune të mirë dhe vendimeve që merren në jetë<sup>53</sup>.

---

<sup>53</sup> Për të gjitha këto kemi argumente nga hadithet e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

## SURJA EL-FIL (ELEFANTI)

Lloji: Mekase<sup>54</sup>, nr. 105, ajete 5

Përmbajtja: Rrëfimi i pronarëve të elefantit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ (١) أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضَلُّيلٍ (٢) وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ (٣) تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ (٤) فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ (٥)

***Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!***

- 1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?***<sup>55</sup>
- 2. A nuk ua prishi atyre kurthin,***
- 3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh,***
- 4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur?***
- 5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë.***

---

<sup>54</sup> Mekase janë ato ajete apo kaptina që kanë zbritur në Mekë, para hixhretit.

<sup>55</sup> Në vitin 570 (ose 571), Ebreha, guvernatori abisinasi i Jemenit, u betua se do ta shkatërronte Qabënë, të cilën e konsideronte një tempull pagan, në mënyrë që të vendoste dominimin e krishterë në të gjithë Gadishullin Arabik. Ai mbledhi një ushtri të fuqishme, në krye të së cilës marshonte një elefant i madh, dhe u drejtua për nga Meka. Kur ushtria iu afrua Mekës, elefantit u ul dhe nuk pranonte të ecte në atë drejtim. Kur i ndërronin drejtimin, ai ecte. Kjo ishte shenjë që ushtria e Ebrehesë të mos e sulmonte Mekën, por Ebreheja s'ia vuri veshin asaj. Allahu i Madhëruar i goditi ashpërsisht njerëzit e elefantit nëpërmjet tufash të panumërta me zogj, që lëshonin një lloj guri të fortë e vdekjeprurës. Morali ishte i qartë për fisin Kurejsh: Allahu i Madhëruar e kishte mbrojtur Faltoren e Tij, por edhe ata prandaj duhej të ishin mirënjohës për këtë.



## Emërtimi

Kjo sure në Kur'an mban numrin rendor 105. Quhet surja El-Fil, surja e Elefantit<sup>56</sup>. Emrin e ka marrë nga elefanti që është përdorur si mjet për të shkatërruar Qabenë e ndritshme. Ky rrëfim nuk është përmendur dy herë në Ku'ran, për dallim nga rrëfimet e tjera, shumica e të cilave janë përmendur më shumë se një herë, si ai i Junusit alejhi selam, që është përmendur dy herë, në suren Safat dhe Kalem apo i Musait me Faraonin, i cili është përmendur dy herë në suren Kasas dhe dy herë në suren Duha. Sipas kësaj ngjarjeje, mori emrin edhe ai vit, i cili në librat e historisë njihet si viti i elefantit<sup>57</sup>.

Për arsyen pse nuk është përmendur dy herë, Tahir Ibn Ashur<sup>58</sup> ka thënë sepse “kjo sure nuk ka të bëjë me përgënjeshtrimin e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).”

## Shkaku i zbritjes

Kjo ngjarje ka lidhje me njerëzit e hendekut, të cilët Allahu i ka përmendur në suren Buruxh. Dhu Nevasi, i cili ishte mbreti i fundit i humejrëve, i vrau

---

<sup>56</sup> Shumica e sureve në Kur'an janë emërtuar në bazë të tematikës apo dominimit të emrit në atë sure.

<sup>57</sup> Po në këtë vit, 570-571, ka lindur Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

<sup>58</sup> Në tefsirin e tij, “Etahrir ue Tenvijr”.

njerëzit në hendeqe. Viktimat ishin të krishterë dhe numri i tyre ishte afërsisht njëzet mijë. Prej tyre shpëtuan vetëm Deus dhe Thaëlebani, të cilët shkuan dhe kërkuan ndihmë prej mbretit të Shamit, i cili po ashtu ishte i krishterë. Ai i drejtoi ata me një shkresë te Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, ngase ishte më pranë tyre. Nexhashiu dërgoi me ta dy komandantë, Erjatin dhe Ebreha ibn es-Sebahun me një ushtri të madhe. Ata hynë në Jemen dhe e rrëzuan mbretërinë e humejrëve. Dhu Nuvasi u mbyt në det duke ikur, kurse pushtetin e morën në dorë abisininasit me në krye këta dy komandantë. Mirëpo këta ranë në konflikt dhe e sulmuan njëri-tjetrin. Kur i rreshtuan ushtritë e veta që të luftojnë, njëri prej tyre tha: “Nuk ka nevojë që të ndeshen ushtritë, por do të dalim vetëm ne të dy në dyluftim dhe cili prej nesh ta vrasë tjetrin, le ta marrë pushtetin”. Tjetri e pranoi këtë propozim dhe dolën në dyluftim. Erjati e sulmoi Ebrehanë, ia preu hundën e gojën dhe ia çau fytyrën, por Atudeja, robi i Ebrehasë, e sulmoi Erjatin dhe e vrau. Ebrehaja u kthye i plagosur, e kuruan dhe pas një kohe u shërua. Kështu ai mbeti komandant i vetëm i ushtrisë abisininase në Jemen.

Nexhashiu i dërgoi një shkresë ku e qortonte për atë që kishte bërë, e kërcënonte dhe betohej se do ta shkelte tokën e tij dhe do t’ia qethte balluket. Mirëpo Ebreha deshi të fitonte simpatinë e tij dhe i dërgoi disa dhurata dhe një strajcë me dhë prej Jemeni, i

gethi balluket dhe ia futi po në atë strajcë. Ai i dërgoi Nexhashiut një letër në të cilën thoshte: "Mbreti le të shkelë dheun e kësaj strajce, që ta çojë në vend betimin që ka bërë. Këto janë balluket e mia, i kam qethur dhe t'i kam dërguar." Kur arriti i deleguari i Ebrehasë te Nexhashiu dhe ia dorëzoi këto gjëra, Nexhashiut i pëlqyen, u pajtua me Ebrehanë dhe pranoi që të vazhdonte si komandant edhe më tej. Pas kësaj, Ebrehaja i dërgoi një lajm Nexhashiut, se do t'i ndërtojë një kishë në Jemen, e tillë që nuk ishte ndërtuar më parë.

Ebrehaja ia filloi në San'a ndërtimit të kësaj kishë të madhe e të lartë, të stolisur nga të gjitha anët dhe shumë të lartë.

Ebrehaja deshi që ta kthente haxhin nga Qabeja në këtë kishë në Jemen, prandaj i thirri njerëzit në mbretërinë e tij, por arabët e fiseve Adnan dhe Kahtan nuk e pranuan diçka të tillë, kurse arabët e fisit Kurejsh u nervozuan shumë nga ky veprim i Ebrehasë.

Kështu, disa prej tyre shkuan natën, hynë brenda në kishë dhe e përlyen me fëlliqësira dhe arritën të ikin e të ktheheshin në Mekë. Kur e panë rojet se ç'kishte ndodhur në kishë, e lajmëruan mbretin dhe i thanë: "Këtë punë e kanë bërë disa njerëz të fisit Kurejsh, të hidhëruar sepse ti i bën konkurrencë me këtë kishë faltore së tyre." Ebrehaja u betua se do të shkonte deri në Mekë dhe do ta shkatërronte faltoren e Qabesë duke ia hequr gurët një nga një.

Ebreha u përgatit me një ushtri të madhe, që të mos kishte mundësi askush ta pengonte dhe mori me vete një elefant të madh, që si ai nuk kishin parë kurrë, i cili quhej Mahmut. Këtë elefant të madh ia kishte dërguar atij Nexhashiu, mbreti i Abisinisë, për këtë qëllim. Disa kanë thënë se ka pasur edhe tetë elefantë të tjerë, disa thonë se ka pasur edhe dymbëdhjetë e kështu me radhë. Ai i kishte marrë elefantët që ta rrëzonte Qabenë, t'i lidhte me zinxhirë këndet e Qabesë dhe pastaj t'i lidhte në qafën e elefantëve dhe t'i rrëzonte muret e Qabesë përnjëherë.

Kur morën vesh arabët për marshimin e Ebrehasë, e konsideruan si veprim shumë të rrezikshëm dhe se e kishin obligim t'i kundërviheshin çdokujt që dëshironte të rrëronte Qabenë. Atij së pari iu kundërvu njëri nga bajraktarët dhe princat e Jemenit, me emrin Dhu Nefer. Ai e thirri popullin e vet dhe arabët e tjerë që t'i kundërvihen Ebrehasë për ta mbrojtur Qabenë - Shtëpinë e Allahut. Ata hapën luftë me Ebrehanë, por ai i mposhti, e zuri rob Dhu Neferin dhe e mori me vete.

Pastaj vazhdoi marshimin dhe kur arriti në tokën e fisit Hatha'n, iu kundërvu Nufejl bin Habib el-Hathamij me njerëzit e tij, por Ebrehaja e mundi edhe atë dhe e zuri rob Nufejlin. Në fillim deshi ta vriste, por pastaj e amnistoi dhe e mori me vete që t'i tregonte rrugën në Hixhaz.

Kur iu afrua Taifit, fisi Thekif i bëri lajka dhe i uroi mirëseardhjen nga frika se mos ua prishte tempullin e idhullit Lat, që kishin në vendin e tyre. Ebrehaja nuk i preku dhe ata dërguan Ebu Regalin që t'ia tregonte rrugën deri në Mekë.

Kur arriti në afërsi të Mekës, në vendin el Mugames, Ebrehaja fushoi aty, ndërsa ushtria e tij grabiti bagëtiti e banorëve të Mekës, të cilat kullotnin në atë vend. Në mesin e bagëtive ishin edhe dyqind devetë e Abdu-l Mutalibit.

Ebrehaja dërgoi Hannat el-Humejrin në Mekë që t'i sillte të parin e fisit Kurejsh dhe ta lajmëronte se mbreti nuk kishte ardhur që të luftonte kundër tyre, por që të rrëronte Qabenë. Hannat shkoi në Mekë dhe i treguan se i pari i Kurejshëve është Abdul Mutalib ibn Hishami. Hannat i tregoi se çfarë i kishte thënë Ebrehasë, por Abdul Mutalibi iu përgjigj: “Pasha Allahun, ne nuk duam të luftojmë me të dhe realisht nuk kemi as fuqi. Kjo është Shtëpia e Shenjtë e Allahut dhe e mikut të Tij, Ibrahimit alejhi salam. Nëse Allahu e mbron prej tij, kjo është shtëpia dhe vendi i shenjtë i Tij. Nëse e lë ta rrëzojë, ne nuk kemi fuqi ta ndalojmë atë.” Atëherë Hannat i tha: “Eja me mua të shkojmë te mbreti” dhe shkoi bashkë me të.

Ebrehaja kur e pa, e priti me respekt. Abdul Mutalibi ishte njeri i madh dhe i pashëm. Ebrehaja zbriti nga froni i tij dhe u ul me të në një qilim të shtruar në tokë.

Pastaj iu drejtua përkthyesit dhe i tha: “Pyete këtë njeri çfarë nevoje ka?” Abdul Mutalibi i tha: “Unë kërktoj prej mbretit që të më kthejë dyqind devetë e mia që m’i ka rrëmbyer.” Ebrehaja iu drejtua përkthyesit e i tha: “Thuaji këtij: Më ke pëlqyer shumë kur të pashë, por pasi fole, u ule në sytë e mi. Ti më flet mua për dyqind devetë e tua, ndërkaq lë mënjanë faltoren, e cila është simbol i fesë sate dhe fesë së stërgjyshërve të tu. Unë kam ardhur ta rrënoj atë tempull e ti nuk më flet për të?” Abdul Mutalibi ia ktheu: “Unë jam pronari i deveve, ndërsa kjo faltore e ka Zotin e vet, që do ta mbrojë.” Ebrehaja ndërhyri: “Nuk do të mund ta mbrojë prej meje!” Abdul Mutalibi i tha: “Atë do ta shohim më vonë.”

Ebrehaja ia ktheu Abdul Mutalibit devetë e rrëmbyera.

Abdul Mutalibi u kthye te Kurejshët dhe i urdhëroi që të largoheshin nga Meka se mos keqtrajtoheshin nga ushtria e Ebrehasë, pastaj shkoi, u kap tek hallka e derës së Qabesë bashkë me disa Kurejshë të tjerë dhe filluan t’i bëjnë lutje Allahut dhe të kërkojnë ndihmën e Tij kundër ushtrisë së Ebrehasë. Abdul Mutalibi dhe shoqëruesit e tij më pas u nisën drejt kodrave.

Në mëngjes, Ebrehaja u përgatit me ushtrinë që të hynte në Mekë, përgatiti edhe elefantin e tij. Kur e drejtuan elefantin nga Meka, Nufejl ibn Habibi shkoi dhe e kapi për veshi dhe i tha: “Mahmut, ulu

dhe kthehu shëndoshë andej nga ke ardhur, ngase ti je në tokën e shenjtë të Allahut!” Pastaj e lëshoi veshin e elefantit dhe elefanti u ul, kurse Nufejli shkoi dhe hipi në kodër. Ushtarët filluan t’i gjuajnë elefantit që ta detyrojnë të ngrihej, por ai nuk ngrihej. Përdorën lloj-lloj metodash që ta detyronin të ngrihej, por ai nuk ngrihej. Mirëpo kur e kthyen nga Jemeni, ai u çua dhe nisi të vrapojë; kur u kthye nga Shami bëri të njëjtën gjë dhe kur e kthyen nga lindja nisi sërish të vrapojë. Kur e kthyen nga Meka, u ul dhe nuk lëvizi.

Ibën Is’haku ka thënë: “Ata ikën duke u rënë pjesët e trupit rrugëve dhe duke mbetur të vdekur kudo nëpër rrugë. U godit edhe Ebrehaja, por ushtarët e morën me vete, kurse atij i binte mishi prej trupit pjesë-pjesë gjatë rrugës. Kur arritën në San’a ishte bërë si zogu kur del nga veza. Thuhet se nuk ka vdekur pa iu ndarë zemra nga kraharori<sup>59</sup>.”

## Kuptimi i ajeteve

أَلَمْ تَرَ كَيْفَ فَعَلَ رَبُّكَ بِأَصْحَابِ الْفِيلِ (١)

**1. Vallë, a nuk ke dëgjuar ti se si bëri Zoti yt me njerëzit e elefantit?**<sup>60</sup>

---

<sup>59</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur’an”, 30/193-196; Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, 5/304; Kurtubiu, “El-Xhami Liahkam El-Kur’an”, 8/7277; Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur’an El-adhim”, komentimi i sures Fil,7/488

<sup>60</sup> Kur’an, Fil: 1.

Allahu i drejtohet Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), por ky ajet përfshin edhe umetin e tij<sup>61</sup>. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) as që e kishte parë këtë ngjarje, nuk kishte lindur ende. Kjo ka kuptimin që ty o Muhamed dhe njerëzve që janë në mesin tuaj dhe atyre që do të vijnë më pas u ka ardhur lajmi për këtë ngjarje nëpërmjet zinxhirit autentik. Pra, përse nuk po besoni<sup>62</sup>?

Ebu Naimi dhe Bejhakui kanë shënuar nga Ibn Abasi se ka thënë: “Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka lindur në vitin e elefantit<sup>63</sup>.”

Njerëzit e elefantit ishin pronarët e tyre, ushtria që i udhëhiqnin drejt Qabesë së bekuar për ta rrënuar atë. Ky elefant quhej Mahmut dhe sa herë që e urdhëronin në drejtim të Qabesë, ai kthehej në anën e kundërt. Edhe pse e rrihnin, ai nuk pranonte ta thyente urdhrin e Allahut, ndonëse ishte kafshë. Kur elefanti u ndal në këtë luginë, iu afrua Nufejli dhe i tha: “Mos prano, ti je në tokën e shenjtë të Allahut<sup>64</sup>!”

Subhanallah! Do të ishte mirë që ta pyesim veten se sa herë gjatë ditës i thyejmë urdhrat e Allahut?

---

<sup>61</sup> Ibn Uthejmin, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 319.

<sup>62</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. 10, fq. 418.

<sup>63</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", fq. 492.

<sup>64</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", fq. 490.



أَلَمْ يَجْعَلْ كَيْدَهُمْ فِي تَضْلِيلٍ (٢)

## 2. A nuk ua prishi atyre kurthin<sup>65</sup>

A nuk bëri të dështojnë dinakëria dhe përpjekjet e tyre për ta rrënuar Qabenë dhe popullin përreth saj? Madje atyre nuk iu dha mundësia as që të afrohen afër saj. Kurth është të dëshirosh t'i bësh dëm dikujt, ngase pronarët e elefantit deshën të derdhin gjakun e Kurejshëve dhe të rrënonin Qabenë duke e prishur me anë të elefantit.<sup>66</sup> Ky ajët kuranor është prej argumenteve të Allahut të Lartësuar. Ata mbetën në këtë gjendje derisa Allahu dërgoi zogj nga qielli për t'i shkatërruar.

Ibn Is'haku ka thënë: “Kur Allahu i ktheu pas abisin-asit nga Meka, arabët filluan t'i çmojnë Kurejshët. Thoshin se këta janë populli i Zotit, ngase Allahu luftoi në anën e tyre dhe i mbrojti kundër armikut të tyre<sup>67</sup>.”

وَأَرْسَلَ عَلَيْهِمْ طَيْرًا أَبَابِيلَ (٣)

## 3. duke dërguar kundër atyre tufa zogjsh<sup>68</sup>

Këto tufa zogjsh ishin njëra nga ushtritë e Allahut, që Allahu subhanehu ue teala e dërgoi kundër një pop-

<sup>65</sup> Kur'an, Fil: 2.

<sup>66</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsir Elmunir", vëll. 15, fq. 706.

<sup>67</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", fq. 491.

<sup>68</sup> Kur'an, Fil: 3.

ulli mizor, por dihet se dënimet e Allahut janë të llojllojshme në këtë botë dhe botën tjetër.

Këta zogj ngjallin kureshtjen e çdo besimtari për ta ditur se nga erdhën e çfarë ishin. Këtë kureshtje më së miri mund ta shuajmë duke lexuar se çfarë thanë dijetarët rreth këtyre zogjve. Po ju sjellim disa nga këto mendime.

- Ibën Abasi dhe Ed-Dahaku kanë komentuar se “*ebabil*” janë shpezët që ndjekin njëri-tjetrin<sup>69</sup>.
- Hasen el Basrij ka komentuar se “*ebabil*” janë shpezë të shumtë<sup>70</sup>.
- Ibën Xheriri ka transmetuar prej Is’hakut se “vinin në turma si devetë në numër të madh<sup>71</sup>.”
- Ibn Abasi për këtë ajet ka komentuar: “Ata kanë pasur hundë si hundët e shpendëve, ndërsa shputat si të qenve<sup>72</sup>.”
- Është transmetuar prej Ikremes se ka komentuar: “Këta kanë qenë shpendë të gjelbër që kanë dalë prej deti, kanë pasur koka si të egërsirave<sup>73</sup>.”
- Është transmetuar prej Ubejd ibn Umejrit se ka thënë: “Ata kanë qenë shpendë të zinj që vinin nga detet, në sqepa dhe kthetra kanë mbajtur gurë<sup>74</sup>.”

---

<sup>69</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, fq. 492.

<sup>70</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, fq. 492.

<sup>71</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 606.

<sup>72</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 607.

<sup>73</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 607.

<sup>74</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 607.

- Seijd bin Xhubejri thotë: “Ishin zogj që vinin nga qielli, që nuk janë parë më parë e as pas tyre si ata kurrë<sup>75</sup>.”
- Katade thotë: “Ishin zogj të zinj, që vinin nga ana e detit turma-turma. Çdo shpend kishte tre gurë, dy gurë në kthetra e një në sqep, nuk e goditnin dikë veçse e copëtonin<sup>76</sup>.”
- Ibn Kethiri përmend se “këta zinxhirë transmetuesish janë autentikë<sup>77</sup>.”
- Nuhasi ka thënë: “Të gjitha këto fjalë përputhen njëra me tjetrën dhe japin kuptimin se ata zogj ishin diçka shumë madhështore<sup>78</sup>.”

Patjetër duhet të ishin diçka e veçantë sepse ata zogj Allahu i dërgoi për të ndëshkuar mizorët dhe ishin një nga ushtritë e Allahut. Ky është ligj i Allahut në kozmos, që nuk ndryshohet.

وَمَا يَعْلَمُ جُنُودَ رَبِّكَ إِلَّا هُوَ

***“Askush tjetër, përveç Tij, nuk e di numrin e ushtrisë së Zotit tënd<sup>79</sup>.”***

Por cili ishte dënimi që këta shpend sillnin me vete?!

تَرْمِيهِمْ بِحِجَارَةٍ مِّن سِجِّيلٍ (٤)

***4. të cilët i gjuajtën me gurë prej baltës së pjekur<sup>80</sup>***

<sup>75</sup> E-sheukani, "Fethul Kadir", vëll. V, fq. 666.

<sup>76</sup> E-sheukani, "Fethul Kadir", vëll. V, fq. 666-667.

<sup>77</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", fq. 493.

<sup>78</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 425.

<sup>79</sup> Kur'an, Mudethir: 31.

<sup>80</sup> Kur'an, Fil: 4.

Allahu na mbrojtë nga hidhërimi i Tij! Sa i dhimbshëm është dënimi i Tij! A nuk shohim çdo ditë pamje nga bota, ku Allahu sjell argumentet e Tij për t'i frikësuar njerëzit që t'i kthehen rrugës së Tij?

وَمَا نُرْسِلُ بِالْآيَاتِ إِلَّا تَخْوِيفًا

*“Ne dërgojmë shenja vetëm për t'i frikësuar njerëzit<sup>81</sup>.”*

Edhe këta gurë që zogjtë mbanin në sqepat dhe kthe-trat e tyre ishin argumente të qarta të Zotit Fuqiplotë. Gurë nga balta e pjekur në zjarrin e xhehenemit. Në të shkruhej emri i atij populli. Ata ishin gurët me të cilët u ndëshkuan populli i Lutit alejhi salam<sup>82</sup>. Gurët ishin të pjekur në zjarr, që të jenë më të fortë. Madhësia e tyre nuk ishte e madhe, por kur goditej dikush me të në kokë, ai depërtonte dhe dilte nga ana e prapme. Allahu na mbrojtë nga dënimi i Tij<sup>83</sup>!

Përfundimi i tyre qe:

فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ (٥)

*5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë<sup>84</sup>.*

Kështu Allahu i Madhërishëm i shkatërroi dhe i asgjësoi dhe bëri që plani dhe qëllimet e tyre famë-

---

<sup>81</sup> Kur'an, Isra: 59.

<sup>82</sup> E-sheukani, "Fethu-l Kadir", vëll. V, fq. 667.

<sup>83</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 320.

<sup>84</sup> Kur'an, Fil: 5.

keqe t'u kthehen si bumerang. Të gjithë u shkatërruan sepse Allahu i bëri si gjethe të shtypura, të grimcuara e të përtytura.

Për fjalët e të Lartmadhërishmit:

فَجَعَلَهُمْ كَعَصْفٍ مَّأْكُولٍ (٥)

### *5. Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë.*

Seid ibn Xhubejri ka komentuar duke thënë se “janë bërë si kashta”, ndërsa sipas një transmetimi tjetër se “janë bërë si gjethi i grurit”<sup>85</sup>.

Ibn Zejdi ka thënë: “El-asfu janë gjethet e bimëve dhe kullosat kur i hanë begatitë dhe i nxjerrin si pleh”<sup>86</sup>.

Në këtë ajet është bërë përngjasimi me gjethet sepse trupat e tyre janë copëtuar si gjethet kur i përtypin kafshët.

Ibn Abasi thotë: “Ata janë bërë si lëvozhga e grurit”. Transmetohet se kur ata goditeshin me gurë, u dilte çdo gjë që kishin në brendësinë e tyre dhe kështu mbeteshin si lëvozhga kur del gruri prej saj”<sup>87</sup>.

Ibn Mesudi thotë: “Kur zogjtë i hidhnin gurët, Allahu i Madhërishëm dërgonte një erë që t'u shtohet fuqia e tyre dhe kush goditej, shkatërrohej”<sup>88</sup>. Por e vërteta është se dënimi nuk i përfshiu të gjithë, vetëm

<sup>85</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, vëll. VIII, fq. 493.

<sup>86</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 699.

<sup>87</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. II, fq. 1034.

<sup>88</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. II, fq. 1034.

ata që deshi Allahu. Edhe prijësi i tyre Ebrehaja u kthye pas dhe më vonë vuajti e vdiq duke përjetuar momente të dhimbshme në çastet e vdekjes, kur iu nda zemra nga kraharori<sup>89</sup>."

Mësim<sup>90</sup>

Kumtohet se i Dërguari i Allahut në ditën e çlirimit të Mekës ka thënë: *"Vërtet, Allahu e ndaloi elefantin të hynte në Mekë, e pushtetin në të ia dha të Dërguarit të Tij dhe besimtarëve. Shenjtëria e saj sot është rikthyer sikur ka qenë dje. A dëgjuat? Ata që janë të pranishëm le t'ua kumtojnë atyre që nuk janë<sup>91</sup>."*

---

<sup>89</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 428.

<sup>90</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishtëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanijji, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Uthejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Allij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-l Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkijj, "Sherh Akide Et-Tahaujje"; Shejh Islam ibn Tejmije, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Zadul Mead"; Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Feuaid"; Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase".

<sup>91</sup> "Fer'hul Bari", vëll. I, fq. 248; Muslimi, vëll. II, fq. 988.

Përgatitja nga ana e Allahut për Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ndaj mizorisë së fisit Kurejsh ndaj tij.

Kjo sure alarmon fisin Kurejsh për fuqinë e Allahut, për t'i frikësuar dhe qortuar ata.

Shpalos fuqinë e Allahut kundër armiqve të Tij.

Tregon se kush dëshiron ta pengojë të vërtetën, Allahu do t'ia asgjësojë kurthet e tyre.

Allahu i Madhëruar deshi që Kurejshët ta kuptojnë se çfarë pësuan ata që deshën të prekin shenjtërinë e Qabesë së bekuar dhe çfarë do t'i gjejë po që se prekin shenjtërinë e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), edhe pse ai ende nuk kishte lindur. Prej mesazheve të kësaj sure është se Kurejshët mendonin se ishin në pozitë më të lartë sesa besimtarët ngase kujdesi për Qabënë e ndritshme u takonte atyre. Por Allahu i Madhëruar u përgjigjet duke u thënë:

أَجَعَلْتُمْ سِقَايَةَ الْحَاجِّ وَعِمَارَةَ الْمَسْجِدِ الْحَرَامِ كَمَنْ أَمَنَ بِاللَّهِ  
وَالْيَوْمِ الْآخِرِ وَجَاهَدَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ ۗ لَا يَسْتَوُونَ عِنْدَ  
اللَّهِ ۗ وَاللَّهُ لَا يَهْدِي الْقَوْمَ الظَّالِمِينَ

*“Vërtet mendoni se ai që u jep ujë haxhilerëve dhe mirëmban Xhaminë e Shenjtë është njësoj me atë që beson në Allahun dhe Ditën e Fundit dhe që lufton në rrugën e Allahut?! Këta nuk janë të njëjtë para*

***Allahut. Ai nuk i udhëzon në rrugë të drejtë njerëzit keqbërës<sup>92</sup>.***

Kurejshët mendonin se edhe pse nuk ishin besimtarë, u mjaftonin si privilegje shërbimet që u ofronin haxhilerëve dhe shtëpisë së shenjtë, Qabesë së bekuar, por Allahu përmes këtij ajeti u tregoi se një gjë e tillë nuk është e barabartë me ata që kanë besuar në Allahun dhe Ditën e Fundit të (Gjykimit).

Allahu u dhuroi Profetëve mrekulli apo argumente pas shpalljes së tyre si Profetë, kurse Muhamedit (paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të) mrekuilitë iu shfaqën edhe para shpalljes. Ato dijetarët i quajnë “irhasat”<sup>93</sup> apo “paralajmërimë” dhe kuptimi i tyre është ndryshim i gjendjes së zakonshme në të pazakonshme. Këto i ndodhnin Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) kur ishte në Mekë, për shembull kur kalonte pranë një peme ajo e përshëndeste me selam. E njëra ndër to ishte edhe mbrojtja e Qabesë së bekuar nga ana e Allahut.

Pra, “irhasat” paralajmërimet, janë para shpalljes, ndërsa argumentet, muxhizet<sup>94</sup>, vijnë pas gradës së Profetësisë.

---

<sup>92</sup> Kur'an, Teube: 19.

<sup>93</sup> Irhasat janë parashenja që aludojnë se diçka me rëndësi do të ndodhë. Irhasat janë para shpalljes.

<sup>94</sup> Mrekullitë janë argumentet e Pejgamberëve që Allahu i Plotfuqishëm u ka dhënë pasi janë graduar me titullin Nebij ose Resul.



Allahu subhanehu ue teala e mbrojti Qabenë e bekuar nga pronarët e elefantit, edhe pse nga shenjat e kiametit është që do të vijë një burrë nga abisinasit dhe do ta rrënojë. Mbrojtja në vitin e elefantit ishte paralajmërim për ardhjen e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe shenjë se Qabeja do të madhërohet. Ndërsa fundi është nënçmim për banorët e Mekës dhe ata që e vizitojnë sepse ata do ta neglizhojnë dhe do të veprojnë në të me mizori, por Allahu nuk e mbron popullin zullumqar.

Allahu na tregon nëpërmjet kësaj sure se si kjo kafshë, e cila nuk ka logjikë e as që është e ngarkuar me ndonjë përgjegjësi, i bindet urdhrit të Allahut dhe del në anën e atyre që e ndihmojnë dhe mbrojnë Qabenë e bekuar. E ti pyete veten në cilën anë je rreshtuar në jetën e kësaj bote, me ata që e mbrojnë fenë e Allahut apo që e sulmojnë? Prej teje mund të kërkohet që t'i bësh dëm fesë tënde me pozitë, laps, influencë ose pasuri por kurrë mos e prano një gjë të tillë. Sa ka që marrin mbi supet e tyre për ta luftuar fenë e Allahut, por janë më të humbur se kafshët? Çështja është se ti je përgjegjës për veten tënde. Si është e mundur që njeriu ta shfrytëzojë dhuntinë e Allahut për ta penguar të vërtetën apo mundohet ta shuajë dritën e fesë?! Nëse ti bën ndonjë mëkat, të gjithë ne jemi mëkatarë, pasi sikur të shpaloseshin gjynahet tona, nuk do ta varrosnim dot njëri-tjetrin.

Por kur e bën një gjë të tillë për ta sulmuar fenë e Allahut me dashje dhe vetëdije të plotë, kjo është fatkeqësia më e madhe.

Njeriu duhet ta kuptojë qëllimin e ardhjes në jetë dhe të krijimit të tij. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tregon se si njëherë një person kishte hipur mbi një lopë. Ajo në atë çast foli dhe i tha: "Nuk jam krijuar për këtë, por për të lëvruar." Njeriu nuk duhet t'i japë rast askujt që ta largojë nga qëllimi për të cilin është krijuar, që është adhurimi i Allahut të Madhëruar. Dije se jeta është me sfida dhe prova të ndryshme, por mos lejo që elefanti të jetë më i ditur se ti për Allahun e Lartësuar!

Kjo ngjarje ka ndodhur në muajin Muharem, ndërsa Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka lindur në muajin Rebiul Euel, domethënë 55 ditë para lindjes së Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Në këtë vit, vitin e elefantit, lindi i Dërguari i fundit, Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)<sup>95</sup>. Lindja e tij ishte shenjë e një të ardhmeje të sigurt dhe e një prosperiteti për Kurejshët, shenjë e sigurisë së Mekës. Lindja e tij ishte parashenjë hyjnore për shfaqjen dhe përhapjen e Islamit nga Meka anekënd botës. Një gjë të tillë e shënon surja në vijim.

---

<sup>95</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 491.

O Allah! O Zoti ynë, mundësona ta kuptojmë fjalën Tënde, që ia shpalle të Dërguarit Tënd (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)!

Na bëj ndihmëtarë të fesë Tënde dhe na ruaj nga hidhërimi Yt!

O Zot, asgjësoji kurthet e atyre që punojnë për ta shuar dritën Tënde!

## SURJA KUREJSH (KUREJSHËT)

Lloji: Mekase, nr. 106, ajete 4

Përmbajtja: Dhuntitë e Allahut ndaj Kurejshëve dhe thirrja për ta adhuruar Atë.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

لِإِيلَافِ قُرَيْشٍ (١) إِيْلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشِّتَاءِ وَالصَّيْفِ (٢) فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ (٣) الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِّنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِّنْ خَوْفٍ (٤)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!*

- 1. (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) Për të mbrojtur fisin Kurejsh<sup>96</sup>,*
- 2. për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë<sup>97</sup>.*
- 3. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë),*

---

<sup>96</sup> Sipas disa komentuesve, përmbajtja e kësaj sureje është e lidhur ngushtë me suren e mëparshme, duke lënë të nënkuptohet se shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri për të mbrojtur Kurejshët.

<sup>97</sup> Struktura ekonomike mbi të cilën ishte ngritur mirëqenia e Kurejshëve të Mekës bazohej në dy situata tregtare: njëra ishte pelegrinazhi i përvitshëm, që sillte në Mekë të gjithë arabët e Gadishullit Arabik, kurse tjetra ishte udhëtimi i dy karvanëve vjetorë, njëri drejt Jemenit gjatë dimrit dhe tjetri drejt Shamit (sot Siria, Palestina, Libani dhe Jordania) gjatë verës. Pozicioni qendror i Mekës ndërmjet Mesdheut dhe Oqeanit Indian dhe aftësitë e jashtëzakonshme të tregtarëve Kurejshë bënë që këto dy karvanë të ktheheshin në pikëmbështetjen e të gjithë aktivitetit ekonomik të qytetit.

#### *4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike.*

### **Emërtimi**

Surja e ka marrë emrin nga fisi Kurejsh, një fis arab që jetonte në Mekë, nga e kishte prejardhjen edhe Pejgamberi Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Ky fis konsiderohet ndër fiset më prestigjioze mbi rruzullin tokësor për shkak të gjenezës që ka<sup>98</sup>. Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është i biri i Abdullahut, i biri i Abdul Mutalibit, i biri i Hashimit, i biri i Abdul Menafit, i biri i Kusejjit, i biri i Kilabit, i biri i Murrehut, i biri i Kabit, i biri i Luejës, i biri i Galibit, i biri i Fihërit, i biri i Malikut, i biri i Nedrit, i biri i Kenaneh, i biri i Huzejmeh, i biri i Mudrikeh, i biri i Ilajsit, i biri i Mudare, i biri i Nezarit, i biri i Muadit, i biri i Adnanit.<sup>99</sup> Adnani është nga Ismajli alejhi selam, i biri i Ibrahimit alejhi selam.

Ky zinxhir nga Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e deri tek Adnani është autentik, ndërsa pas Adnanit e deri tek Ibrahimit alejhi selam nuk kemi argument të prerë për të.

Kurejshët në rrjedhat historike kanë pasur shumë privilegje dhe dallohen nga fiset e tjera arabe, por u

---

<sup>98</sup> Ibn Kajim el Xhevzjeh, "Zadul Mead", vëll. 1, fq. 70.

<sup>99</sup> Ibn Kajim el Xhevzjeh, "Zadul Mead", vëll. 1, fq. 70.

mjafton që Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është pjesëtar i këtij fisi. Pjesa më e madhe e Kur'anit ka zbritur në gjuhën (dialektin) e tyre, ndërsa pjesa tjetër jo, pasi Kurejshët nuk e shqiptonin "hemzen", ndërkohë që dihet se Kur'ani ka ardhur me "hemze". Kur Othmani, Allahu qoftë i kënaqur me të, bëri tubimin e Kur'anit në një musaf, që njihet si tubimi i dytë, kishte përzgjedhur që për këtë detyrë nga kurejshët të angazhoheshin personat në vijim: Seid bin A'si, Abdurhaman bin Harith bin Hishami, Ibn Zubejri dhe Zejd bin Thabiti, por ky i fundit ishte nga Medina. Othmani, Allahu qoftë i kënaqur me të, i tha: "Nëse keni mospajtim, shkruajeni në gjuhën e kurejshëve." Kurejshët nuk u larguan nga Islami pas vdekjes së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), edhe pse disa fise arabe dolën nga Islami. Merita për këtë i takon hatibit të Kurejshëve, Suhejl bin Amërit. Kjo sure emërtohet ndryshe edhe si surja "Li 'ijlaf".

## **Shkaku i zbritjes**

Kjo sure flet për fisin Kurejsh, për mirësitë që u kishte dhuruar Allahu i Madhërishtëm<sup>100</sup>. Në Kur'an është e ndarë nga surja e mëparshme, surja Fil. Ndërmjet tyre është vendosur "Bismilahi" ("Në emër të Allahut"), edhe pse në mes dy sureve ka lidhshmëri

---

<sup>100</sup> El Vahidi, "Esbab Nuzul-Kur'an", fq. 739.

në përmbajtje. Kështu kanë theksuar Ibn Is'haku dhe Abdurahman ibn Zejd Eslemi<sup>101</sup>.

Nga ata që i kanë konsideruar këto dy sure si një sure të vetme për shkak të lidhshmërisë që kanë është edhe Ubej bin Kabi<sup>102</sup>.

Sufjan ibn Ujejne ka thënë: "Ne kishim një imam që i lexonte si një sure (suren Fil dhe Li'ijlaf) pa bërë ndarje mes tyre." Amër bin Mejmun el Evdij ka thënë: "Jemi falur një herë pas Omer bin Hatabit dhe në namazin e akshamit lexoi në rekatin e parë suren Tin, ndërsa në rekatin e dytë Fil dhe Kurejsh<sup>103</sup>."

Disa kanë komentuar se qëllimi këtu është për udhëtimin që kishin zakon të bënin Kurejshët në kohën e dimrit drejt Jemenit dhe në kohën e verës drejt Shamit për të bërë tregti dhe gjëra të tjera, e pastaj ktheheshin prej udhëtimit të sigurt në vendin e tyre për shkak të autoritetit që gëzonin te njerëzit si banorë të vendit të shenjtë të Allahut. Kush i njihte, i respektonte, madje kush u bashkëngjitej dhe udhëtonte me ta ishte i sigurt për shkak të tyre<sup>104</sup>. E tillë ishte gjendja e tyre kur udhëtonin në dimër dhe në verë, ndërsa për gjendjen e tyre në qytetin e Mekës i Lartmadhërishtmi ka thënë:

---

<sup>101</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 495.

<sup>102</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 429.

<sup>103</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 429.

<sup>104</sup> Ibn Uthejmin, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 331; Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Baguij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. II, fq. 1034.

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا جَعَلْنَا حَرَمًا آمِنًا وَيُنَظِّفُ النَّاسُ مِنْ  
حَوْلِهِمْ ۖ أَفَبِالْبَاطِلِ يُؤْمِنُونَ وَبِنِعْمَةِ اللَّهِ يَكْفُرُونَ

*“Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt (Mekën), ndërkohë që njerëzit rreth tij po grabiten.”<sup>105</sup>*

## Kuptimi i ajeteve

لِإِيلَافِ قُرَيْشٍ (١)

*1. (Shkatërrimin e njerëzve të elefantit Allahu e bëri) Për të mbrojtur fisin Kurejsh<sup>106</sup>*

Komentatorët kanë përmendur se pjesëza “lam” mund të ketë dy kuptime:

Pjesëza “lam” vjen si parafjalë, që është e lidhur në përmbajtje me suren e mëparshme. Këtë e kanë thënë Ibn Is’haku dhe Abdurahman ibn Zejd Eslemi. Sipas tyre, kuptimi i kësaj sureje është: “E penguam elefantin që të futet në Mekë dhe e shkatërruam ushtrinë e tij “për të mbrojtur fisin Kurejsh”<sup>107</sup>, domethënë për shkak të bashkimit dhe tubimit të tyre të sigurt në vendin e tyre<sup>108</sup>.

Ndërsa Ibn Xheriri ka komentuar: “Më e drejtë është se pjesëza “lam” është pjesëz që shpreh çudi. I Lart-madhërishmi sikur thotë: “Çudituni, magjepsuni për

<sup>105</sup> Kur'an, Ankebut: 67.

<sup>106</sup> Kur'an, Kurejsh: 1.

<sup>107</sup> Kur'an, Kurejsh: 1.

<sup>108</sup> Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, vëll. VIII, fq. 495.



udhëtimin e garantuar e të sigurt që bëjnë kurejshët dhe mirësinë Time ndaj tyre për këtë gjë"<sup>109</sup>, ngase muslimanët kanë arritur konsensus se kjo sure është në vete, është e ndarë nga surja e mëparshme<sup>110</sup>."

Allahu i shkatërroi ata që deshi dhe e madhështoi pozitën e Shtëpisë së Tij (Qabesë së bekuar) dhe banorët përreth saj (Kurejshët) në zemrat e arabëve, saqë i respektonin dhe nuk u bënë ndonjë të keqe në udhëtimet e tyre.

Zexhaxhi ka thënë: "Dhe kështu, i bëri si byk i ngrënë"<sup>111</sup> për t'i mbrojtur Kurejshët, d.m.th. u shkatërrua ushtria e elefantit dhe mbetën Kurejshët<sup>112</sup>."

Fer'a ka thënë: "Kjo sure është e lidhur me suren Fil ngase Allahu ka përmendur mirësinë që u dhuroi, e cila ishte shkatërimi i ushtrisë së elefantit, pastaj ka përmendur "Li'ijlafi kurejsh", d.m.th. se kjo që i bëme Ne ushtrisë së elefantit është mirësi e Jona ndaj Kurejshëve, të cilët udhëtonin për tregti dhe askush nuk i pengonte sepse njerëzit thoshin "këta janë banorët e shtëpisë së Allahut"<sup>113</sup>.

Imam Kurtubiu ka përmendur se Ibn Abasi për këtë ajet ka thënë: "Dy mirësi që Allahu ka garantuar për Kurejshët kanë qenë qëndrimi në Mekë dimrit dhe qëndrimi në Taif verës<sup>114</sup>."

---

<sup>109</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 497.

<sup>110</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 496.

<sup>111</sup> Kur'an, Fil: 5.

<sup>112</sup> E-sheukani, "Fethu-l Kadir", vëll. V, fq. 670.

<sup>113</sup> E-sheukani, "Fethu-l Kadir", vëll. V, fq. 669.

<sup>114</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 429-430.

إِيْلَافِهِمْ رِحْلَةَ الشَّنَاءِ وَالصَّيْفِ (٢)

## 2. për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë<sup>115</sup>

Fjala "i'jlafihim", që shqip përkthehet "për t'i mbrojtur, garantuar", në ajetin e dytë është shpjegim i fjalëve të ajetit të parë, prandaj i Lartmadhërishti ka thënë: "për t'i mbrojtur ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë"<sup>116</sup>. Kurejshët bënë tregti dy herë në vit; një herë verës për në tokat e Shamit<sup>117</sup>, ngase klima ishte më e ftohtë dhe zakonisht bëhej tregtia me fruta, kurse dimrit udhëtonin për në tokat e Jemenit, ku tregtohej me perime. Nga këto tregti ata fitonin dhe një pjesë të këtij fitimi e linin për shërbimet ndaj Qabesë së bekuar<sup>118</sup>.

Ibn Kutejbe thotë: "Arabët jetonin nga tregtia. Ata e bënë këtë dy herë në vit, dimrit për në Jemen e verës për në Sham. Sikur të mos e bënë këtë tregti, nuk do të kishin mundësi të qëndronin në Mekë dhe sikur të mos ishte siguria e afërsisë së Qabesë, nuk do të mund të lëviznin të lirë"<sup>119</sup>.

Toka e Mekës ishte një luginë e thatë, nuk ishte pjellore dhe Kurejshët ishin të varur nga tregtia që bënë dhe askush nuk i pengonte gjatë udhëtimit

---

<sup>115</sup> Kur'an, Kurejsh: 2.

<sup>116</sup> Kur'an, Kurejsh: 2. Ibn Kethir, vëll. "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 497.

<sup>117</sup> Sot Siria, Palestina, Libani dhe Jordania.

<sup>118</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 331.

<sup>119</sup> E-sheukani, "Fethu-l Kadir", vëll. V, fq. 670.

sepse thoshin “këta janë banorët e Qabesë dhe dashamirët e Shtëpisë së Allahut”. Allahu i urdhëroi ata që ta adhurojnë Atë, të vetmin që meriton të adhurohet, si shenjë respekti për këto mirësi. Kur erdhi Islami, nuk gjeti fis arab më të pasur dhe më krenar sesa fisin Kurejsh<sup>120</sup>.

Ibn Abasi thotë: "Qëndronin dimrit në Mekë për shkak të temperaturave të nxehta dhe verës në Taif për shkak të klimës së përshtatshme<sup>121</sup>."

Pastaj Allahu i Madhërishëm i udhëzoi që të jenë mirënjohës ndaj kësaj mirësie të madhe duke thënë:

فَلْيَعْبُدُوا رَبَّ هَذَا الْبَيْتِ (۳)

### ***3. Prandaj le të adhurojnë Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë)***<sup>122</sup>

Domethënë le të adhurojnë vetëm Atë sepse ua bëri këtë vend të shenjtë të sigurt dhe këtë faltore të shenjtëruar. Le të jetë pra ky falënderim për këto dhunti. Ajeti në fjalë ka lidhje me ajetin paraprak, prandaj ata obligohen që ta adhurojnë Zotin e Qabesë<sup>123</sup>. Adhurim do të thotë nënshtrim ndaj Allahut me dashuri dhe madhërim<sup>124</sup>.

---

<sup>120</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauj”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. II, fq. 1034.

<sup>121</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. 29, 30, fq. 375.

<sup>122</sup> Kur'an, Kurejsh: 3.

<sup>123</sup> Ibn Kethir, “Tefsir El-Kur'an El-adhim”, vëll. VIII, fq. 497.

<sup>124</sup> Ibn Utthejmini, “Tefsir Xhuzi Amme”, fq. 332.

Shejhul Islam Ibn Tejmije adhurimin e ka përkufizuar si vijon: "Emër përmbledhës i çdo gjëje që e do Allahu dhe është i kënaqur me të prej fjalëve, veprave të dukshme dhe të fshehta<sup>125</sup>."

"Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë)"<sup>126</sup> është lidhje e madhërimit me Qabenë, ngase kurejshët kishin idhuj që i adhuronin dhe madhëronin.

Zoti i kësaj faltoreje, Qabesë, është Ai:

الَّذِي أَطْعَمَهُمْ مِّنْ جُوعٍ وَآمَنَهُمْ مِّنْ خَوْفٍ (٤)

**4. i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike<sup>127</sup>**

Kuptimi i kësaj është se Allahu u dha mirësinë e sigurisë, prandaj u tha që ta adhurojnë vetëm Atë, pa i bërë shok askënd, duke mos adhuruar pos Tij asnjë idhull. Kush nuk i bindet këtij urdhri, Allahu e privon edhe nga siguria e kësaj bote dhe e botës tjetër.

Ata i goditi frika nga uria për shkak se toka e Mekës nuk kishte prodhime të vetat, ndërkohë që i kaploi edhe frika nga ushtria e elefantit. Allahu i Madhëruar ka sqaruar në këtë ajet dy faktorë, dy mirësi që ua dhuroi Kurejshëve: njëra është e dukshme, siguria, kurse tjetra është e fshehtë, të ushqyerit nga uria. Të ushqyerit në ditë urie është mbrojtje nga shkatërrimi,

---

<sup>125</sup> Shejh Islam ibn Tejmije, "Ubudije".

<sup>126</sup> Kur'an, Kurejsh: 3.

<sup>127</sup> Kur'an, Kurejsh: 4.

ndërsa siguria nga frika është një çështje e dukshme. Kur një vend është i rrethuar nga armiku, askush nuk mund të dalë jashtë, pra është diçka e dukshme. Allahu e ka bërë Mekën vend të sigurt, aty nuk lejohet të priten drunjte, as bari, as të merren sendet e humbura, nuk lejohet gjuetia e as derdhja e gjakut. Këto veçori nuk gjenden në ndonjë vend tjetër, as në Medinën e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

Edhe Medina ka haremin<sup>128</sup> e saj, zonën e shenjtë, por dallon shumë nga Meka. Në Mekë nuk i lejohet asnjë muslimani të hyjë pa veshur ihramet, përveç banorëve të saj, ndërsa në Medinë nuk ndodh një gjë e tillë. Në Mekë ndalohet prerja e drunjve dhe e barit pa dallim, ndërsa në Medinë lejohen disa veprime. Në këtë vend edhe gjallesat e tjera pos njeriut janë të sigurta. Sikur të mos ishte ngarkesë për besimtarët, Allahu do t'ua bënte edhe therjen e kafshëve të tjera haram, por ato janë të lejuara të theren brenda haremit (zonës së shenjtë)<sup>129</sup>. Këto mirësi Allahu i ka përmendur në fjalën e Tij:

أَوَلَمْ يَرَوْا أَنَّا جَعَلْنَا حَرَمًا آمِنًا وَيُنَظِّفُ النَّاسُ مِنْ حَوْلِهِمْ أَفَبِالْبَاطِلِ  
يُؤْمِنُونَ وَبِنِعْمَةِ اللَّهِ يَكْفُرُونَ

---

<sup>128</sup> Harem do të thotë zona e shenjtë, ku nuk lejohet hyrja e jomuslimanëve, derdhja e gjakut, prerja e pemëve apo edhe gjuetia etj.

<sup>129</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Sheukani, "Fer'h-l Kadir", etj., komentimi i sures Kurejsh.

***“Vallë, a nuk e shohin ata se si Ne u kemi dhënë atyre një vend të shenjtë e të sigurt (Mekën), ndërkohë që njerëzit rreth tij po grabiten? A mos vallë ata besojnë në gjëra të kota, ndërsa dhuntitë e Allahut i mohojnë?”<sup>130</sup>”***

Ibn Abasi për fjalën e Allahut: “... i Cili i ushqen ata në ditë urie dhe i siguron në ditë frike”<sup>131</sup>, ka thënë: “Këto dy mirësi ishin nga dua ja që bëri Ibrahim i alejhi selam kur tha<sup>132</sup>:

وَإِذْ قَالَ إِبْرَاهِيمُ رَبِّ اجْعَلْ هَذَا بَلَدًا آمِنًا وَارْزُقْ أَهْلَهُ مِنَ الثَّمَرَاتِ مَنْ آمَنَ مِنْهُمْ بِاللَّهِ وَالْيَوْمِ الْآخِرِ ۖ قَالَ وَمَنْ كَفَرَ فَأُمْتِعْهُ قَلِيلًا ثُمَّ أَضْطَرُّهُ إِلَىٰ عَذَابِ النَّارِ ۖ وَبِئْسَ الْمَصِيرُ

***“Dhe kur Ibrahim tha: “Zoti im, bëje këtë një qytet sigurie dhe banorët e tij, që besuan Allahun dhe jetën tjetër, furnizoji me lloje frutash”<sup>133</sup>. ”***

---

<sup>130</sup> Kur'an, Ankebut: 67.

<sup>131</sup> Kur'an, Kurejsh: 4.

<sup>132</sup> Kurtubiu, “El-Xhami Liahkam El-Kur'an”, vëll. 10, fq. 436.

<sup>133</sup> Kur'an, Bekare: 126.

## Mësime<sup>134</sup>

Në këtë kapitull shihet shfaqja e shenjave hyjnore sepse Allahu bëri që të shkatërrohet ushtria e elefantit për të ruajtur fisin Kurejsh dhe për të paralajmëruar lindjen e Pejgamberit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). I lartësuar qoftë Allahu!

Kapitulli sqaron mirësitë e Allahut ndaj fisit Kurejsh, për të cilat kërkohet që të jenë falënderues, se në të kundërtën do të veshin petkun e urisë dhe të frikës për shkak të mosfalënderimit.

Adhurimet i takojnë vetëm Allahut të Madhëruar.

---

<sup>134</sup> Sherif ef Ahmeti, “Kur’ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe”; Prof. Hasan I. Nahi “Kur’ani i madhërishtëm”, (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, “Tefsir El-Kur’an El-adhim”; El-Kurtubi, “El-Xhami Liahkam El-Kur’an”; Taberij, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur’an”; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, “Tefsiru El-Xhelalejn”; Imam El-Bagauij, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanij, “Fethu El-Kadir”; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, “Ed’uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur’an bi El-Kur’an”; Nasir Es-Sadij, “Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan”; Salih El-Uthejmin, “Tefsir El-Kur’an El-Kerim Xhuzi Amme”; Muhamed Sulejman El-Eshkar, “El-Kur’ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir”; Ebij Bekër El-Xhezairij, “Ejser Et-Tefasir Likelam el-Allij El-Kebir”; Uehbe Ezuhejli, “Et-Tefsir El-Munir”; Dr. Aid El-Karni, “Et-Tefsir El-Mujeser”; El Vahidij, “Esbabul En-Nuzul”; Muhamed El-Gazali, “Komenti tematik i Kur’anit Famëlartë”; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, “Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur’an El-Adhim”; Seid Kutb, “Fi Dhilali-l Kur’an”; Ebij El-Izi Eddimeshkij, “Sherh Akide Et-Tahauije”; Shejh Islam ibn Tejmiije, “Ubudije”; Ibn Kajim El-Xhevzijeh, “Zadul Mead”; Ibn Kajim El-Xhevzijeh, “Feuaid”; Emin Bahrami, “Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase”.

Allahu duhet falënderuar e lavdëruar për mirësitë e Tij, të cilat duhen shpenzuar për të arritur kënaqësinë e Allahut.

Të ushqyerit nga uria dhe siguria nga frika deri më sot asnjë shtet në botë nuk arriti t'ia ofrojë popullit të vet në formë të përsosur, vetëm feja islame. Këto dy mirësi të kësaj bote, ushqimin dhe sigurinë, Allahu i Lartmadhërishëm ua jep edhe jobesimtarëve ashtu siç ua dha edhe kurejshëve. Mund të themi se në atë kohë arabët anembanë gadishullit kishin një karakter të fuqishëm dhe gëzonin pavarësi dhe liri më të gjerë se të tjerët. Kjo bëri që ata të marrin përsipër bartjen e misionit islam dhe përhapjen e tij në Lindje dhe Perëndim. Parametri për të vlerësuar dashurinë e Allahut nuk janë dhuntitë e Tij, ngase Allahu edhe jobesimtarët nuk i privon nga të mirat e Tij. Por matës është të shikosh nëse Krijuesi yt po ta lehtëson kryerjen e adhurimeve ndaj Tij apo jo.

Begatia, mirësia më e madhe është që njeriu duhet ta falënderojë Allahun që e ka bërë nga robërit e Tij dhe prej umetit të Muhamedit, (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). O ju të bekuar! Pas saj nuk mbetet asgjë pos që njeriu ta lusë Zotin që mos t'ia marrë këtë mirësi derisa të vdesë.

Allahu i Madhërishëm thotë:

رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا وَهَبْ لَنَا مِنْ لَدُنْكَ رَحْمَةً ۗ  
إِنَّكَ أَنْتَ الْوَهَّابُ



*"Zoti ynë, mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, pse vetëm Ti je dhuruesi i madh."*<sup>135</sup>

Besimtari i drejtohet Allahut që të mos ia marrë mirësinë e besimit dhe Islamit derisa ta takojë Atë.

Siguria është ndër çështjet esenciale mbi të cilën ngrihet jeta njerëzore, por besimtari përpos sigurisë në këtë botë kujdeset edhe për sigurinë në Ditën e Gjykimit, atë ditë kur njerëzit do të dalin në tokën e mahsherit dhe patjetër që do t'i kaplojë frika. I siguruar në këtë ditë është ai që ia ka pasur frikën Allahut në këtë botë dhe ka respektuar urdhrat dhe ndalesat e Tij, ndërsa i frikësuar në këtë ditë është ai që nuk i ka përfillur mësimet e Allahut në jetën e kësaj bote.

Lus Allahun që të na përjetësojë dhuntinë e Islamit, sigurinë në vendin tonë dhe të na mundësojnë që të jemi falënderues ndaj dhuntive të Tij!

---

<sup>135</sup> Kur'an, Ali Imran: 8.

## SURJA EL-MA'UN (NEVOJTARËT)

Lloji: Mekase, nr. 107, ajete 7

Përmbajta: Atributet e mohuesit të Ditës së Gjykimit dhe hipokritit.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالذِّينِ (١) فَذَلِكَ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ (٢) وَلَا يَحْضُ  
عَلَىٰ طَعَامِ الْمِسْكِينِ (٣) فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ (٤) الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ  
سَاهُونَ (٥) الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ (٦) وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (٧)

*Në emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!*

- 1. A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?*
- 2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët*
- 3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit.*
- 4. Mjerë për ata, të cilët kur falen,*
- 5. janë të pakujdesshëm për namazet,<sup>136</sup>*
- 6. të cilët duan vetëm që të duken*
- 7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtareve.*

---

<sup>136</sup> Sipas komentuesve të Kur'anit, vargjet 4-5 bëjnë fjalë ose për hipokritët, të cilët falen vetëm kur janë me të tjerët dhe jo kur janë vetëm, ose për ata besimtarë që nuk falen rregullisht, por që e falin namazin jashtë kohës së tij apo e falin përgjithësisht në fund të kohës së tij, duke mos i kryer si duhet rregullat e tij dhe pa qenë të përqendruar në të. Gjithsesi, kërcënimi i përfshin të gjitha këto kategori, por atij që bën vetëm një pjesë të këtyre veprave i takon vetëm një pjesë prej kërcënimit, ndërsa atij që i bën të gjitha këto i takon kërcënimi i plotë.

## Emërtimi

Kjo sure quhet surja "Ma'un", surja e "Nevojtarëve", por në librat e tefsirit sheh se dijetarët e kanë emërtuar edhe me disa emra të tjerë, si "Dijnë"<sup>137</sup>, "Dita e Llogarisë", "Jetim", "Surja e Jetimit". Imam Shevkani ka thënë: "Ka gjithsej shtatë ajete. Është medinase sipas Ibn Abasit dhe Katades. Është mekase sipas A'tas, Xhabirit dhe një mendimi të Ibn Abasit. Hibetu Allah Mufesir Darir ka thënë<sup>138</sup>: "Gjysma e saj është shpallur në Mekë për Elas bin Vail Eshmiij dhe gjysma tjetër në Medinë për Abdullah bin Ubejin. Ibn Merdevej ka përmendur nga Ibn Abasi se ka thënë: "A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?"<sup>139</sup> ka zbritur në Mekë<sup>140</sup>."

Është transmetuar se Ibn Mes'udi është pyetur për domethënien e fjalës "el'maun" dhe ka thënë: "Me këtë nënkuptohen gjërat që njerëzit këmbëjnë mes tyre, si sëpata, enët, kovat, etj." <sup>141</sup>

---

<sup>137</sup> El-Eshkar, "Zubdet Tefsir min Fetul Kadir", fq. 823.

<sup>138</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsirul Munir", vëll. XV, fq. 818.

<sup>139</sup> Kur'an, Ma'un: 1.

<sup>140</sup> E-sheukani, "Fethul Kadir", vëll. V, fq. 673.

<sup>141</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 639.

## Shkaku i zbritjes

Mukatil dhe Kelbiju kanë thënë se ajeti i parë: *"A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?"*<sup>142</sup> ka zbritur për Elas bin Vail Eshmijun<sup>143</sup>.

Ibn Xhurejxhi ka thënë: "Ebu Sufjan bin Harbi therte çdo javë nga dy buallica. Një ditë i erdhi një jetim dhe i kërkoi pak, por ai e përzuri me shkopin e tij. Allahu shpalli ajetin<sup>144</sup>: *"A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë? Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët."*<sup>145</sup> Tre ajetet e para: *"A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë? Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit"*<sup>146</sup> janë shpallur në Mekë për Elas bin Vail Eshmij dhe Velijd bin Mugireh. Ndërsa pjesa e dytë, katër ajetet e fundit: *"Mjerë për ata, të cilët kur falen, janë të pakujdesshëm për namazet, të cilët duan vetëm që të duken dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve"*<sup>147</sup>. Ka zbritur për disa hipokritë të Medinës. Pra, gjysma e parë është mekase dhe gjysma e dytë medinase<sup>148</sup>.

---

<sup>142</sup> Kur'an, Ma'un: 1.

<sup>143</sup> El Vahidi, "Esbabu nuzul", fq. 741.

<sup>144</sup> El Vahidi, "Esbabu nuzul", fq. 741.

<sup>145</sup> Kur'an, Ma'un: 1-2.

<sup>146</sup> Kur'an, Ma'un: 1-3.

<sup>147</sup> Kur'an, Ma'un: 4-7.

<sup>148</sup> Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Tefasir", vëll. V, fq. 621.

## Kuptimi i ajeteve

أَرَأَيْتَ الَّذِي يُكَذِّبُ بِالْأَيْدِينَ (١)

*A e ke parë atë që mohon Ditën e Llogarisë?*<sup>149</sup>

Allahu i Madhërisëm këtu i drejtohet Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ngase Kur'ani i ka zbritur atij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) duke përfshirë edhe umetin e tij çdoherë. Ata që e mohojnë Ditën e Llogarisë, ditën e shpërblimit dhe të ndëshkimit, janë ata që e mohojnë ringjalljen dhe nuk besojnë atë me të cilën kanë ardhur Pejgamberët. Allahu i Madhëruar thotë:

أَإِذَا مِتْنَا وَكُنَّا تُرَابًا وَعِظَامًا أَإِنَّا لَمَبْعُوثُونَ (١٦) أَوْ آبَاءُنَا الْأَوَّلُونَ

*"(Ata thonë): "Vallë, kur të vdesim dhe të bëhemi eshtra e pluhur, a thua njëmend do të ringjallemi? Edhe paraardhësit tanë të lashtë?"*<sup>150</sup>

Nëse dëshiron ta shohësh atë që e mohon Ditën e Llogarisë, shiko veprat e tij, sepse do ta gjesh zemërfortë, që nuk mëshiron e nuk jep nga pasuria e tij. Si rezultat i një mosbesimi të tillë vijnë edhe pasojat.

فَذَلِكِ الَّذِي يَدْعُ الْيَتِيمَ (٢)

*2. Ky është ai që i dëbon ashpër jetimët*<sup>151</sup>

<sup>149</sup> Kur'an, Ma'un: 1.

<sup>150</sup> Kur'an, Safat: 16-17.

<sup>151</sup> Kur'an, Ma'un: 2.

Do të thotë se ky është ai që abuzon me jetimin, të drejtën, nuk e ushqen, nuk sillet mirë ndaj tij<sup>152</sup> dhe nuk ka mëshirë ndaj bonjakut. Jetim është ai që i ka vdekur i ati pa arritur moshën e pjekurisë dhe ka nevojë që të mbështetet.

Do të gjesh shumë hadithe profetike që inkurajojnë për bamirësinë ndaj jetimëve. Në të kundërtën gjen këtë kategori Allahu na ruajt të cilët i dëbojnë ashpër jetimët. Fjala “*de’a*” do të thotë dëbim i ashpër, që e përzë me vrazhdësi me forcë. Allahu i Lartmadhëruar thotë në suren Tur:

يَوْمَ يُدْعَوْنَ إِلَىٰ نَارِ جَهَنَّمَ دَعَاً

***“Atë ditë, ata do të hidhen me forcë në zjarrin e xhehenemit<sup>153</sup>.”***

Kjo është arsyeja që do t'i gjesh këta njerëz që nëse jetimi u kërkon diçka apo u flet, e dëbojnë, e përzënë ashpër dhe nuk e mëshirojnë<sup>154</sup>.

Ibn Abasi ka thënë: "Jetimit nuk ia jep të drejtat e tij<sup>155</sup>."

Muxhahidi ka thënë: "Jetimit nuk ia jep të drejtat e tij, as nuk e ushqen<sup>156</sup>."

وَلَا يَحُضُّ عَلَىٰ طَعَامِ الْمَسْكِينِ (٣)

***3. dhe nuk nxit që t'i jepet ushqim të varfrit<sup>157</sup>.”***

---

<sup>152</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. XIV, fq. 468.

<sup>153</sup> Kur'an, Tur: 13.

<sup>154</sup> Ibn Uttejmini, "Tefsir xhuzi amme", fq. 326.

<sup>155</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. 29-30, fq. 377-378.

<sup>156</sup> Po aty.

<sup>157</sup> Kur'an, Ma'un: 3.

Atributi i dytë i atyre që nuk besojnë në Ditën e Llogarisë është se nuk nxisin t'i mëshirojnë të varfrit që kanë nevojë për ushqim, ngase zemrat e tyre janë të forta si guri. Pra, këta nuk kanë mëshirë as për jetimin e as për të varfrin ngase zemra e tij është e ngurtë<sup>158</sup>.

Imam Kurtubiu ka thënë: “Qortimi në këtë citat nuk është gjithëpërfshirës sepse nuk përfshin atë që nuk ka mundësi, por përfshin ata që nga koprracia ankohen dhe nuk i ndihmojnë të varfrit. Kuptimi do të jetë nuk japin kur kanë mundësi e as që nxisin të tjerët kur u vështrësohet gjendja<sup>159</sup>.”

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ (٤)

#### 4. Mjerë për ata, të cilët kur falen<sup>160</sup>

“*Vejlun*” do të thotë “Mjerë” Kjo shprehje është përmendur shumë herë në Kur'an. Ajo ka disa kuptime<sup>161</sup>: dënim, shkatërrim dhe luginë në xhehenem.

“*Lilmusalin*”, të cilët kur falen<sup>162</sup>, pra ata që janë prej namazlinjve dhe i janë përkushtuar faljes së namazit, por më pas e neglizhojnë namazin ose e braktisin në tërësi, siç ka komentuar Ibn Abasi, apo duke mos e kryer në kohën e përcaktuar fetarisht, duke i falur

<sup>158</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi amme", fq. 327.

<sup>159</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. 10, fq. 438.

<sup>160</sup> Kur'an, Ma'un: 4.

<sup>161</sup> E-sheukani, "Fethul Kadir", vëll. V, fq. 674.

<sup>162</sup> Kur'an, Ma'un: 4.

jashtë kohës së paraparë, sikundër kanë komentuar Mesruku dhe Ebu Duha<sup>163</sup>.

Ky citat mund ta hutojë injorantin duke thënë se Allahu i ka qortuar ata që falen me “vejl”. Por përgjigjen e gjejmë në citatin tjetër, në kapitullin Mudethir, ku tregohet se mosfalja e namazit është shkak për të hyrë në xhehenem.

مَا سَأَلَكُمْ فِي سَفَرٍ (٤٢) قَالُوا لَمْ نَكُ مِنَ الْمُصَلِّينَ

***"Çka ju solli ju në Sekar? Ata thonë: "Nuk kemi qenë prej atyre që faleshin (që bënin namaz)"<sup>164</sup>.***

Përgjigjja është e qartë dhe këtë e sqaron ajeti vijues *"janë të pakujdesshëm për namazet"*<sup>165</sup>, të cilët duan vetëm që të duken (sa për sy e faqe)<sup>166</sup>.

Këta janë munafikët - hipokritët. Përmendëm këtë përgjigje me dobësinë e të hutuarit ngase zenadikët - të dalët nga feja, lënien e namazit e argumentojnë me këtë ajet<sup>167</sup>.

الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ (٥)

***5. "janë të pakujdesshëm për namazet"*<sup>168</sup>**

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është pyetur për *"janë të pakujdesshëm për*

---

<sup>163</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 631.

<sup>164</sup> Kur'an, Mudethir: 42, 43.

<sup>165</sup> Kur'an, Ma'un: 5.

<sup>166</sup> Kur'an, Ma'un: 6.

<sup>167</sup> Esh-Shenkiti, "Edvail Bejan", vëll. VI, fq. 386.

<sup>168</sup> Kur'an, Ma'un: 5.



*namazet*” dhe ka thënë se “*është për qëllim, humbja e kohës*<sup>169</sup>”.

Ibn Abasi dhe disa dijetarë të tjerë kanë komentuar se këtu aludohet për munafikët-hipokritët, të cilët falen vetëm kur i shohin të tjerët dhe nuk falen kur janë vetëm<sup>170</sup>.

Ata ibn Dinari ka thënë: "Qoftë lavdëruar singerisht Allahu i Madhërishtëm, i Cili ka thënë: "*janë të pakujdesshëm për namazet*"<sup>171</sup> e nuk ka thënë "*fi salat-ificim sahun*", në namazin e tyre janë të pakujdesshëm<sup>172</sup>."

Ibn Uehebi transmeton nga Maliku se Ibn Abasi ka thënë: "Sikur të kishe thënë "*fi salatihim sahun*", "*në namazin e tyre janë të pakujdesshëm*", do të ishte qortim për besimtarët, por ka thënë "an salatihim-për namazet".

Sepse besimtari ka mundësi të harrojë në namaz dhe kjo ndodh me të gjithë, i ndodhi edhe Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), por jo që të jetë i pakujdesshëm ndaj tij.

Munafikët ose hipokritët janë të pakujdesshëm ndaj namazit, të cilin ose e vonojnë nga koha e parë dhe e falin në kohën e fundit të lejuar, dhe e bëjnë çdo herë apo zakonisht, ose janë të pakujdesshëm ndaj namazit duke mos e kryer në përputhje me kushtet dhe

---

<sup>169</sup> Shënon Bejhakui në "Sunen", 214/2.

<sup>170</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 632.

<sup>171</sup> Kur'an, Ma'un: 5.

<sup>172</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. XX, fq. 212.

rregullat e parapara; ose e falin pa përlësi dhe pa analizuar rreth domethënies së tij. Kjo shprehje i përfshin të gjitha këto që u përmendën, mirëpo kush ka vetëm disa cilësi të tilla, ka marrë vetëm një pjesë të qortimit të ajetit. Kush i ka të gjitha cilësitë e tilla, e ka marrë komplet qortimin e ajetit dhe e ka arritur hipokrizinë e plotë në vepra (nifak el-amelij). Në dy koleksionet e sakta është konfirmuar se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Ai është namazi i munafikut, ai është namazi i munafikut, ai është namazi i munafikut. Kjo ngase ai e pret diellin derisa të gjendet mes dy brirëve të djallit, atëherë ngrihet dhe shpejt e shpejt i fal katër rekate, ku Allahun e përmend shumë pak<sup>173</sup>.”*

Ky është namazi i ikindisë, kur vonohet deri në mbarim të kohës së tij, e cila është koha e urryer për t'u falur. Vetëm atëherë personi në fjalë ngrihet dhe e fal me shpejtësi pa përqendrim, pa përkushtim dhe pa i bërë si duhet edhe lëvizjet. Për këtë i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë se shumë pak e përmend Allahun, çka aludon për atë se si ngrihet ta falë namazin vetëm për t'u treguar para njerëzve e jo për hir të Allahut. Personi i këtillë është sikur nuk është falur fare. Në citatin tjetër i Lartmadhërishtmi ka thënë:

إِنَّ الْمُنَافِقِينَ يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَادِعُهُمْ وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كَسَالَىٰ يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا

---

<sup>173</sup> Buhariu, "Fet'hul Bari", vëll. VI, fq. 386; Muslimi, vëll. I, fq. 434.

*“Në të vërtetë, hipokritët përpiqen të mashtrojnë Allahun, por është Ai që i mashtron ata. Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t’u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak<sup>174</sup>.”*

Por kush janë këta që ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm?

الَّذِينَ هُمْ يُرَاءُونَ (٦)

*6. “të cilët duan vetëm që të duken (sa për sy e faqe)<sup>175</sup>.”*

Për fjalën “juraun-sa për sy e faqe”, komentatorët kanë dhënë disa sqarime:

Katade ka thënë: “Harron a e ka falur apo jo”.

Disa të tjerë kanë thënë: “Nuk shpresojnë në shpërblim nëse e falin e as nuk i frikësohen ndëshkimit nëse nuk falen.”

Muxhahidi ka thënë: “Janë të pakujdesshëm, neglizhojnë”.

Hasen el Basri ka thënë: “Është ai i cili e fal (namazin), sa për sy e faqe, e nëse i ka ikur, nuk bëhet merak<sup>176</sup>.”

---

<sup>174</sup> Kur'an, Nisa: 142.

<sup>175</sup> Kur'an, Ma'un: 6.

<sup>176</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. II, fq. 1035.

Hipokritët edhe kur bëjnë adhurime shtiren, adhurojnë sa për sy e faqe që të kenë ndikim në shoqëri. Nuk kanë për qëllim të afrohen tek Allahu. Hipokriti jep lëmoshë që njerëzit të thonë se po jep, e zbukuron namazin për të thënë njerëzit sa mirë që falet. Afrohen tek njerëzit me adhurim ndaj Allahut. Këta janë munafikët, hipokritët. Ndërsa ai që falet për njerëz, si p.sh. përulet para ndonjë mbreti apo bën sexhde para tij, ky është mushrik<sup>177</sup>. Allahu e ka privuar nga xheneti dhe dënimi për të do të jetë zjarri. Ndërsa hipokriti falet për Allah duke u shtirur që ta lavdërojnë njerëzit për këtë. Allahu i përshkruan ata duke thënë:

*“Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë...<sup>178</sup>”*

Pra këta janë që ndaj namazit të tyre janë të pakujdesshëm dhe këtë e bëjnë sa për sy e faqe. Ai i cili lexon Kur'an me zë, mundohet ta lexojë më mirë, e stolis namazin e tij vetëm e vetëm për ta përmendur njerëzit, të gjithë hyjnë në grupin e hipokritëve. Njeriu i cili bën vepra vetëm sa për sy e faqe një ditë do t'ia zbulojë Allahu, se nuk ka qenë i sinqertë, qoftë herët apo vonë.

---

<sup>177</sup> Politeistë janë ata që adhurojnë idhujt dhe me adhurimet e tyre i bëjnë Allahut rival.

<sup>178</sup> Kur'an, Nisa: 142.

Realiteti i dyfaqësisë është të kërkuarit e interesave të kësaj bote me adhurim. Esenca e tij është kërkimi i pozitës në zemrat e njerëzve.

Ajo mund të jetë:

- heshtja, dëshiron me të pozitë dhe lavdërim;
- dyfaqësia me fjalë;
- dyfaqësia në rroba, për t'u dukur më asket;
- dyfaqësia në namaz dhe lëmoshë apo e hijeshon namazin për ta parë njerëzit<sup>179</sup>.

Imam Ahmedi përkitazi me çështjen e rijasë-bërjen e gjërave për sy e faqe ka transmetuar prej Abdullah ibn Amrit se si i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): *“Kush u flet, u lavdërohet njerëzve me punët e veta, Allahu do ta poshtërojë dhe do ta ulë në sytë e njerëzve<sup>180</sup>.”*

Kur jemi duke folur për kryerjen e një veprë për sy e faqe, duhet përmendur se nuk konsiderohet e këtij lloji vepra që bën një person për hir të Allahut dhe njerëzit marrin vesh për të dhe kjo e gëzon personin në fjalë.

Farzet, obligimet, nuk duhet të kuptohen se në to ka dyfaqësi, ngase ato duhen patjetër të bëhen haptazi.

وَيَمْنَعُونَ الْمَاعُونَ (٧)

**7. dhe nuk u japin ndihmë nevojtareve (as hua).<sup>181</sup>**

---

<sup>179</sup> Kurtubiu, “El-Xhami Liahkam El-Kur'an”, vëll. X, fq. 439.

<sup>180</sup> Ahmedi, vëll. II, f. 212.

<sup>181</sup> Kur'an, Ma'un: 7.

D.m.th. nuk e kanë kryer adhurimin ndaj Allahut ashtu si duhet dhe as që kanë qenë bamirës ndaj krijesave, bile nuk i kanë ndihmuar as me huazimin e gjërave që kanë mundur t'i shfrytëzojnë, edhe pse do t'ua kthenin pas një kohe, e të mos përmendim ndihmën me se nuk u kanë ndihmuar lekët apo lëmosha të tjera.

Për domethënien e fjalës “ma'un” janë dhënë disa mendime, edhe pse në kuptim janë të përafërta.

Aliu radijAllahu anhu ka thënë se është zekati<sup>182</sup>.

Abdullah bin Mesudi ka thënë: “Me këtë nënkuptohen gjërat që njerëzit i këmbejnë mes vete, si: sëpata, enët, kovat etj.<sup>183</sup>, ato që nuk lejohet të mos jepen, si uji, kripa, zjarri<sup>184</sup>.”

Ibn Omeri ka thënë: “Ndalimi i së vërtetës<sup>185</sup>.”

Ibn Uthejmini për ajetin: **“dhe nuk u japin ndihmë nevojtarëve (as hua)”**<sup>186</sup> ka thënë: “Nuk japin çfarë duhet të japin (që njerëzit kanë nevojë) nga enët.”

P.sh. vjen dikush dhe të thotë: “kam nevojë për një kovë”, ndonjë enë që të pi me të apo llambë elektrike. Dhe nuk ia jep edhe kjo është diskreditim.

Mosdhënia nevojtarëve ndahet në dy grupe: kur njeriu mëkaton dhe kur nuk mëkaton, por privohet

---

<sup>182</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauj”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. II, fq. 1035.

<sup>183</sup> Taberiju, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. xxiv, f. 639.

<sup>184</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauj”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. II, fq. 1035.

<sup>185</sup> Taberiju, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXX, fq. 373.

<sup>186</sup> Kur'an, Ma'un: 7.

nga të mirat. Ajo që obligohet të jepet dhe në rast se njeriu nuk e jep, mëkaton. Por ajo që me të nuk obligohet në rast se nuk e jep, nuk mëkaton por privohet nga të mirat.

P.sh. vjen një person dhe të thotë: "Më jep ujë të pi, se nëse nuk pi, do të vdes", në këtë rast dhënia e ujit është obligim dhe në rast se njeriu nuk i jep ujë mëkaton. Derisa disa dijetarë kanë përmendur se në këtë rast ky është garantues ose në të kundërtën duhet të paguajë shpagim, ngase ky është shkaktar në këtë rast për vdekjen e tij dhe obligohet të japë atë çfarë ka kërkuar. Njeriu duhet të shikojë në veten e tij a i ka këto cilësi apo jo? Që e ka neglizhuar namazin apo e ka lënë në tërësi dhe nuk u ka dhënë të tjerëve atë që ka pasur për obligim, le të pendohet dhe le të kthehet tek Allahu ose në të kundërtën do të përgëzohet me fjalën "vejl-mjerë". Allahu na ruajt nga një gjendje e tillë. E nëse është i pastër nga këto cilësi, e përgëzojmë me të mira. Leximi i Kur'anit nuk është vetëm për të bërë me të ibadet, por edhe për t'u edukuar me të. Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë për Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të): "Moralit i tij ka qenë Kur'ani."<sup>187</sup> Ahlaku, etika e tij që ka marrë nga Kur'ani<sup>188</sup>.

---

<sup>187</sup> Shënon Muslimi, kapitulli namazi i natës, fq. 139.

<sup>188</sup> Ibn Uttejmini, "Tefisr xhuzi amme", fq. 329-330.

### Mësimet<sup>189</sup>

- Surja El-Ma'un, megjithëse e shkurtër, e flak përku-shtimin e shtirur dhe konsideron se të ndihmuarit e atyre që janë në nevojë është kusht fundamental i besimit, ashtu sikundër është kusht fundamental falja e namazit me përpikëri të plotë. Surja El-Ma'un i kërcënon ata që e pengojnë bamirësinë dhe ndihmën për ata që kanë nevojë.
- Kjo sure aludon për vërtetimin e besimit në ringja-llje, shpërblim dhe ndëshkim.
- Allahu i ka cilësuar jobesimtarët dhe dyfytirëshat me katërtribute: koprracinë, lënia e namazit, dyfaqësia, mosdhënia e zekatit.

---

<sup>189</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishtëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanij, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Uthejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Alij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-l Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkij, "Sherh Akide Et-Tahauije"; Shejh Islam ibn Tejmije, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhezvzjeh, "Zadul Mead"; Ibn Kajim El-Xhezvzjeh, "Feuaid"; Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase".



- Çdo zemër që është e zbrazët nga besimi në ringjallje, shpërblimi dhe ndëshkimi është krijesa më e keqe, nuk ka dobi nga ajo.
- Ndëshkimi, kërcënimi për ata që e neglizhojnë namazin dhe nuk kanë dert se në çfarë kohe e falin atë është shenjë e hipokrizisë. Allahu na ruajt nga ky veprim.
- Besimi është vëlla i drejtësisë dhe i përmbushjes së nevojave të atyre që janë nevojtarë, kurse paganizmi është vëlla i egoizmit, mostolerancës dhe arrogancës.
- Dënimi do t'i takojë atij që e ha pasurinë e jetimit, që nënvlerëson jetimin, e nënçmon dhe nuk i jep të drejtat që duhet t'i gëzojë.
- Mosdhënia e atyre që kanë nevojë është shenjë e hipokritëve, ndërsa ai që nuk u jep nevojtarëve prej muslimanëve nuk është nga ata.
- Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *"Kush nuk interesohet për çështjet e besimtarëve nuk është nga ata."*
- Dije se gjëja më e mirë që t'i bën për Allah është ajo vepër që nuk e di askush pos Allahut, e pastaj mundohesh edhe vetë ta harrosh për ditën që do ta takosh Allahun. E kur ta takosh Allahu, do të të nderojë kur të ta shpalosë atë vepër e të të shpërblejë për të. Në këtë botë ka njerëz që nëse ia bën një të mirë kurrë nuk ta harron derisa ta kompensojë me një të mirë tjetër. E si është me Allahun e Madhëruar, që është i lartësuar nga ky shembull, që sikur çdo gjë që ti

dëshiron, ta jep dhe nuk pakëson asgjë nga pasuria e Tij?! Kush bën vepra vetëm sa për sy e faqe, një ditë do t'ia shpalosë Allahu se nuk ka qenë i sinqertë, qoftë herët apo vonë.

- Namazi, namazi, namazi! Nëse të kaplon përtacia dhe muezini të thërret për namaz dije se meleku që ke në anën e djathtë t'i shkruan hapat që do t'i bësh për në xhami për ta kënaqur Allahun e Madhëri-shëm. Ato gjurmë edhe pse do të fshihen nga toka, do të mbesin për ditën që do ta takosh Allahun e Madhëruar. Ky është kuptimi i ajetit.

إِنَّا نَحْنُ نُحْيِي الْمَوْتَىٰ وَنَكْتُبُ مَا قَدَّمُوا وَآثَارَهُمْ ۚ  
وَكُلَّ شَيْءٍ أَحْصَيْنَاهُ فِي إِمَامٍ مُّبِينٍ

*"Sigurisht, Ne i ringjallim të vdekurit dhe shënojmë veprat që kanë bërë dhe gjurmët e (punëve të) tyre. Ne e kemi llogaritur çdo gjë në një libër të qartë<sup>190</sup>."*

Kjo fe nuk është vetëm një manifestim i ritualeve, të cilat nuk mjaftojnë nëse nuk burojnë nga sinqeriteti, për shkak të të cilit lënë gjurmë në zemër dhe shtyjnë për vepra të mira. Besimi në Ditën e Llogarisë nuk është një fjalë që thuhet me gjuhë, por një ndryshim në zemër që shtyn për të bërë bamirësi ndaj vëllezërve nevojtarë në mbikëqyrjen dhe përkujdesen ndaj tyre. Allahu nuk dëshiron prej njerëzve vetëm fjalë, por dëshiron që të kenë vepra që i vërtetojnë fjalët

---

<sup>190</sup> Kur'an, Jasin: 12.

ose në të kundërtën do të jenë të kota, pa peshë, e as që do të merren në konsideratë. Imma Sharavij ka thënë: "Nëse sheh një të varfër në vendet e muslimanëve, dije se atje në mesin e tyre është një i pasur që ka ngrënë pasurinë e tij." Cilësitë e përmendura në këtë sure sjellja e keqe me jetimin, lënia e namazit, dyfaqësia, koprracia në pasuri- janë shenja të hipokritëve që nuk i posedon besimtari i sinqertë. Nëse besimtari vesh diçka nga këto cilësi, qortimi bie mbi të pavarësisht nga lloji i përmendur dhe madhësia e dyfaqësisë<sup>191</sup>. Allahu ka thënë:

إِنَّ الْمُنَافِقِينَ يُخَادِعُونَ اللَّهَ وَهُوَ خَادِعُهُمْ وَإِذَا قَامُوا إِلَى الصَّلَاةِ قَامُوا كَسَالَىٰ يُرَاءُونَ النَّاسَ وَلَا يَذْكُرُونَ اللَّهَ إِلَّا قَلِيلًا

*"Kur ata ngrihen për namaz, ngrihen me përtesë, vetëm sa për t'u dukur para botës dhe Allahun e përmendin fare pak<sup>192</sup>."*

وَلَا يُنْفِقُونَ إِلَّا وَهُمْ كَارِهُونَ

*"Dhe nuk shpenzojnë (nga pasuria), veçse në mënyrë përbuzëse<sup>193</sup>."*

O Zot, na ruaj nga dyfaqësia, na mundëso faljen e namazit deri në takimin me Ty dhe mundësona t'i ndihmojmë jetimët dhe nevojtarët!

<sup>191</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 439.

<sup>192</sup> Kur'an, Nisa: 142.

<sup>193</sup> Kur'an, Teube: 54.

## SURJA EL-KEUTHER (TË MIRAT E SHUMTA)

Lloji: Mekase, nr. 108, ajete 3

Përmbajtja: Mirësitë e Allahut ndaj Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ (١) فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحِرْ (٢) إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ (٣)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!*

*1. Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira<sup>194</sup>,*

*2. andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!<sup>195</sup>*

*3. Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë (farësosur)<sup>196</sup>.*

---

<sup>194</sup> “Shumë të mira”: në tekstin origjinal thuhet “El Keuther”. Kjo fjalë, sipas disa transmetimeve, tregon një lumë në xhenet, të cilin Allahu i Madhëruar ia ka premtuar si dhuratë Profetit Muhamed (a.s.), për ta kompensuar dhe ngushëlluar për gjithçka që ka hequr për çështjen e Tij. Komentet tradicionale thonë se ajo tregon pozitën e Profetit (a.s.) në xhenet, ku do të vendoset në vendin më të lartë (el uesila) dhe do të kënaqet me mirësitë e dritës hyjnore.

<sup>195</sup> Ky varg është shumë i rëndësishëm për sa i përket praktikës së ritualeve në ditën e Kurban Bajramit, e cila festohet në ditën e dhjetë të haxhillëkut dhe kujton provën, në të cilën Allahu i Madhërishtëm vuri Ibrahimin (a.s.). Vargu përshkruan radhën e kryerjes së riteve: në fillim falet namazi i Bajramit, pastaj theret kurhani.

<sup>196</sup> “Fatprerë”: në tekstin origjinal thuhet “ebter”, që do të thotë “pa bisht”. Kjo shprehje ishte epitet ironik që arabët ia vinin dikujt që nuk kishte djem. Sipas disa transmetimeve, biri i Profetit Muhamed (a.s.), Kasimi, vdiq në një moshë fare të

## Emërtimi

Fjala "keuther" rrjedh nga fjala arabe "kethere-të mira të shumta". Është sure medinase sipas Ekremes, Hasenit, Muxhahidit, Katades, por mekase sipas mendimit të shumicës, si Ibn Abasit, Kelbijut dhe Mukatilit. Ibn Merdevjhu nga Ibn Abasi, Ibn Zubejri dhe Aishja kanë thënë se kjo sure është shpallur në Mekë.

## Shkaku i zbritjes

Ibn Abasi ka thënë<sup>197</sup>: "U shpall për shkak të Elas bin Vail Esehmi, kur ai pa që Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) po dilte nga xhamia dhe ai po hynte tek dera e fisit Benij Sehm. Disa Kurejshë po bisedonin. Kur Elasi hyri tek ata, e pyetën: "Me kë po bisedoje?" Tha: "Me atë, farësosurin", duke pasur për qëllim Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), të cilit më parë i kishte vdekur i biri, Abdullahu. Arabët atë që nuk kishte fëmijë e quanin farësosur. Dhe Allahu zbriti këtë sure."<sup>198</sup>

Fëmijët e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)<sup>199</sup>

---

njomë dhe, për këtë, një nga armiqtë e Profetit (a.s.) e quajti atë fatprerë, duke aluduar se edhe feja që ai predikonte, do të ishte e tillë.

<sup>197</sup> Shënuar nga Ibn Asakir në historinë e Damaskut, 3/125.

<sup>198</sup> El Vahidi, "Esbabu Nuzul", fq. 743.

<sup>199</sup> Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Zadul Mead", vëll. I, fq. 100.

Fëmija i parë është Kasimi, i cili vdiq fëmijë. Pastaj Zejnebja, e cila thuhet se ka qenë më e madhe se Kasimi, pastaj Rukija, Umu Kulthumi dhe Fatimja. Ibn Abasi ka thënë: "Rukija ishte më e madhja, ndërsa Umu Kulthumi më e vogla". Pastaj Abdullahu ka mospajtime a ka lindur para apo pas shpalljes, por disa kanë saktësuar se ka lindur pas shpalljes. Më pas ka lindur Ibrahim i në Medinë, nga gruaja Maria kibtijë (egjiptiane e krishterë), në vitin e tetë pas hixhretit. Ka mospajtim në lidhje me faktin se a i është falur xhenazja apo jo. Të gjithë fëmijët kanë vdekur para Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), përveç Fatimes, e cila ka vdekur gjashtë muaj pas vdekjes së Resulullahut, sipas transmetimit të Aishes, Allahu qoftë i kënaqur me të. Të gjithë fëmijët kanë pasur për nënë Hatixhen, përveç Ibrahimit, i cili ka qenë fëmija i Maries.

## **Kuptimi i ajeteve**

إِنَّا أَعْطَيْنَاكَ الْكَوْثَرَ (١)

*Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty shumë të mira*<sup>200</sup>

Allahu i thotë të Dërguarit të Tij: "O Muhamed, ne të dhamë shumë të mira."

---

<sup>200</sup> Kur'an, Kuthër: 1.

Fjala "keuther" ka disa kuptime. Imam Kurtubiu në "Tefsirin" e tij ka përmendur gjashtëmbëdhjetë kuptime; dy të parat janë të sakta duke u bazuar në hadithet autentike: lumë në xhenet, pellgu haud, pejgamberllëku dhe libri, Kur'ani, Islami, lehtësimi i Kur'anit dhe i sheriatit, sahabët dhe umeti, altruizmi<sup>201</sup>, lartësimi i dhikrit (përmendja e Allahut), drita e zemrës, shefati (ndërmjetësimi i Pejgamberit paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), mrekullitë e Allahut, fjala 'La ilahe il-Allah', feja, pesë namazet, diçka madhështore.

Muslimi ka transmetuar në "Sahihun" e tij prej Enesit se ka thënë: "I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishte duke qëndruar me ne në xhami dhe për disa çaste dremiti, e pastaj e ngriti kokën i buzëqeshur. Ne e pyetëm: "O i Dërguari i Allahut, pse qeshe?" Tha: *"Pak më parë m'u shpall një sure, Keuther"*. Pastaj tha: *"E dini ç'është Keutheri?"* Ne iu përgjigjëm: "Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë." I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) tha: *"Ai është një lumë, një basen në të cilin do të pijë umeti im në Ditën e Kiametit. Enët e tij janë në numër sa yjet në qiell. Një nga umeti im do të pengohet nga baseni e unë do të them: -O Zot, edhe ky është prej umetit tim,*

---

<sup>201</sup> Gatishmëria për të flijuar të mirën vetjake për të mirën e të tjerëve, dëshira e synimi për t'i bërë mirë tjetrit.

*por Zoti do të më thotë: -Ti nuk di çfarë gjërash ka shpikur ky pas teje."*<sup>202</sup>

Imam Ahmedi ka transmetuar prej Enesit se një person e ka pyetur të Dërguarin e Allahut: "O i Dërguari i Allahut, ç'është Keutheri?" Ai ka thënë: "*Ky është një lumë në xhenet, që ma ka dhënë Zoti im. Ai është më i bardhë se qumështi, më i ëmbël se mjalti dhe në të ka shpendë që kanë qafa si të deveve*". Atë çast Omeri tha: "O i Dërguari i Allahut, këta shpendë qenkan me fat!" I Dërguari i Allahut subhanehu ue teala ka thënë: "*O Omer, ai që do t'i hajë është edhe më me fat se ato.*"<sup>203</sup>

Buhariu ka transmetuar prej Se'id ibn Xhubejrit se Ibn Abasi për nocionin keuther ka thënë: "Ka për qëllim të mirat që ia ka dhënë Allahu të Dërguarit të Tij, Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)". Ky mendim mbështetet duke u bazuar në aspektin gjuhësor të domethënies së keutherit.

Ebu Bishri ka thënë: "E pyeta Sei'd ibn Xhubejrin: "Disa thonë se keutheri është një lumë në xhenet?" Sei'd më tha: "Lumi, i cili është në xhenet, është një pjesë e të mirave të cilat Allahu ia ka dhënë Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)".<sup>204</sup>

---

<sup>202</sup> Shënon Muslimi, vëll. I, fq. 300.

<sup>203</sup> Ahmedi, vëll. IV, fq. 220.

<sup>204</sup> Buhariu, "Fethul-Bari", vëll. VIII, fq. 603.



Po ashtu është transmetuar prej Sei'd ibn Xhubejrit, se si Ibn Abasi ka komentuar se keuther do të thotë të mira të shumta<sup>205</sup>.

Prej të mirave që Allahu i ka dhënë në këtë botë janë të shumta, por disa nga ato janë përmendur, ashtu siç kanë shënuar në dy Koleksionet e sakta prej hadithit të Xhabirit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, se Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *“Më janë dhënë pesë gjëra që nuk i janë dhënë asnjë Pejgamberi para meje: jam ndihmuar me frikë ndaj armikut në distancë një muaj, më është bërë toka xhami dhe e pastër (për falje), çdo pjesëtar i umetit tim që e zë namazi le ta falë, më është dhënë shefati (ndërmjetësimi), më është lejuar plaçka e luftës, Pejgamberët dërgoheshin tek populli i tyre, ndërsa unë jam dërguar për mbarë njerëzimin<sup>206</sup>.”*

Imam Ahmedi ka transmetuar prej Enesit se i Dërguari i Allahut ka thënë: *“Hyra në xhenet dhe pashë një lumë me brigje prej tendash prej margaritari. E preka me dorë shtratin ku rridhte lumi, ku ja, ai ishte një misk me erë të jashtëzakonshme. E pyeta Xhibrilin e i thashë: -O Xhibril, ç'është ky lumë? M'u përgjigj: -Ky është Keutheri, që ta ka dhënë Allahu.”<sup>207</sup>*

Keutheri është lumi që ka dy gryka që rrjedhin në pellgun haud, gjatësia dhe gjerësia e të cilit janë sa

---

<sup>205</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. II, f. 67.

<sup>206</sup> Shënon Buhariu, kapitulli i tejemumit, 335. Muslimi, kapitulli i namazit, xhamitë vendet për falje, 3/521.

<sup>207</sup> Ahmedi, vëll. III, fq. 103.

një muaj, uji i tij është më i bardhë se qumështi e më i ëmbël se mjalti, më i ftohtë se bora, enët e tij janë sa yjet në qiell në numër dhe ndriçim, aroma e tij është më e këndshme se miski. Ai që ka ecur në këtë dynja sipas udhëzimeve të Muhamedit alejhi selam do të pijë në Ditën e Kiametit nga haudi i tij. Ai që pi nga haudi, nuk do të etet më kurrë; do të pinë njerëzit e devotshëm nga umeti i Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Nëse Allahu do t'u japë banorëve të xhenetit nga mirësitë e tij, më e pakta do të jetë sa dhjetë herë dynjaja. E si do të jetë gjendja e të dashurit të Tij, për të cilin Allahu ka përgatitur të mira që gjithmonë shtohen dhe pozita e tij do të jetë e lartë<sup>208</sup>? Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) do të hapë derën e xhenetit.

Për këtë mirësi të madhe, Allahu e urdhëron Pejgamberin e Tij që ta falënderojë me namaz dhe kurban.

فَصَلِّ لِرَبِّكَ وَأَنْحِرْ (٢)

*"andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban<sup>209</sup>!"*

Muhamed bin Kabi ka thënë: "Njerëzit faljen dhe therjen e kurbanit ia dedikonin dikujt tjetër e jo

---

<sup>208</sup> Shih "Feuaid ue durer min tefsir suret Keuther", "Mexhmua fetaua Ibn Tejmije".

<sup>209</sup> Kur'an, Keuther: 2.

Allahut. Allahu e urdhëroi Pejgamberin e Tij të falet dhe të therë për Allah<sup>210</sup>.”

Ekreme, Katade dhe Atau thonë: "Fale namazin e Kurban Bajramit dhe ther kurbanin tënd<sup>211</sup>.”

Se'id bin Xhubejri dhe Muxhahidi thonë: "Fali namazet obligative (farzet) duke i bashkuar dhe there kurbanin tënd në Mina<sup>212</sup>.”

Ibn Kethiri thotë: "Kuptimi është se ashtu si të kemi dhënë të mira të shumta në këtë botë dhe në botën tjetër, në mesin e të cilave edhe lumin, ji i sinqertë ndaj Zotit në kryerjen e namazeve të obliguara (farzeve) dhe jo të obliguara (nafile) dhe në therjen e kurbanit. Pra, adhuroje vetëm Allahun një, që nuk ka shok, dhe ther vetëm në emër të Allahut. Në këtë kontekst janë edhe fjalët e të Lartmadhërishmit:

قُلْ إِنَّ صَلَاتِي وَنُسُكِي وَمَحْيَايَ وَمَمَاتِي لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ

*“Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurban im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij<sup>213</sup>.”*

---

<sup>210</sup> "Tefsir Bagavij", "Muhtesar Tefsir El-Bagavij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. II, fq. 1036.

<sup>211</sup> Po aty.

<sup>212</sup> Po aty.

<sup>213</sup> Kur'an, En'am: 162-163.

Ibn Tejmije thotë: “Allahu i Madhëruar urdhëroi që t’i bashkojë këto dy ibadete madhështore, namazin dhe kurbanin, të cilat aludojnë për afërsi, modesti, varfëri karshi Madhërisë së Allahut, mendim të mirë, forcë bindjeje, qetësi të zemrës për Allah.”<sup>214</sup>

Kurse Ibn Uthejmini thotë<sup>215</sup>: “Kuptimi është se si falënderim ndaj Allahut për mirësitë e mëdha, falu dhe ther kurban. Qëllimi i namazit këtu është të gjitha namazet dhe namazi i parë është namazi i kurorëzuar me kurban, pra namazi i Kurban Bajramit. Por ajeti është gjithëpërfshirës, *“andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd”*<sup>216</sup>, namazet obligative, vullnetare, namazet e Bajrameve dhe xhumaja.

Në këtë ajet ka ardhur: *“dhe ther kurban”*<sup>217</sup>.

Zakonisht deveja theret, ndërsa kafshët e tjera priten, por është përmendur therja për devenë, edhe pse i përfshin edhe kafshët e tjera, sepse ajo është më e madhe dhe të varfrit fitojnë më shumë nga mishi i saj. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) në haxhin e lamtumirës kishte njëqind deve për të therur, gjashtëdhjetë e tri prej të cilave i theri vetë, pastaj ia dha Aliut radijAllahu anhu për t’i therur të tjerat. Të gjithë mishin e dhuroi për lëmoshë përveç një pjese prej secilës, që e përgatitën për

---

<sup>214</sup> “Mexhmua fetaua Ibn Tejmije”, tefsir i sures Keuther.

<sup>215</sup> Ibn Uthejmini, “Tefsir xhuzi Amme”, fq. 333.

<sup>216</sup> Kur'an, Keuther: 2.

<sup>217</sup> Kur'an, Keuther: 2.

ushqim. Edhe vetë Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) hëngri nga mishi dhe piu nga lengu i mishit dhe urdhëroi që të jepen të gjitha për lëmoshë, edhe lëkurat e tyre.<sup>218</sup>

Urdhri në këtë ajet i drejtohet atij dhe umetit të tij andaj duhet të jemi të sinqertë në namaz dhe në therjen e kurbaneve<sup>219</sup>."

Ibn Abasi, Atau, Muxhahidi, I'krime, Haseni dhe dijetarët e tjerë nga gjeneratat e para kanë komentuar se këtu aludohet për therjen e deveve dhe bagëtive të tjera në emër të Allahut<sup>220</sup>. Kjo ishte e kundërta e praktikës së idhujtarëve, që u përkuleshin të tjerëve e jo Allahut dhe i thernin kafshët në emër të të tjerëve, e jo në emër të Allahut. Allahu i Lartmadhërishëm ka thotë:

وَلَا تَأْكُلُوا مِمَّا لَمْ يُذْكَرِ اسْمُ اللَّهِ عَلَيْهِ وَإِنَّهُ لَفِسْقٌ

*"Mos hani asnjë mish që nuk është therur me emrin e Allahut, sepse është gjynah<sup>221</sup>!"*

إِنَّ شَانِئَكَ هُوَ الْأَبْتَرُ (٣)

*Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë (farësosur)<sup>222</sup>.*

<sup>218</sup> Shënon Buhariu, kapitulli i haxhit, 1718. Muslimi, 1317/348.

<sup>219</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 333.

<sup>220</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 653-654.

<sup>221</sup> Kur'an, En'am: 121.

<sup>222</sup> Kur'an, Keuther: 3.

Ai që të urren ty, e urren atë që ti solle, domethënë udhëzimin dhe të vërtetën. Ai është i privuar nga të mirat<sup>223</sup>.

Fjala “ebter” në aspektin gjuhësor do të thotë farësosur. Për meshkujt thuhet për atë që nuk ka djem, ndërsa për kafshët thuhet për atë që nuk ka bisht. Pra, o Muhamed, ai që të urren ty dhe që e urren udhëzimin, të vërtetën, argumentet bindëse dhe dritën e qartë me të cilën ke ardhur ti, ai është farësosur, i nënçmuar dhe nuk do të përmendet më.

Es-Sudiju ka thënë: "Kur ndonjë personi i vdisnin fëmijët meshkuj, thoshin iu pre fati (i humbi emri). Kur të Dërguarit të Allahut i vdiqën djemtë, thanë: “Muhamedit iu shua emri”. Për këtë Allahu shpalli: ***“Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë (farësosur)”***<sup>224</sup>.” Ata ishin aq injorantë saqë ushqeheshin me iluzione se meqë i kanë vdekur djemtë, të Dërguarit të Allahut do t’i shuhet emri. Zoti na ruajt, nuk ndodhi kjo, por e kundërta, ngase Allahu bëri që emri i të Dërguarit të Tij të ngrihet lart dhe ligjin të cilin e solli ai ua obligoi gjithë njerëzve për të gjitha kohërat deri në Ditën e Ringjalljes. Paqja dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të përgjithmonë deri në Ditën e Gjykimit<sup>225</sup>. Shemer ibn Atij ka përme-

---

<sup>223</sup> Aid el Karni, "Tefsir Mujeser", fq. 920.

<sup>224</sup> Kur'an, Keuther: 3.

<sup>225</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 504.

ndur se kjo sure ka zbritur për rastin e Ukbe ibn Ebi Munitit<sup>226</sup>.

Është transmetuar prej Ataut se ka thënë: "Ky ajet është shpallur për rastin e Ebu Lehebit, ngase kur vdiq njëri nga djemtë e të Dërguarit të Allahut, Ebu Lehebi shkoi tek idhujtarët dhe tha: "Sonte Muhamedit iu pre fati (ngeli pa trashëgues)". Dhe Allahu zbriti këtë ajet.

Kjo sure përmban sqarimin e mirësisë së Allahut ndaj Pejgamberit të Tij, të cilit i dhuroi shumë të mira, pastaj e urdhëroi për sinqeritet në namaz dhe therje dhe në të gjitha adhurimet. Pastaj ka sqaruar se ai që e urren të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) apo urren diçka nga ligji islam, ai është farësosur, nuk ka dobi nga ai e as bereqet.

O Zot, mos na privo nga mirësitë e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) në këtë botë dhe botën tjetër!

Mësimë<sup>227</sup>

Kur lexojmë suren Keuther, e cila është shumë e

---

<sup>226</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 657.

<sup>227</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishtëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanijji, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij,

shkurtër, ndiejmë sikur marrim një lajm të shpejtë, që na përgëzon me një sihariq të bukur.

Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) me të mirat dhe dhuntitë e Allahut konsiderohet krijesa më e lumtur në sipërfaqen e tokës. Ai është i pari i bijve të Ademit, prijësi i atyre që ishin më parë dhe i tyre që do të jenë më vonë. Një ndër nderimet me të cilat Allahu i Madhëruar e lartësoi të Dërguarin e Tij ishte edhe lumi Keuther.

Saktësia e haditheve profetike mbi Keutherin tregojnë se është lumë në xhenet.

Surja Keuther shpie drejt sinqeritetit në adhurim e veçanërisht në dy veprat më madhështore, namazi dhe kurhani.

Kjo sure legjitimon duanë kundër zullumqarit.

Nga mësimet madhështore që shpalos surja në fjalë janë edhe pamjet nga jeta e thirrjes në periudhën mekase, që tregojnë kurthet dhe keqtrajtimet ndaj Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe shokëve të tij.

---

“Ed’uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur’an bi El-Kur’an”; Nasir Es-Sadij, “Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan”; Salih El-Uthejmin, “Tefsir El-Kur’an El-Kerim Xhuzi Amme”; Muhamed Sulejman El-Eshkar, “El-Kur’ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir”; Ebij Bekër El-Xhezairij, “Ejser Et-Tefasir Likelam el-Allah El-Kebir”; Uehbe Ezuhejli, “Et-Tefsir El-Munir”; Dr. Aid El-Karni, “Et-Tefsir El-Mujeser”; El Vahidij, “Esbabul En-Nuzul”; Muhamed El-Gazali, “Komenti tematik i Kur’anit Famëlartë”; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, “Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur’an El-Adhim”; Seid Kutb, “Fi Dhilali-l Kur’an”; Ebij El-Izi Eddimeshkij, “Sherh Akide Et-Tahauije”; Shejh Islam ibn Tejmije, “Ubudije”; Ibn Kajim El-Xhevzijekh, “Zadul Mead”; Ibn Kajim El-Xhevzijekh, “Feuaid”; Emin Bahrami, “Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase”.



Kjo sure zbriti për të pastruar zemrën e Profetit dhe si vërtetim se e mira do të jetojë përjetësisht për atë që zgjodhi Allahu, ndërsa armiqtë e tij do të jenë farësosur ngase veprat e tyre përfundojnë me vdekjen e tyre.

Një grup njerëzish Allahu i privilegjoi sepse jetuan me Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), qëndruan afër tij, e mbrojtën atë, ai kërkoi falje për ta, disave u dha lamtumirën sa ishte gjallë dhe tani kemi mbetur ne që nuk e kemi parë, as jemi përshëndetur me të. Por për ne ka një takim, ai është pellgu, “haudi” i tij. Kush është i kënaqur me Allahun dhe ndihet i qetë në besimin se nuk ka të adhuruar me meritë pos Tij dhe nuk e ka shoqëruar me askend në adhurim dhe se Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është rob dhe i Dërguar i Tij i vërtetë, të cilin Allahu e ka dërguar me udhëzim dhe fe të vërtetë, ai e do të Dërguarin e Allahut dhe mundohet të ndalet aty ku ka ndaluar ai, edhe pse mund të ketë gabime dhe rrëshqitje, por gabimin e pason me kërkim të faljes dhe nuk i lëndon njerëzit. Allahu e ka mbrojtur zemrën dhe gjuhën e tij prej lëndimit të njerëzve dhe askush nuk ankohet prej tij. Nëse njeriu e merr në konsideratë dobinë e fesë dhe nderin e vëllait të vet musliman së bashku me dashurinë për Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe nuk adhuron askënd përveç Allahut, e cila është detyra kryesore që

u ka caktuar robërve të Tij, shpresojmë se ky njeri do ta arrijë pellgun ose “haudin ” dhe do të pijë nga duart e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Një fjalë e tillë është shumë e lehtë, por të praktikuarit e saj është e vështirë, me përjashtim të atij që Allahu ia ka lehtësuar dhe e ka forcuar. Hadithet mbi haudin arrijnë shkallën tevatur<sup>228</sup>, i kanë transmetuar mbi tridhjetë sahabë.

Kadij Ajadi ka thënë njëzet e pesë sahabë, Neueju njëzet e tetë, Ibn Haxheri ka thënë pesëdhjetë sahabë dhe disa dijetarë të vonshëm kanë numëruar deri në tetëdhjetë sahabë. Haudi në aspektin gjuhësor ka kuptimin vendmbledhje e ujit, pellg. Nga aspekti terminologjik ka për qëllim haudin e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Haudi mbushet nga Keutheri, që është në xhenet, ndërsa ky është në sheshin e Ditës së Kiametit, para Urës së Siratit, siç kanë përmendur imam Kurtubiu dhe Gazaliu. Haudin e kanë refuzuar disa grupime të devijuara si mutezilët<sup>229</sup> dhe havarixhët<sup>230</sup>, ndërsa një grup nga sekti rafidij supozojnë se fjala “usejhabij”, e cila ka ardhur në hadithin e Keutherit, ka për qëllim sahabët të cilët e kanë lënë fenë. Por dihet që nga

---

<sup>228</sup> Tévatur është term që përdoret në shkencën e hadithit dhe që ka kuptim se hadithin në fjalë e kanë transmetuar një grup i konsiderueshëm transmetuesish nga Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

<sup>229</sup> “Mutezilët” janë grupacioni i devijuar ideologjik politik që u paraqitën në shekullin e dytë të hixhretit në kohën e kalifatit Emevij.

<sup>230</sup> “Havarixhët”, grupacioni i parë i devijuar i shfaqur pas vdekjes së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

bindjet e devijuara të këtij sekti është se shumica e sahabëve kanë dezertuar nga feja. Allahu na ruajt nga devijimet ideologjike!

Cilat grupe do të pengohen nga haudi?

- Murtedunët<sup>231</sup> dhe hipokritët si dhe disa havarixhë.
- Pasuesit e bidatit (sajimit në fe), sipas Shatibiut.
- Pasuesit e mëkateve të mëdha, ata që i bëjnë haptazi, ka thënë Imam Kurtubiu.

Besimi, e vërteta dhe e mira nuk mund të jenë farësosur sepse kanë degë të shtrira dhe rrënjë të thella, ndërsa mohimi, e kota dhe e keqja janë farësosur edhe pse vlojnë dhe bëjnë mizori.

Matësi me të cilën mat Allahu i Madhëruar dallon nga matësi i njerëzve, ngase ata mashtrohen pas së kotës që ua hijeshojnë ata të cilët janë farësosur. Por ku janë ata sot? Ku mbeti pozita, pasuria dhe pasardhësit e tyre karshi dritës së Pejgamberit dhe Keutherit të tij në këtë botë dhe botën tjetër? I tillë do të jetë realiteti mes atyre që thërrasin në të vërtetën dhe në të kotën.

Pasuesit e Traditës së Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) vdesin, por do të mbeten gjallë çdoherë veprat e tyre ngase ata ngjallën Traditën Profetike dhe kanë hise në fjalën e Allahut: *“... dhe ta ngritëm lart emrin?!”*<sup>232</sup>, ndërsa pasuesit e

---

<sup>231</sup> Femohues është ai që mohon diçka nga shtyllat e fesë apo bazat e besimit, apo diçka nga Islami që njihet tek muslimanët si obligim.

<sup>232</sup> Kur'an, Sherh: 4 .

bidatit do të vdesin përgjithmonë, edhe veprat e tyre, sepse kanë hise në ajetin: “*Sigurisht, ai që të urren ty, ai vetë është fatprerë, (farësosur)*<sup>233</sup>.”

O Zot i gjithësisë, udhëzoni në rrugën që thirri i Dërguari Yt, mundësoni shefatin e tij, të pimë nga Keutheri, që kurrë më të mos kemi etje dhe të takohemi me të!

O Allah, o Zoti ynë, dhuroni besim të pastër, sinqeritet dhe durim në rrugën Tënde!

Mundësoni të jemi ndihmëtarë të Sunetit të Pejgamberit Muhamed!

Të gjithë ata që e urrejnë, shpifin dhe tentojnë ta nënvlerësojnë figurën e tij bëji farosur në këtë botë para se ta shijojnë dënimin në botën tjetër!

Allahu, engjëjt dhe besimtarët dërgojnë salavate mbi të pandërprerë.

---

<sup>233</sup> Kur'an, Keuther: 3.

## SURJA EL-KAFIRUN<sup>234</sup> (JOBESIMTARËT)

Lloji: Mekase, nr. 109, ajete 6

Përmbajtja: Obligueshmëria e distancimit nga jobesimtarët dhe feja e tyre.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (١) لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (٢) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا  
أَعْبُدُ (٣) وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَّا عَبَدْتُمْ (٤) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا  
أَعْبُدُ (٥) لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ (٦)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit*

- 1. Thuaj: “O ju mosbesimtarë!*
- 2. Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni*
- 3. dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj.*
- 4. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni*
- 5. dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj<sup>235</sup>!*
- 6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”*

---

<sup>234</sup> Krerët e Mekës, në përpjekje për të kufizuar dëmet që parashikonin në ekonominë dhe në fuqinë e Kurejshëve për shkak të predikimeve të Profetit (a.s.), i bënë atij një propozim qesharak: një vit të gjithë do të adhuronin Zotin e Vetëm dhe një vit zotat e tjerë. Profeti (a.s.) e refuzoi qartazi propozimin dhe kjo sure u shpall për të ngulitur në mënyrë absolute pamundësinë për të bërë tregti me normat e Allahut të Madhëruar, pamundësinë e propozimit të çdo forme të sinkretizmit fetar apo të pajtimit doktrinar midis feve dhe rrjedhimisht ndalimin e kryerjes së çdo rituali të përbashkët ndër fetar.

<sup>235</sup> Vargu flet për ata jobesimtarë që Allahu e di se nuk do të besojnë asnjëherë.

## Emërtimi

Surja Kafirun quhet Surja e Jobesimtarëve apo siç njihet edhe si Surja Ihlas, e sinqeritetit. Kjo është surja e pastrimit dhe mohimit, e distancimit nga veprimet e idhujtarëve, urdhëron për përkushtim të plotë në adhurim sinqerisht vetëm ndaj Allahut të Madhërishëm.

## Shkaku i zbritjes

Kjo sure **“Thuaj: “O ju mosbesimtarë!”<sup>236</sup>** e deri në fund ka zbritur për krerët e Mekës, të cilët i bënë Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) një propozim duke i thënë: “O Muhamed! Eja, pasoje fenë tonë, që ta pasojmë fenë tënde, adhuro zotat tanë një vit që ta adhurojmë Zotin tënd një vit. Nëse ajo që ti po adhuron është më e dobishme se ajo që posedojmë ne, atëherë do të të shoqërojmë e të bëhemi pjesë e saj. E nëse ajo që adhurojmë ne është më e dobishme se ajo që ke ti, atëherë na shoqëro dhe bëhu pjesë e saj!” Ai u tha: “Allahu na mbrojtë që t'i shoqërojmë Atij dikë tjetër!” Allahu shpalli ajetet: **“Thuaj: “O ju mosbesimtarë!”<sup>237</sup>** deri në fund të sures. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) shkoi tek

---

<sup>236</sup> Sure Kafirun, 1.

<sup>237</sup> Sure Kafirun, 1.

Qabeja, ku ishin një grup Kurejshësh, dhe ua tha këtë sure deri në fund. Kurejshët u dëshpëruan nga ajo që dëgjuan<sup>238</sup>.

### Kuptimi i ajeteve

قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ (١)  
لَا أَعْبُدُ مَا تَعْبُدُونَ (٢) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (٣)

**1-3. Thuaj: “O ju mosbesimtarë! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj”<sup>239</sup>.**

Fjalët e të Lartmadhërishmit: **“Thuaj: “O ju mosbesimtarë!”<sup>240</sup>** përfshijnë çdo mosbesimtar mbi sipërfaqen e Tokës, edhe pse këto fjalë me rastin e shpalljes u janë drejtuar mosbesimtarëve Kurejshë. Thuhet se ata nga injoranca e madhe e kanë ftuar të Dërguarin e Allahut që t’i adhurojë idhujt e tyre një vit, e pastaj edhe ata do ta adhurojnë një vit Atë që adhuron ai. Kjo është arsyeja që Allahu e shpalli këtë sure dhe e urdhëroi të Dërguarin e Tij (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) që të distancohet plotësisht nga feja e tyre dhe ka thënë: **“Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni”<sup>241</sup>**, d.m.th. idhujt që barazoni me Allahun.

<sup>238</sup> El Vahidi, "Esbabu Nuzul", fq. 745.

<sup>239</sup> Kur'an, Kafirun: 1-3.

<sup>240</sup> Kur'an, Kafirun: 1.

<sup>241</sup> Kur'an, Kafirun: 2.

Kuptimi është që atyre që propozuan të kotën, t'u thotë "o ju jobesimtarë", me shpallje hyjnore: ***"Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni"***<sup>242</sup> siç më propozuat, ***"dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj"***<sup>243</sup>. Tashmë nuk do ta adhuroni Atë që unë adhuroj, Allahun, për shkak se Ai xhele xhelalehu e ka caktuar një gjë të tillë<sup>244</sup>.

Dijetari Abdurahman bin Nasir es-Sadij thotë: "Për shkak se nuk jeni të sinqertë në adhurimin ndaj Allahut, adhurimi ndaj Tij që është i kurorëzuar me shirk (rivalitet), nuk quhet adhurim."<sup>245</sup>

(٥) وَلَا أَنْتُمْ عَابِدُونَ مَا أَعْبُدُ (٤) وَلَا أَنَا عَابِدٌ مَا عَبَدْتُمْ (٣)  
***4-5. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!***<sup>246</sup>

Unë nuk e kryej adhurimin tuaj, nuk e ndjek dhe nuk i përmbahem, por e adhuroj Allahun ashtu si ka urdhëruar, si do dhe si është i kënaqur Ai."<sup>247</sup> Për këtë ka thënë: ***"...dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj!"***<sup>248</sup>, d.m.th. ju nuk u përmbaheni urdhrave të Allahut dhe dispozitave të Tij

---

<sup>242</sup> Kur'an, Kafirun: 2.

<sup>243</sup> Kur'an, Kafirun: 3.

<sup>244</sup> El Xhezairij, "Ejser tefasir", vëll. V, fq. 623-624.

<sup>245</sup> Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan", fq. 865.

<sup>246</sup> Kur'an, Kafirun: 4-5.

<sup>247</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VII, fq. 506-507.

<sup>248</sup> Kur'an, Kafirun: 4-5.



përkitazi me adhurimin, por shpikët diçka nga vetja në adhurim dhe morët zota të rrejtshëm.

Gjatë jetës time nuk do të adhuroj asgjë nga zotat tuaj, që ju i adhuroni. E as ju nuk do të adhuroni Allahun në jetën tuaj derisa të jeni në mosbesimin dhe adhurimin e idhujve.<sup>249</sup>

Në këtë kuptim janë edhe fjalët e të Lartmadhë-rishmit:

إِنْ هِيَ إِلَّا أَسْمَاءٌ سَمَّيْتُمُوهَا أَنْتُمْ وَأَبَاؤُكُمْ مَا أَنْزَلَ اللَّهُ بِهَا مِنْ سُلْطَانٍ ۗ إِنْ يَتَّبِعُونَ إِلَّا الظَّنَّ وَمَا تَهْوَى الْأَنْفُسُ ۗ وَلَقَدْ جَاءَهُمْ مِنْ رَبِّهِمْ الْهُدَىٰ

*“Këta janë vetëm emra që ua keni ngjitur (idhujve) ju dhe të parët tuaj, kurse Allahu nuk ju ka dërguar për ata asnjë provë. Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi, ndonëse u ka ardhur prej Zotit të tyre udhëzimi (për rrugën e drejtë).”<sup>250</sup>*

Kështu, i Dërguari i Allahut u distancua nga çdo gjë që ishte e tyre. Adhuresi patjetër duhet të ketë një të adhuruar të cilin e adhuron dhe një rrugë adhurimi që e shpie në adhurimin e Tij. I Dërguari i Allahut dhe pasuesit e tij e adhurojnë Allahun ashtu si ka urdhëruar Allahu. Së këndejmi, fjala e dëshmisë së përkatësisë islame është “*La ilahe il-Allah, Muahmed resulullah-Nuk ka Zot tjetër pos Allahut, Muhamedi është i Dërguari i Tij*”, që do të thotë se nuk meriton

<sup>249</sup> El-Eshkar, “Zubdet tefsir min fethul kadir”, fq. 824.

<sup>250</sup> Kur’an, Nexhm: 23.

të adhurohet me të drejtë askush pos Allahut, kurse rruga e vetme që t'i bëhet Atij adhurim i vërtetë është që të ndiqet rruga e të Dërguarit të Allahut.

Idhujtarët kanë adhuruar zota të tjerë e jo Allahun e Madhërisëm. Ata kanë bërë adhurime që nuk i ka lejuar Allahu. Nisur nga kjo, Pejgamberi i Allahut u ka thënë:

لَكُمْ دِينُكُمْ وَلِيَ دِينِ (٦)

**6. Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!**<sup>251</sup>

për të bërë veçimin mes dy grupeve dhe ndarjen mes tyre.

Në këtë kontest janë edhe fjalët e të Lartmadhërishtit:

وَإِنْ كَذَّبُوكَ فَقُلْ لِي عَمَلِي وَلكُمْ عَمَلُكُمْ ۗ  
أَنْتُمْ بَرِيئُونَ مِمَّا أَعْمَلُ وَأَنَا بَرِيءٌ مِّمَّا تَعْمَلُونَ

*“Nëse ata të quajnë gënjeshtar, thuaju: “Unë kam (shpërblim për) punën time, kurse ju keni (shpërblim për) punën tuaj. Ju s’jeni përgjegjës për atë që bëj unë dhe as unë s’jam përgjegjës për atë që bëni ju.”*<sup>252</sup>

Këta politeistë që dhanë propozimin u shkatërruan dhe mbetën në mosbesimin e tyre. Disa u vranë në Bedër e disa të tjerë u shkatërruan duke u ndarë nga kjo botë pa pasur mundësi për ta shijuar besimin. Allahu e ka thënë të vërtetën ngase ata nuk e adhuro-

---

<sup>251</sup> Kur'an, Kafirun: 6.

<sup>252</sup> Kur'an, Junus: 41.

jnë Allahun, që t'i shpëtojë nga zjarri dhe t'i kaplojë mëshira e Tij.

Fjala "din" në këtë ajet ka dy kuptime, siç kanë përmendur komentatorët, vjen në kuptimin e fesë, besimit, e kundërta e shirkut. Në kuptimin e shpërblimit do të thotë se "ju keni shpërblimin tuaj, unë kam shpërblimin tim për atë që adhuron".<sup>253</sup>

Buhariu ka komentuar: "Do t'u thuhet *"Ju keni fenë tuaj"*, mosbesimin, *"ndërsa unë fenë time"*, Islamin. Në fund të ajetit nuk përmendet shkronja *j*, që tregon përkatësi, pra thuhet "din" e jo "dini", ngase ajetet mbarojnë me shkronjën *n*. Kur vjen në fund shkronja *n*, bie shkronja *j*.<sup>254</sup>

## Mësim<sup>255</sup>

---

<sup>253</sup>E-sheukani, "Fethul Kadir", vëll. V, fq. 685.

<sup>254</sup>"Fet'hul Bari", vëll. VIII, fq. 604.

<sup>255</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përktim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërisëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukaniji, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Uthejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Allij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-l Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkij, "Sherh Akide Et-Tahauije"; Shejh Islam ibn Tejmije, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Zadul Mead"; Ibn

Surja argumenton vërtetimin e besimit në caktimin e Allahut. Kjo sure aludon për mbrojtjen hyjnore për të Dërguarin e Allahut në mospranimin e propozimit nga ana e parisë së Kurejshëve.

Vërtetimi i ekzistencës së ndarjes mes pasuesve të besimit dhe pasuesve të mosbesimit, paganizmit.

Ndoshta përzierja dhe supozimet për pranimin e Allahut karshi adhurimit të tyre ishte ndjenja se distanca mes tyre dhe Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishte afër, se ekzistonte mundësia për mirëkuptim për ndarjen e pushtetit dhe për pikëtakim në mes të rrugës. Kaptina u shpall për ndërprerjen e këtij dyshimi dhe prerjen e orvatjes së ndarjes mes dy adhurimeve, rrugëve, metodologjive. Fjalët e të Lartmadhërishtit: ***“Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!”***<sup>256</sup> do të thonë unë jam këtu, ju jeni atje dhe mes nesh nuk ka as rrugë e as urë. Ndarje e plotë dhe veçim i qartë e preciz. Kjo ndarje ishte e domosdoshme për të sqaruar kriteret thelbësore, bazën e besimit dhe të adhurimit.

Njëshmëria është diçka dhe paganizmi është diçka tjetër, nuk takohen asnjëherë, nuk ka kompromise mes tyre. Islami është Islam, injoranca është injorancë, dallimet mes tyre janë të mëdha dhe rrugëdalja

---

Kajim El-Xhevizih, “Feuaid”; Emin Bahrami, “Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihës”.

<sup>256</sup> Kur'an, Kafirun: 6.

e vetme është dalja nga injoranca në tërësi dhe hyrja në Islam në tërësi, shpërngulja e plotë nga petku i injorancës në Islam dhe ky është hapi i parë në rrugë për ta kuptuar Islamin teorik dhe praktik. Kjo sure tregon kontradiktën në të adhurar dhe adhurimin mes besimtarëve dhe të tjerëve dhe se mosbesimi është një popull përball Islamit. Këta tre faktorë aludojnë se nuk ka takim mes mosbesimit dhe besimit dhe as mes armiqve dhe pasuesve të Islamit.

Muslimani nuk përpiket t'i mënjanojë dhe mohojë religjionet e tjera që janë në kundërshtim me religjionin tonë. Që të gjithë dijetarët dhe shkencëtarët eminentë janë të mendimit se Islami lufton vetëm për të penguar çrregullimin dhe për të eliminuar armiqtë. Çdo dhunë, e cila bëhet për t'i shtyrë njerëzit me dhunë të besojnë, konsiderohet luftë e nxitur nga djalli dhe sunduesit tiranë. Luftërat e tilla vetëm sa shtojnë padurimin dhe urrejtjen.

Kjo sure konsiderohet njëra ndër suret mbi parimet e së cilës formohen dhe rregullohen më saktë marrëdhëniet ndërkombëtare. Le ta pranojmë dhe njohim ekzistimin e të gjitha besimeve, le t'i bëjmë vend dialogut konstruktiv, real e të qetë, që të shtrihet anakënd njerëzve dhe të formojë institucione në të cilat do ta promovojnë këtë dialog, mirëpo qysh në fillim duhet të denoncohen dhe refuzohen urrejtjet e fshehta e të fuqishme botërore kundër Islamit si dhe

akuzat se është religjion fanatik dhe me pikëpamje fanatike ndaj jetës.

- Leximi i kësaj sure në namazet jo të obliguara apo nafilë.

Në "Sahihun e Muslimit" është konfirmuar prej Xhabirit se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e ka lexuar këtë sure, suren Kafirun dhe suren Ihlas

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ

**"Thuaj: Ai, All-llahu është Një!"<sup>257</sup>**

në dy rekatet pas tavafit-rrotullimit rreth Qabesë<sup>258</sup>.

Muslimi ka transmetuar në "Sahihun" e tij prej Ebu Hurejrës se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i ka lexuar dy suret e përmendura në dy rekatet (sunset) e namazit të sabahut<sup>259</sup>.

Imam Ahmedi ka transmetuar prej Ibn Omerit se i Dërguari i Allahut i ka lexuar suret Kafirun dhe Ihlas në dy rekatet para namazit të sabahut dhe në dy rekatet pas namazit të akshamit<sup>260</sup> njëzet e disa herë apo të paktën mbi dhjetë herë<sup>261</sup>.

Po ashtu, Ahmedi ka transmetuar prej Ibn Omerit se ka thënë: "Ia kam vënë veshin të Dërguarit të Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe

---

<sup>257</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

<sup>258</sup> Muslimi, vëll. II, fq. 888, hadithi është i gjetë.

<sup>259</sup> Muslimi, vëll. I, fq. 502.

<sup>260</sup> Këtu është për qëllim leximi i këtyre dy sureve në sunsetet e sabahut dhe të akshamit.

<sup>261</sup> Ahmedi, vëll. II, fq. 24-25.

vëreja se e lexonte suren Kafirun dhe Ihlas njëzetekatër herë, apo njëzetepesë herë, në dy rekatet sunet të sabahut dhe të akshamit<sup>262</sup>."

Muhamed bin Nasër dhe Taberaniu kanë nxjerrë në "Evsat" nga Ibn Omeri se ka thënë: "Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: **"Thuaj: Ai, Allahu është Një!"**<sup>263</sup> është një e treta e Kur'anit, ndërsa surja **"Thuaj: "O ju mosbesimtarë!"**<sup>264</sup> është një e katërta e Kur'anit<sup>265</sup>."

E vërteta është një, nuk mund të dyfishohet apo shumëfishohet dhe sa herë që ka luftë mes së vërtetës dhe së kotës, dije se nuk do të zgjatë ngase e kota çdo herë është e zhdukur.

وَقُلْ جَاءَ الْحَقُّ وَزَهَقَ الْبَاطِلُ ۗ إِنَّ الْبَاطِلَ كَانَ زَهُوقًا

**"Thuaj: "E vërteta erdhi, ndërsa e pavërteta u shkatërrua. Sigurisht, e pavërteta është e paracaktuar të zhduket!"**<sup>266</sup>

O Zot, mundësona që çdo herë të distancohemi prej mosbesimi dhe pasuesve të tij, të jemi adhurues ndaj Teje ashtu siç i përket Madhërisë Tënde dhe mos na bëj prej atyre që bëjnë kompromise për ta bashkuar të kotën me të vërtetën!

<sup>262</sup> Ahmedi, vëll. II, fq. 24.

<sup>263</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

<sup>264</sup> Kur'an, Kafirun: 1.

<sup>265</sup> Sheukanij, "Fethul Kadir ", vëll, V, fq. 671.

<sup>266</sup> Kur'an, Isra: 81.

## SURJA EN-NASR<sup>267</sup> (FITORJA)

Lloji: Medinase<sup>268</sup>, nr. 110, ajete 3

Përmbajtja: Çlirimi i Mekës dhe paralajmërimi për vdekjen e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ (١) وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا (٢) فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ ۚ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا (٣)

***Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!***

- 1. Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)***
- 2. dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe,***
- 3. atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai; se Ai është vërtet Pranues i madh i pendimeve.***

---

<sup>267</sup> Kjo ishte surja e fundit që iu dha Profetit (a.s.), duke mbyllur kështu një cikël shpalljesh që zgjaste prej njëzetë e tre vjetësh. Ajo ishte shpallja e fitores së përgjithshme të Islamit mbi mosbesimin dhe e kthimit masiv në Islam të të gjithë Arabisë. Kur Muhamedi (a.s.) mori këtë shpallje, e kuptoi se Zoti i tij i Madhëruar po e paralajmëronte për ndarjen e afërt nga kjo botë dhe për këtë lajmëroi të afërmit e tij më të ngushtë. Gjatë gjithë kohës që parapriu vdekjen e tij tokësore, Profeti (a.s.) thoshte vazhdimisht në namazet e tij: “*Subhānek ell-llāhumme rabbena ue bibandik. All-llāhumme gfir li*” (I Lartësuar qofsh, o Zoti im, dhe i Falënderuar. O Zot, më fal!).

<sup>268</sup> Medinase janë kapitinat apo ajetet që janë shpallur në Medinë, pas hixhretit.



## Emërtimi

Quhet “Nasr” për shkak se fillon me këtë fjalë. Njihet edhe si surja “Tevdije-E lamtumirës”. Imam Termidhiu e ka përmendur si surja Fet’h.

Nesaiu ka transmetuar prej Ubjedullah ibn Utbes se ka thënë: “Ibn Abasi më pyeti: -O bir i Utbes, a e di se cila është surja e fundit e Kur'anit që ka zbritur? Unë i thashë: -Po. surja Nasr.

Ai më tha: -Ia qëlllove.”<sup>269</sup>

## Shkaku i zbritjes

Surja Nasr i ka zbritur Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) duke u kthyer nga Lufta e Hunejnit dhe ai ka jetuar pas zbritjes së saj edhe dy vite<sup>270</sup>.

Na ka lajmëruar Seijd bin Muhamed el Muedhi dhe ka thënë: "Na ka lajmëruar Ebu Omer bin Xhafer el Mukriu se ka thënë: Na ka lajmëruar el Hasen bin Sufjani se ka thënë: Na ka treguar Abdul Aziz bin Selam se ka thënë: Na ka treguar Is'hak bin Abdullah bin Kejsan, se ka thënë: Më ka treguar babai im nga Ekremeh nga Ibn Abasi se ka thënë<sup>271</sup>: “Kur Pejgamberi sal-lAllahu erdhi nga Lufta e Hunejnit, Allahu

---

<sup>269</sup> Nesaiu në "El-Kubra", vëll. V, fq. 525.

<sup>270</sup> Si Vahidij, "Esbabu-l Nuzul", fq. 747.

<sup>271</sup> Zinxhiri është i dobët për shkak të prezencës së Is'hak bin Abdullahut.

i Madhëruar i shpalli: "Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)".<sup>272</sup> Ai tha: "O Ali bin ebij Talib, oj Ftaime! Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)."<sup>273</sup>

Zinxhiri i këtij transmetimi është i dobët për shkak të prezencës së Is'hak bin Abdullahut.

Imam Buhariu ka transmetuar prej Ibn Abasit se ka thënë: "Omeri më merrte me vete në shoqëri me personalitete të shquara të Luftës së Bedrit, mirëpo disave prej tyre kjo nuk u pëlqeu dhe thanë: "Pse na shoqëron ky ne, kur ne i kemi fëmijët në moshën e tij?" Omeri u tha: "Ju e dini se kush është dhe i kujt është ky djalosh." Një ditë i thirri ata e më thirri edhe mua që t'u bashkohem. Mendoj se atë ditë më thirri vetëm që t'u tregoja se pse më mbante pranë vetes. Omeri pyeti: "Ç'thoni për fjalët e të Lartmadhërishmit: ***"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)?"***"<sup>274</sup> Disa u përgjigjën: "Ky ajete na urdhëron që ta lavdërojmë Allahun dhe të kërkojmë falje prej Tij kur të na ndihmojë dhe të na mundësojë fitore." Disa të tjerë heshtën, nuk folën gjë. Atëherë Omeri m'u kthye mua e më tha: "O Ibn Abas, a thua edhe ti kështu?" Unë i thashë: -Jo, nuk them ashtu. Omeri më pyeti: "Po si thua ti?" Unë iu përgjigja: -Ky ajete flet për vdekjen e të Dërguarit të

---

<sup>272</sup> Kur'an, Nasr: 1.

<sup>273</sup> Kur'an, Nasr: 1. Shih El Vahidi, "Esbabul nuzul", fq. 747.

<sup>274</sup> Kur'an, Nasr: 1. Shih El Vahidi, "Esbabul nuzul", fq. 747.

Allahut, të cilën Allahu ia bëri me dije me fjalën: *"Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)"*,<sup>275</sup> deri në fund. Atëherë Omeri tha: "Edhe unë nuk kuptoj diçka tjetër prej kësaj sureje pos asaj që thua ti"<sup>276</sup>. Këtë transmetim e shënon vetëm Imam Buhariu.

## Koha e zbritjes

Ka dy mendime.

I pari: Çlirimi i Mekës ka ndodhur në vitin e tetë, në muajin Ramazan. Kjo sure ka zbritur në vitin e dhjetë. Është transmetuar se Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka jetuar pas kësaj sureje shtatëdhjetë ditë dhe ka vdekur në muajin Rebiul-Evel, në vitin e dhjetë të hixhretit. Edhe për këtë shkak është quajtur surja "Tevdije-E lamtumi-rës".

I dyti: Ka zbritur para çlirimit të Mekës dhe ishte premtim nga Allahu për Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) se do ta ndihmonte kundër banorëve të Mekës dhe se do ta çlironte atë qytet. Sipas këtij mendimi, çlirimi i Mekës është paralajmërim për gajbin (të fshehtë), si mrekulli që është shenjë e pejgamberllëkut<sup>277</sup>.

---

<sup>275</sup> Kur'an, Nasr: 1. Shih El Vahidi, "Esbabul nuzul", fq. 747.

<sup>276</sup> "Fet'hul-Bari", vëll. VIII, fq. 606.

<sup>277</sup> "Tefsir Razij", 32/100.

Mendimi i parë është më i qartë duke u bazuar edhe në thënien e Omerit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij: "Kjo sure është shpallur në vendin e quajtur Mina, në haxhin e lamtumirës. Pastaj u shpall ajeti:

الْيَوْمَ أَكْمَلْتُ لَكُمْ دِينَكُمْ وَأَتَمَمْتُ عَلَيْكُمْ نِعْمَتِي وَرَضِيْتُ لَكُمُ الْإِسْلَامَ  
دِينًا

*“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj.”<sup>278</sup>*

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka jetuar pas saj tetëdhjetë ditë, pastaj u shpall ajeti i kelales (fundi i sures Nisa). Ka jetuar pas tij pesëdhjetë ditë dhe pastaj u shpall ajeti:

لَقَدْ جَاءَكُمْ رَسُولٌ مِّنْ أَنْفُسِكُمْ عَزِيزٌ عَلَيْهِ مَا عَنِتُّمْ حَرِيصٌ عَلَيْكُمْ  
بِالْمُؤْمِنِينَ رَءُوفٌ رَّحِيمٌ (١٢٨) فَإِنْ تَوَلَّوْا فَقُلْ حَسْبِيَ اللَّهُ لَا إِلَهَ  
إِلَّا هُوَ ۖ عَلَيْهِ تَوَكَّلْتُ ۖ وَهُوَ رَبُّ الْعَرْشِ الْعَظِيمِ

*“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.”<sup>279</sup>*

---

<sup>278</sup> Kur'an, Maide: 3.

<sup>279</sup> Kur'an, Teube: 128.

Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) jetoi tridhjetë e pesë ditë, pastaj u shpall ajeti:

وَأَتَقُوا يَوْمًا تُرْجَعُونَ فِيهِ إِلَى اللَّهِ ۖ ثُمَّ تُوَفَّى كُلُّ نَفْسٍ مَّا كَسَبَتْ وَهُمْ لَا يُظْلَمُونَ

*“Dhe ruajuni asaj dite që do të ktheheni tek Allahu.”<sup>280</sup>*

Jetoi edhe njëzet e një ditë. Mukatili thotë se ka jetuar edhe shtatë ditë<sup>281</sup>.

### Kuptimi i ajeteve

إِذَا جَاءَ نَصْرُ اللَّهِ وَالْفَتْحُ (١)

*Kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës)<sup>282</sup>.*

Ky ajet kur'anor i drejtohet Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), se Allahu do ta ndihmojë kundër armikut të tij.

Komentuesit janë unaninë me konstatimin se këtu me nocionin “çlirim” është për qëllim çlirimi i Mekës, ngase fiset arabe kalimin e tyre në Islam e kushtëzonin me çlirimin e Mekës dhe thoshin: "Nëse ngadhënjën mbi popullin e vet, atëherë është Pejgamber." Kështu, kur ia mundësoi Allahu të Dërguarit të Tij ta çlirojë Mekën, njerëzit filluan të hyjnë në

<sup>280</sup> Kur'an, Bekare: 281.

<sup>281</sup> Kurtubi, “El-Xhami Liahkam El-Kur'an”, 20/233.

<sup>282</sup> Kur'an, Nasr: 1. Shih El Vahidi, "Esbabul nuzul", fq. 747.

fenë e Allahut grupe-grupe. Brenda dy vitesh besimi islam u përhap në gjithë Gadishullin Arabik, qoftë i lartësuar Allahu për mirësinë.

Çlirimi i Mekës ka ndodhur më 20 Ramazan të vitit të tetë të hixhretit.

Pra, kur të vijë ndihma e Allahut dhe çlirimi (i Mekës), do të të vijë edhe exheli ty<sup>283</sup>.

Buhariu ka transmetuar në "Sahihun" e tij prej Amër ibn Selemes se ka thënë: "Kur u çlirua Meka, çdo fis vrapoi tek i Dërguari i Allahut që të deklarojë kalimin në Islam. Fiset kalimin në Islam e lidhnin me çlirimin e Mekës dhe thoshin: "Lëreni ta shohim ç'do të bëjë me popullin e vet, nëse ngadhënjen mbi ta, atëherë vërtet është Pejgamber."<sup>284</sup>

Por, çfarë do të ndodhë kur të vijë ndihma e Allahut të Madhërishëm?

وَرَأَيْتَ النَّاسَ يَدْخُلُونَ فِي دِينِ اللَّهِ أَفْوَاجًا (٢)

*dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe<sup>285</sup>*

T'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe ngase më parë hynin si individë, kurse tani filluan të vinin tek Pejgamberi delegacione, saqë viti i nëntë i hixhretit quhet viti i delegacioneve.

---

<sup>283</sup> Uehb Zuhjel, "Tefsir elMunir", vëll. 15, fq. 849.

<sup>284</sup> "Fet'hul-Bari", vëll. VIII, fq. 616.

<sup>285</sup> Kur'an, Nasr: 2.

Ikreme dhe Mukatil kanë thënë: "Qëllimi i nocionit "njerëzit" janë populli i Jemenit, ngase erdhën shtatëqind besimtarë që hynë në Islam."

Haseni ka thënë: "Kur ndodhi çlirimi i Mekës, arabët i thoshin njëri-tjetrit: "Lëreni ta shohim ç'do të bëjë me popullin e vet, nëse ngadhënjën mbi ta, atëherë vërtet është Pejgamber. Allahu i mbrojti nga pronarët e elefantit dhe ju nuk keni forcë ndaj tyre." Kështu filluan të hynë në Islam grupe-grupe pasi më parë hynin një nga një e dy nga dy.

Imam Ahmedi ka transmetuar prej Ebu Ammarit se ka thënë: "Më ka rrëfyer njëri nga fqinjët e Xhabir ibn Abdullahut e më ka thënë: "Erdha prej një udhëtimiti dhe kur mbërriti Xhabiri, më dha selam dhe u ul. Unë fillova t'i tregoja se si janë përçarë njerëzit dhe si shpikin risi. Xhabiri filloi të qante, e pastaj tha: "E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) duke thënë: *"Vërtet, njerëzit kanë hyrë grupe-grupe në fenë e Allahut, po edhe do të dalin prej saj grupe-grupe"*<sup>286</sup>.

Kështu filluan që i tërë fisi të hyjë në Islam.

Pastaj Allahu i drejtohet të Dërguarit të Tij duke i thënë se kur ta shohë këtë shenjë:

فَسَبِّحْ بِحَمْدِ رَبِّكَ وَاسْتَغْفِرْهُ ۗ إِنَّهُ كَانَ تَوَّابًا (۳)

<sup>286</sup> Ahmedi, vëll. III, fq. 343.

***3. atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai, se Ai është vërtet pranues i madh i pendimeve*<sup>287</sup>.**

Kur të vijë ndihma e Allahut, të bëhet çlirimi i Mekës, të hyjnë njerëzit në fenë e Allahut grupe-grupe, veç është të afruar vdekja dhe ***"atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai"***<sup>288</sup>.

Madhëroje Allahun me madhërim të kurorëzuar me falënderim.

Tesbihi ose madhërimi është shenjtërimi i Allahut duke larguar çdo gjë që nuk i takon Madhërisë së Tij.

Hamdi ose lavdërimi është për Allahun, i plotësuar me dashuri dhe respekt. Pastaj bashko tesbihun dhe lavdërimin dhe kërko falje.

Allahu ka urdhëruar për dy gjëra:

Së pari, për tesbih të kurorëzuar me hamd.

Së dyti, për istigfar, kërkim faljeje. Falje është mbulimi i mëkateve nga Allahu ndaj njeriut duke ia shlyer dhe tejkaluar ato.

Ky është qëllimi i çdo njeriu, pasi njeriu bën shumë mëkate, ka nevojë për falje dhe nëse Allahu nuk e kaplon me mëshirën e Tij, shkatërrohet. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: *"Askush nga ju nuk do të hyjë në xhenet me*

---

<sup>287</sup> Kur'an, Nasr: 3.

<sup>288</sup> Kur'an, Nasr: 3.



*veprat e tij.*" Thanë: "As ti o i Dërguari i Allahut!?" Tha: "**As unë, nëse Allahu nuk më kaplon me mëshirën e Tij<sup>289</sup>.**" Nëse kërkon falje nga Allahu, Ai do të të falë<sup>290</sup>, "**se Ai është vërtet pranues i madh i pendimeve<sup>291</sup>**" ndaj atyre që kërkojnë falje dhe pendim. Haseni ka thënë: "Është afruar exheli i tij, prandaj Allahu e urdhëroi me tesbih dhe teube, që ta përfundojë jetën me shtim të veprave të mira."

### Mësimet<sup>292</sup>

Kjo kaptinë është shpallur rreth ditëve të fundit të jetës së Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Prej saj u kuptua ashtu siç e kup-

---

<sup>289</sup> Shënon Buhariu, 6463. Muslimi, 2816/82.

<sup>290</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir Xhuzi amme", fq. 341-342.

<sup>291</sup> Kur'an, Nasr: 3.

<sup>292</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishtëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanij, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Uthejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Alij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-I Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkij, "Sherh Akide Et-Tahauije"; Shejh Islam ibn Tejmiye, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhevzijek, "Zadul Mead"; Ibn Kajim El-Xhevzijek, "Feuid"; Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase".

tuan sahabët e shkathët dhe mendjemprehtë, se është duke u paralajmëruar vdekja e Pejgamberit të dashur, që ai ta ndiejë ndarjen e afërt nga kjo botë, ndaj duhej të përgatitet duke lartësuar Zotin dhe duke i kërkuar falje dhe mëshirë.

Kjo sure na obligon që ta madhërojmë dhe falënderojmë Allahun në momentin e realizimit të ndonjë mirësie, duke bërë sexhde falënderimi.

Atë kohë kur Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i erdhi shpallja, në fillim nuk i besoi pos gruaja e tij Hadixhja dhe Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me ta, dhe kështu numri i besimtarëve shtohet dita-ditës, por si individë, derisa erdhi koha e çlirimit të Mekës dhe Pejgamberi i pa njerëzit se si hynin në fenë e Allahut grupe-grupe.

Dijetarët janë unanimitisht të pajtimit se kjo është surja e fundit që i ka zbritur Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e plotë. Këtë e thotë edhe Ibn Abasi, siç ka përmendur Muslimi.

Në fjalën e Allahut ***"dhe t'i shohësh njerëzit duke hyrë në fenë e Allahut grupe-grupe"***<sup>293</sup> këtu përmendet "në fenë e Allahut" dhe nuk ka thënë në fenë tënde, o Muhamed, ngase Islami është feja e Allahut, ndërsa Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është vetëm predikues i saj.

Allahu e urdhëron Pejgamberin e Tij së pari me tesbih (madhërim), pastaj me istigfar (falje) duke i

dhënë prioritet asaj që është detyrë ndaj Krijuesit para vetes.

Legjitimiteti i të qarit për të vdekurin, por duke mos lëshuar zë apo vajtuar.

Në këtë sure fisnike ka përgëzim dhe urdhër për Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), se kur të arrihet ky përgëzim do të pasojë edhe sinjalizimi. Përgëzimi është ndihma e Allahut ndaj të Dërguarit të Tij, çlirimi i Mekës, hyrja e njerëzve në fenë e Allahut grupe-grupe dhe ata që ishin armiq të fesë do të bëhen ndihmëtarë të saj. Urdhri është që të madhërohet, të falënderohet Allahu dhe të kërkohet falje nga Ai, ndërsa sinjalizimet janë dy:

I pari, se ndihma e Allahut do të vazhdojë ndaj besimtarëve.

I dyti, se vdekja e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) është afruar.

- Kërkimi i faljes është i nevojshëm për shkak të neglizhimit të të drejtave ndaj Krijuesit. Edhe pse njeriu mundohet të japë kontributin e tij, istigfari mbetet i mangët karshi mirësive të Allahut. Istigfari kërkohet në momentin kur njeriu mund ta godasë vetëpëlqimi apo mendjemadhësia si përkujtues i neglizhencës sonë në këtë drejtim.
- Pse Allahu ka kërkuar nga Pejgamberi i Tij që të kërkohet falje kur dihet se atij i janë falur të gjitha mëkatet?

***“...atëherë madhëroje me falënderim Zotin tënd dhe kërko falje nga Ai<sup>293</sup>.”***

Për këtë pyetje janë dhënë disa përgjigje, të cilat i ka përmendur Imam Kurtubiu në tefsirin e tij.

- 1) Prej Sunetit të Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishte që gjatë ditës bënte shpeshherë istigfar.
- 2) Istigfari është adhurim dhe duhet bërë patjetër.
- 3) Tërheqje e vërejtjes për umetin e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) që të mos e lënë istigfarin.
- 4) Kërkimi i faljes për umetin.

Kjo ndihmë erdhi pas njëzet vitesh dhe pas gjithë atyre vuajtjesh dhe peripecish të vështira që ka dëshmuar historia. Pra, kjo ndihmë erdhi pas marrjes së shkaqeve. Allahu në suren Bekare thotë:

أَمْ حَسِبْتُمْ أَنْ تُدْخَلُوا الْجَنَّةَ وَلَمَّا يَأْتِكُمْ مَثَلُ الَّذِينَ خَلَوْا مِنْ قَبْلِكُمْ ۗ مَسْتَهْمُ الْأَسَاءِ وَالضَّرَّاءِ وَزُلْزَلُوا حَتَّى يَقُولَ الرَّسُولُ وَالَّذِينَ آمَنُوا مَعَهُ مَتَى نَصْرُ اللَّهِ ۗ أَلَا إِنَّ نَصْرَ اللَّهِ قَرِيبٌ

***“Vërtet mendoni të hyni në xhenet pa provuar atë që kanë provuar të tjerët para jush? Ata i goditi mjერიmi dhe sëmundjet dhe, aq shumë u tronditën, saqë çdo i Dërguar dhe ndjekësit e tij thirrën: “Kur do të***

---

<sup>293</sup> Kur'an, Nasr: 3.

***arrijë ndihma e Allahut?!" Ja, ndihma e Allahut është afër<sup>294</sup>.***"

Kjo mirësi që ne shohim sot, kur muslimanët dëshmojnë "La ilahe il-Allah", kur nuk ka fe që e përqafojnë njerëzit më shumë sesa Islamin, a nuk është kjo ndihma e Allahut?

Kjo sure tregon edhe etikën profetike në momentin që atij i vjen ndihma e Allahut dhe mundësohet çlirimi i Mekës. Ai nuk jepet pas këtij gëzimi dhe nuk e angazhon veten me ata të cilët e detyruan ta braktisë vendlindjen, e keqtrajtuan dhe e penguan në thirrjen e tij, por duke qenë hipur në deve fillon të bëjë tesbih, të falënderojë Allahun dhe të kërkojë falje prej Tij.

Imam Ahmedi shënon se na ka treguar Muhamed bin ebij Adij nga Davudi, nga Shabiju, nga Mesruku, se ka thënë: *"Ka thënë Aishja: "Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) shpeshtoi istigfarin në fund të jetës së tij (kërkoi falje dhe pendim tek Ai) dhe tha: "Zoti im më lajmëroi se do të shoh shenja në umetin tim dhe më urdhëroi që në moment kur t'i shoh, të bëj tesbih, ta falënderoj, t'i kërkoj falje dhe pendim. Unë i pashë ato..."*

Kur zbriti kjo sure, Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) edhe pse ishte ndër njerëzit që më së shumti bënte ibadet dhe ia kishte frikën Allahut, filloi ta shpeshtojë në ruku dhe sexhde

---

<sup>294</sup> Kur'an, Bekare: 214.

frazën "Subhaneke Allahume rabena ue bihamdike, Allahume igfir lij." Në shqip: "I lartësuar je o Allah, Zoti ynë. Lavdërimi të takon ty. O Allah, më fal mua!"<sup>295</sup>

Sahabët kanë rënë në ujdi se kjo sure paralajmëron vdekjen e Pejgamberit sal- lAllahu alejhi ue sel-lem, ngase ashtu siç ka pasur shenja para lindjes për pejgamberllëkun e tij, edhe kjo sure ka qenë shenjë për vdekjen e tij, por edhe pas saj ka pasur edhe disa shenja të tjera që kanë treguar për vdekjen e tij, si: zbritja e ajetit: "*Sot jua përsosa fenë tuaj...*"<sup>296</sup>. Pastaj i Dërguari (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) vizitoi dëshmorët e Uhudit dhe varrezat e Bekijave, u lut dhe kërkoi falje për ta, dha lëmoshë nëntë dinarët që posedonte dhe liroi robërit që kishte.

Atë e shqetësonte mosinteresimi i njerëzve për besimin, por nuk shqetësohej aspak pse njerëzit e nënçmonin. Në fund, ai vetëm tha: "O Zoti im, nëse Ti nuk je i hidhëruar, unë nuk mërzitem aspak për atë që më ka ndodhur!"

Ndoshta thua e mendon se si do të ishte jeta e tij sikur të kishte zgjatur edhe pak e të kënaqej me fitoren dhe ngadhënjimin e arritur? Por unë them se me ngadhënjimin dhe fitoren kënaqen vetëm ata që

---

<sup>295</sup> Buhariu në librin e tefsirit, kapitulli "Idha xhae nasr Allah" (4968). Muslimi në librin e namazit, kapitulli "Çfarë thuhet në ruku dhe sxhde" (484), (217).

<sup>296</sup> Kur'an, Maide: 3.

synojnë kryelartësinë dhe mburrjen. Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) nuk ishte i tillë. Ai në ditët e fundit të jetës u detyrua të kërkonte ushqim për anëtarët e familjes së tij, ngase nuk kishte gjë për të ngrënë. Kërkoi ushqim nga një tregtar hebre, i cili i tha se do t'i jepte ushqim vetëm nëse i linte diçka si peng. Asokohe i Dërguari ishte në kulmin e sundimit, para ushtrisë së tij ishin mposhtur të gjithë fuqitë jobesimtare; perandoria romake i kishte fshehur gjurmët e saj në Gadishullin Arabik, kurse të gjitha vendbanimet hebraike ishin dorëzuar. Po që se i Dërguari i Allahut kërkonte nga shokët e tij të paguanin çmimin e ushqimit të tij, kjo për ta do të ishte nder i lartë, që do të vlente në këtë botë dhe në botën tjetër.

Mirëpo i Dërguari i Allahut nuk e bëri këtë. Ai i tha hebreut: *"Unë jam besnik në tokë dhe qiell, merre pengun që kërkon"* dhe i dha mburojën që kishte me vete. I Dërguari vdiq, kurse mburoja e tij mbeti edhe më tej peng në duart e hebreut, të cilit ia kishte dhënë për ta siguruar kafshatën e gojës për familjen e tij.

Më thoni, çfarë përfitoi nga kjo dynja?!

Pastaj vjen shpallja e Allahut, e cila e lë të zgjedhë: të qëndrojnë në këtë dynja apo të takojë Allahun.

Ai tha: "Më mirë është të takoj Allahun!"

Muhamedi e takoi Zotin e tij dhe mbeti i kënaqur me të mirat e Tij. Tani ai është me të Dërguarit që

erdhën para tij dhe me engjëjt e lartë që e shoqërojnë:

فِي مَقْعَدِ صِدْقٍ عِنْدَ مَلِيكٍ مُّقْتَدِرٍ

***“...në kuvendin e së vërtetës (në xhenet), tek një Sundues i Plotfuqishëm.”***<sup>297</sup>

I lartësuar qofsh o Zoti ynë, Ty të takon lavdërimi dhe falënderimi. O Zot, falna mëkatet, lëshimet tona, na forco në fenë Tënde dhe ndihmona ndaj popullit jobesimtar!

---

<sup>297</sup> Kur'an, El-Kamer: 55.



## SURJA EL-MESSED (FLAKA)

Lloji: Mekase, nr.111, ajete 5

Përmbajtja: Tërheqja e vërejtjes për Ebi Lehebin dhe gruan e tij si dhe paralajmërim për përfundimin e tyre.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (١) مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا  
كَسَبَ (٢) سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ (٣) وَامْرَأَتُهُ حَمَّالَةَ  
الْحَطَبِ (٤) فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ (٥)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!*

- 1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit<sup>298</sup> dhe u thaftë në gjithçka!*
- 2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera<sup>299</sup>.*
- 3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara,*
- 4. po ashtu edhe gruaja e tij<sup>300</sup>, që mbart drutë e zjarrit,*

<sup>298</sup> Ebu Leheb (babai i flakës) ishte nofka e Abdul 'Uzzasë, birit të Abdul Muttalibit, pra xhaxhait të Profetit (a.s.). Kur u bë kryetar i fisit të Hashimive, pas vdekjes së Ebu Talibit, ai refuzoi ta vazhdonte mbrojtjen fisnore për Muhamedin (a.s.) dhe e la atë të ekspozuar ndaj armiqësisë së idhujtarëve.

<sup>299</sup> Ebu Lehebi tallej me Profetin (a.s.) duke thënë: "Nëse është e vërtetë ajo që thotë nipi im, unë kam mjaft pasuri dhe djem sa për të paguar shpërblësën time."

<sup>300</sup> Ajo quhej Umm Xhumejl bint Harb dhe kishte një rol kryesor në armiqësinë që burri i saj ushqente ndaj nipi të tij, Profetit (a.s.). Ajo ishte motra e Ebu Sufjanit, që në atë kohë do të udhëhiqte luftën e idhujtarëve kundër muslimanëve.

Me mllefin e saj, ajo hidhte përreth shtëpisë së Muhamedit (a.s.) ferra dhe gjemba, me shpresën që ai të lëndohej gjatë kthimit në shtëpi natën.

## ***5. në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme.***

### **Emërtimi**

Quhet surja "Mesed", që do të thotë "Flaka" dhe "Litar prej fijesh palme", që aludon për litarin që do ta mbajë në zjarr Umu Xhemil, gruaja e Ebu Lehebit. Njihet edhe si surja "Tebet", "Iu thafshin duart Ebu Lehebit", surja "Ebij Leheb" ose surja "Leheb".

### **Shkaku i zbritjes**

Imam Buhariu ka transmetuar prej Ibn Abasit se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) në një mëngjes ka dalë në luginën Bet'ha, është ngjitur në kodër dhe ka thirrur: "Ja sabbahah!"<sup>301</sup> Pas pak rreth tij u mblodhën Kurejshët dhe u tha: "Ç'mendoni nëse ju them se armiku do t'ju sulmojë në mëngjes apo mbrëmje, a do të më besonit?" I thanë se po. I Dërguari i Allahut tha: "Atëherë, unë jam këtu për t'jua tërhequr vërejtjen për një dënim të ashpër që do të pasojë". Ebu Lehebi i tha: "A për këtë na ke thirrur, u shkatërroftë!" Për këtë, Allahu i Madhërisëm shpalli këtë sure të plotë<sup>302</sup>.

---

<sup>301</sup> Kjo është thirrje kur tërhiqet vëmendja për ndonjë rrezik.

<sup>302</sup> Buhariu "Fet'hu-l-Bari", vëll. VIII, fq. 609.

## Kuptimi i ajeteve

تَبَّتْ يَدَا أَبِي لَهَبٍ وَتَبَّ (١)

### *1. Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithçka.*<sup>303</sup>

Fjala “tebet” ka kuptimin shkatërrim. Mukatil do të thotë "humbur, u thafshin". A'ta thotë se kuptimi i saj është humbje. Kjo është dua kundër tij për shkatërrim dhe ai me të vërtetë u shkatërrua.

Në këtë kontekst është edhe fjala e Allahut: *“por dredhia e tij e çoi vetëm në rrënim (humbje)*<sup>304</sup>.”

Ky është lajm nga qielli që iu shpall Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), se Ebu Lehebi do ta humbë dynjanë dhe ahiretin. Ai u godit nga një sëmundje e rëndë, e cila e bëri të vuajë dënimin në këtë botë ende pa shijuar zjarrin e garantuar për shkak të urrejtjes dhe keqtrajttimeve ndaj të Dërguarit të Allahut.

Pse janë përmendur duart e jo trupi?

Këtu janë përmendur dy duart edhe pse ky mallkim ka qenë për tërë trupin dhe jo vetëm për duart e tij, por në gjuhën arabe shpeshherë përmendet pjesa që aludon për trupin. Duart janë mjete me të cilat njeriu bën veprat e tij, merr dhe jep.

Kush është Ebu Lehebi?

---

<sup>303</sup> Kur'an, Mesed: 1.

<sup>304</sup> Kur'an, Gafir: 37.

Abdul Uzza, i biri i AbdulMotalibit, me nofkën Ebu Leheb (babai i flakës) për shkak se fytyra e tij ka pasur ngjyrë flake. Pra, xhaxhai i Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e ka ofenduar, urryer, përqeshur dhe nënçmuar shumë të Dërguarin e Allahut dhe fenë e tij.

Xhaxhallarët e tjerë të Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishin: Hamzai, Abasi, Ebu Talibi, emri i të cilit ishte Abdul Menaf, Zubejr, Abdul Kabe, Mukavim, Darar, Mugireh, Musab. Thuhet edhe Nevfeli dhe disa kanë shtuar Avamin. Islamin e kanë përqaftuar vetëm Hamzai dhe Abasi. Kur Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u bë Pejgamber ishin gjallë Hamzai, Abasi, Ebu Talibi dhe Ebu Lehebi<sup>305</sup>.

Pse është përmendur nofka e tij Ebu Leheb dhe jo emri Abdul Uzza?

Imam Kurtubiu përgjigjet duke thënë:

Emri i tij ka qenë Abdul Uzza, rob i Uzzasë. Allahu nuk ka dashur që “ubudijen”, adhurimin që i takon vetëm madhërisë së Tij, t’ia dedikojë dikujt tjetër në Kur'an, qoftë edhe me përmendjen e emrit të tij, si Abdul Uzza<sup>306</sup>.

Ai ka qenë i njohur me nofkën e tij në mesin e njerëzve më shumë sesa me emrin e tij.

---

<sup>305</sup> "Zadul Mead", vëll. I, fq. 102.

<sup>306</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X. fq. 459.

Emri është diçka më e ndershme për njeriun sesa nofka e tij. Allahu e ka nënvlerësuar atë duke e thirrur me diçka të mangët, siç është nofka, ngase Allahu në Kur'an të gjithë Pejgamberët i ka thirrur me emrat e tyre e jo me nofkë.

Allahu deshi t'ia realizojë dëshirën Ebu Lehibit pasi ai e pranoi me dëshirë nofkën "babai i flakës", që ta fuste në flakë të xhehenemit. Imam Ahmedi ka transmetuar prej Ebu Zinadit se ka thënë: "Më ka lajmëruar një person me emrin Rebi'a ibn Ibadi pjesëtar i fisit Beni Dejjil, i cili ka qenë idhujtar e pastaj kaloi në Islam, e më ka thënë: "Në kohën e injorancës, e kam parë të Dërguarin e Allahut në tregun Dhul-Mexhaz teksa u thoshte njerëzve: "O njerëz, thoni 'La ilahe il- lAllah', s'ka Zot pos Allahut, do të shpëtoni". Njerëzit ishin tubuar rreth tij, ndërkaq pas tij ishte një person me fytyrë flakëruese, syshtrembër e me flokë të përdredhur, i cili thoshte: "Gënjen, e ka lënë fenë e vet!" Ky person e ndiqte të Dërguarin e Allahut kudo që shkonte. Unë pyeta se kush është ky person, e m'u përgjigjën: "Ebu Lehebi, xhaxhai i tij"<sup>307</sup>."

A i bëri atij dobi pasuria në këtë botë?!

مَا أَغْنَىٰ عَنْهُ مَالُهُ وَمَا كَسَبَ (٢)

**2. Nuk do ta ndihmojnë atë as pasuria dhe as fitimet e tjera**<sup>308</sup>

---

<sup>307</sup> Ahmedi, vëll. III, fq. 343.

<sup>308</sup> Kur'an, Mesed: 2.

Ibn Abasi dhe disa të tjerë kanë komentuar se me fjalët *"fitimet e tjera"*<sup>309</sup> aludohet për fëmijët e Ebu Lehebit<sup>310</sup>. Komenti i tillë është transmetuar edhe prej Aishes, Muxhahidit, Ataut, El-Hasenit dhe Ibn Sirinit<sup>311</sup>.

Është përcjellë prej Ibn Mes'udit se si i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), kur i ka thirrur njerëzit në besim, Ebu Lehebi ka thënë: "Nëse është e vërtetë ajo që thotë djali i vëllait tim, unë do ta shpëtoj veten prej dënimit të dhimbshëm në Ditën e Kiametit me pasurinë dhe fëmijët e mi". Prandaj Allahu ia zbriti këtë ajet.

Pra, e vërteta është se *"fitimet e tjera"*<sup>312</sup> përfshijnë gjithçka që ka përfituar apo që do të përfitojë në të ardhmen, nëpërmjet së cilës ngrihet dhe merr pozitë<sup>313</sup>.

Pasurinë që posedon dhe fëmijët nuk do ta mbrojnë nga shkatërrimi në këtë botë dhe zjarri në botën tjetër<sup>314</sup>.

Pastaj Allahu i Madhërishëm përmend gjendjen e tij në të ardhmen.

سَيَصْلَىٰ نَارًا ذَاتَ لَهَبٍ (٣)

**3. Ai, me siguri, do të hidhet në zjarrin me flakë të tërbuara**<sup>315</sup>.

---

<sup>309</sup> Kur'an, Mesed: 2.

<sup>310</sup> Taberiu, vëll. XXIV, fq. 667.

<sup>311</sup> Taberiu, vëll. XXIV, fq. 667.

<sup>312</sup> Kur'an, Mesed: 2.

<sup>313</sup> Ibn Uthejmin, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 347.

<sup>314</sup> El-Eshkar, "Zubdet Tefsir", fq. 825.

Do të thotë në zjarr me flakë të fortë, me shkëndija dhe që djeg fuqishëm<sup>316</sup>.

Do ta kaplojë zjarri nga të gjitha anët<sup>317</sup>.

Do të dënohet në zjarr të tërbuar, që do t'i djegë lëkurën, në zjarrin e xhehenemit<sup>318</sup>. Por nuk do të jetë i vetëm, atë do ta shoqërojë në zjarr edhe gruaja e tij.

وَأَمْرًا أَنَّهُ حَمَّالَةٌ الْحَطَبِ (٤)

#### **4. po ashtu edhe gruaja e tij, që mbart drutë e zjarrit<sup>319</sup>**

Gruaja e tij ishte prej elitës së grave Kurejshe, e thërrisnin Umu Xhemil (nëna e Xhemilit), por emri i saj i vërtetë ishte Erva bint Harb bin Umeje, motra e Ebu Sufjanit. Ajo ishte krahu i djathtë i burrit të saj në mosbesim, injorim dhe kundërshtim me kokëfortësi ndaj së vërtetës. Nisur nga kjo, ajo do të jetë së bashku me të kur të dënohet në zjarrin e xhehenemit, në Ditën e Kiametit. Për fjalët e të Lartmadhërishmit "*që mbart drutë e zjarrit*"<sup>320</sup>, Zejdi dhe Dahaku kanë thënë: "Bartte gjemba dhe i hidhte në rrugën ku ecte Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe shokët e tij, që të

<sup>315</sup> Kur'an, Mesed: 3.

<sup>316</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 514.

<sup>317</sup> Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan", fq. 866.

<sup>318</sup> El-Eshkar, "Zubdet tefsir", fq. 826.

<sup>319</sup> Kur'an, Mesed: 4.

<sup>320</sup> Po aty.

shkelnin mbi to. Këtë e bënte zakonisht natën”. Ky transmetim është i Atijes nga Ibn Abasi<sup>321</sup>.

Katade, Muxhahidi dhe Sidiju kanë thënë se ka për qëllim se “ajo bartte fjalë dhe me këtë mbillte armi- qësi, bënte përçarje mes njerëzve dhe ndizte mes tyre zjarr ashtu siç i ndez zjarri drutë<sup>322</sup>.”

Ibn Ebi Hatimi ka transmetuar me zinxhir transme- tuesish prej Esmës, vajzës së Ebu Bekrit, se ka thënë: “Kur u shpallën fjalët të Lartmadhërishmit”, erdhi gruaja e shëmtuar, Umu Xhemil bint Harb, duke kukatur dhe duke mbajtur një gur në dorë e tha: “Të qortuarin e refuzuam, fenë e tij e urryem dhe thirrjen e tij e kundërshtuam!” Në këtë kohë, i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) bashkë me Ebu Bekrin rrinin ulur në faltore. Ebu Bekri, kur e pa, tha: “O i Dërguari i Allahut, ajo është nisur drejt nesh, frikësohem se mos të sheh.” I Dërguari i Allahut tha: “Ajo assesi nuk do të më shohë” dhe recitoi pjesë nga Kur'ani për mbrojtje. I Lartma- dhërishmi për këtë ka thënë:

وَإِذَا قَرَأْتَ الْقُرْآنَ جَعَلْنَا بَيْنَكَ وَبَيْنَ الَّذِينَ لَا يُؤْمِنُونَ بِالْآخِرَةِ حِجَابًا مَّسْتُورًا

***"Kur ti e lexon Kur'anin, në mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, Ne vëmë një perde të pa- dukshme."***<sup>323</sup>

---

<sup>321</sup> Bagaviu, “Muhtesar Tefsir El-Bagauij”, ose siç njihet “Mealim Et-Nzil”, vëll. 2, fq. 1037.

<sup>322</sup> Po aty.

<sup>323</sup> Kur'an, Israë: 45.



Ajo erdhi dhe u ndal para Ebu Bekrit, nuk e pa të Dërguarin e Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe iu drejtua Ebu Bekrit e i tha: “O Ebu Bekër, kam marrë vesh se shoku yt më ka përqeshur.” Ebu Bekri i tha: “Jo, pasha Zotin e Qabesë, nuk të ka përqeshur!” Atëherë u kthye duke thënë: "Kurejshët e dinë se unë jam bija e të parit të tyre."<sup>324</sup>

فِي جِيدِهَا حَبْلٌ مِّن مَّسَدٍ (٥)

**5. në qafën e saj do të ketë një litar prej fijesh palme<sup>325</sup>.**

Muxhahidi dhe Urve kanë komentuar: “Do të jetë litar prej zjarri<sup>326</sup>.”

El A’uiufi ka kuptuar prej Ibn Abasit, Ed-Dahakut dhe Ibn Zejdit se kanë thënë: "Ajo ka vënë gjemba në rrugën ku ka kaluar i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)."

Xheuheriu ka shpjeguar se fjala “el-mesed” ka kuptimin “fije palme”. Po ashtu, “el-mesed” ka kuptimin “litar prej fijeve të palmës”. Ka mundësi që të jetë edhe prej lëkurës apo leshit të devesë.

Ibn Uthejmini thotë: “Kishte një litar në qafë, me të cilin mbante gjemba dhe drunj, i lidhte ato dhe më pas i hidhte në rrugën ku ecte i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

<sup>324</sup> Buhariu, "Fethul'Barî", vëll. VIII, fq. 610.

<sup>325</sup> Kur'an, Mesed: 5.

<sup>326</sup> "Ed-Durrerr el-menthur", vëll. VIII, fq. 667.

Kështu e poshtëroi veten, edhe pse ishte me famë, nga fisi Kurejsh, e uli veten në këtë pozitë dhe ky litar do të jetë zjarr për të në Ditën e Gjykimit. Allahu na mbrojtë nga një gjest i tillë<sup>327</sup>!

Muxhahidi fjalët e të Lartmadhërishimit: *"në qafën e saj do të ketë një litar prej fijeve palme"*<sup>328</sup>, i ka komentuar si "qafore prej hekuri"<sup>329</sup>.

Ibn Zejdi thotë: "Litar nga një dru që rritet në Jemen, që quhet mesed"<sup>330</sup>.

Haseni thotë: "Mbante rruaza në qafë"<sup>331</sup>.

Ajo kishte një qafore me vlerë, për të cilën u betua në zotat e rrejshëm, Uzzanë dhe Latin, se do ta shpenzonte në armiqësi kundër të Dërguarit të Allahut, por do të jetë dënim për të në Ditën e Kiametit<sup>332</sup>.

### Mësimë<sup>333</sup>

Kjo sure tregon ligjet e Allahut Fuqplotë në këtë

---

<sup>327</sup> Ibn Uttejmini, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 347.

<sup>328</sup> Kur'an, Mesed: 5.

<sup>329</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 681.

<sup>330</sup> Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. 2, fq. 1037.

<sup>331</sup> Po aty.

<sup>332</sup> El-Eshkar, "Zubdet Tefsir", fq. 826.

<sup>333</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanij, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-

botë dhe botën tjetër për shkatërrimin e Ebu Lehebit dhe prishjen e kurtheve të tij kundër Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të).

- Askujt nuk do t'i bëjë dobi pasuria dhe as fëmijët nga dënimi i Allahut, nëse largohet nga kënaqësia e Tij subhanehu ue teal.
- Kjo sure aludon edhe për shenjtërinë e nderit të muslimanëve në përgjithësi dhe se i tillë do të jetë fundi i keqbërësve.
- Afërsia familjare nuk e shpëton njeriun nga zjarri, siç ndodhi me Ebu Lehebin, xhaxhanë e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), i cili do të jetë në zjarr.
- Tre ajetet e para aludojnë për lajmërimin për gajbin nga tre aspekte:
  - a) Lajmërimi për Ebu Lehebin me shkatërrim dhe humbje e kjo gjë ndodhi.
  - b) Lajmërimi se ai nuk do të përfitojë nga pasuria e tij edhe kjo u pa.

---

Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Uthejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Alij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-l Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkijj, "Sherh Akide Et-Tahauije"; Shejh Islam ibn Tejmiye, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhevzijeh, "Zadul Mead"; Ibn Kajim El-Xhevzijeh, "Feuaid"; Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase".

- c) Lajmërimi për të se do të jetë nga banorët e zjarrit edhe kjo ndodhi sepse ai vdiq në mosbesim
- Dijetarët kanë përmendur se kjo kaptinë është mrekulli për pejgamberllëkun e Muhamedit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), ngase ajo që i kishte zbritur për këta dy persona ishte një ngjarje e gjallë, për ata që janë të zotët e mendjes.
  - Ky është personi i vetëm që Allahu e ka thirrur me nofkë në Kur'an, Ebu Leheb.
  - Allahu në shumë vende në Kur'an urdhëron që jobesimtarët të thirren "thuj: o ju jobesimtarë", ndërsa në këtë sure Allahu e thirri xhaxhanë e Pejgamberit me nofkën e tij. Jo për diçka, por për të mos i lënë hapësirë dikujt të thotë se si Pejgamberi i Allahut nuk po e respekton xhaxhanë, po e thërret me një thirrje që nuk i përket etikës ndaj xhaxhait.
  - Allahu ka shumë armiq, por në librin e shenjtë përmendi me emra vetëm disa prej tyre, ndër ta janë edhe Ebu Lehebi dhe gruaja e tij.
  - Ebu Lehebi jetoi deri pas Luftës së Bedrit, por u privua të dalë në këtë luftë që të mos i jepet rasti të vdesë me nder sepse edhe pse nuk ishte besimtar, vdekja në fushën e betejës është nder. Transmetohet se Ebu Lehebi pati vuajtje të dhimbshme nga një sëmundje, madje fëmijët e tij u larguan duke pasur frikë se mos i godet edhe ata. Ata nuk patën mundësi as ta përgatisin për ta varrosur, por e tërhoqën zvarrë derisa e hodhën në një gropë dhe e mbuluan shpejt.

O Zot, mos na bëj nga ata mbi të cilët që zbret hidhërimin Tënd e të na shndërrohet jeta e kësaj bote në ferr!

O Zot, na ruaj nga armiqtë e Tu dhe jepu ndëshkimin në këtë botë dhe botën tjetër atyre që u bëjnë keq besimtarëve të Tu!

O Allahu ynë! Mos na verbo në këtë botë nga drita Jote! O më i madhi i gjithësisë!

## SURJA EL-IHLAS<sup>334</sup> (SINQERITETI)

Lloji: Mekase, nr. 112, ajete 4

Përmbajta: Njëshmëria e Allahut

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (١) اللَّهُ الصَّمَدُ (٢) لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (٣) وَلَمْ يَكُنْ  
لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (٤)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!*

- 1. Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!*
- 2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim<sup>335</sup>.*
- 3. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur.*
- 4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”*

### Emërtimi

Quhet surja "Ihlas-Sinqueriteti" ngase flet për njëshmërinë e Allahut të Madhëruar, që është i pastër nga

---

<sup>334</sup> Sipas një transmetimi nga Profeti (a.s.), leximi i sures “El Ihlas” ka vlerën e leximit të një së tretës së Kur'anit. Njëri nga shokët e Profetit (a.s.), Ubej Ibn Ka'bi, ka përcjellë se shkak për zbritjen e saj ka qenë një kërkesë që idhujtarët arabë i bënë Muhamedit (a.s.), kur i thanë: “O Muhamed! Na përshkruaj Zotin tënd”. Atëherë, Allahu shpalli këtë sure, që është quajtur nga disa komentues si “sinteza e përsosur e teuhidit”, e monoteizmit islam.

<sup>335</sup> Ky është përkthimi i emrit të Allahut “Es-Samed”, që ndër të tjera ka edhe kuptimet: “Ai që ka njëshmërinë absolute”, “I Përbjeshmi” dhe “I Papërshkueshmi”, pra, Ai që nuk ka brendësi.

çdo gjë, i distancuar nga çdo ortak. Kjo sure e shpëton njeriun nga shirku apo zjarri. Njihet edhe si surja “Kul-huvallahu ehad”, ashtu siç e ka quajtur Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), si “Kul-huvallah”, pa e përmendur “ehad”. “Allahu vahid Es-Samed”, siç e shënon Imam Buhariu. “Es-Samed”<sup>336</sup>, që është emër prej emrave të Allahut, është përmendur vetëm në këtë sure dhe nuk është përmendur në ndonjë vend në Kur'an. “Teuhid-Njëshmëria”, “Nexhah-Shpëtim”, “Velaje-Miqësi”, ngase kush e lexon, bëhet nga miqtë e Allahut. Quhet ndryshe edhe “Esas-Bazament”, ngase përmbledh bazat e fesë<sup>337</sup>.

## Shkaku i zbritjes

Dahaku, Mukatili dhe Katade kanë thënë: "Erdhën disa njerëz tek i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe i thanë: "Përshkruana Zotin tënd. Zoti na e ka treguar në Tevrat përshkrimin e Tij. Na trego, nga se përbëhet Ai? Çfarë llojit i takon? Nga ari, bakri apo argjendi? A ha dhe pi? Nga kush e ka trashëguar dynjanë dhe kujt do t'ia trashëgojë? Allahu e shpalli këtë sure që i referohet vetëm Madhërisë së Tij në veçanti<sup>338</sup>."

---

<sup>336</sup> Ka kuptimin “**Allahu është Absoluti**”.

<sup>337</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsiru-l Munir", vëll. XV, fq. 870.

<sup>338</sup> Elvahidij, "Esbabu-l Nuzul", fq. 751.

Imam Ahmedi ka transmetuar prej Ubej ibn Ka'bit se idhujtarët i janë drejtuar të Dërguarit të Allahut dhe i kanë thënë: “O Muhamed, na trego gjenezën e Zotit tënd”. Për këtë, Allahu i Madhërishëm shpalli: **”Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!”**<sup>339</sup>

## Kuptimi i ajeteve

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ (١)

1. Thuaj: **“Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!”**<sup>340</sup>

Thuaj o ti i Dërguar (Muhamed), atyre që të pyetën t'ia përshkruash Zotin tënd: **“Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!”**<sup>341</sup>

Ikrimeja ka thënë: “Kur çifutët thanë "ne adhurojmë Uzejrin, të birin e Zotit", të krishterët thanë "ne adhurojmë Mesihun, birin e Zotit", zjarrëputistët thanë "ne adhurojmë Diellin dhe Hënën", kurse idhujtarët thanë "ne adhurojmë idhujt", atëherë Allahu i Madhërishëm i shpalli të Dërguarit të Tij: **“Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!”**<sup>342</sup>

Ai është një, i vetëm, nuk ka as ortak e as ndihmës, nuk ka rival dhe të ngjashëm me Të. Këto cilësi dhe emra i takojnë vetëm Allahut të Madhërishëm, ngase

---

<sup>339</sup> Kur'ani, Ihlas: 1.

<sup>340</sup> Kur'ani, Ihlas: 1.

<sup>341</sup> Kur'ani, Ihlas: 1.

<sup>342</sup> Kur'ani, Ihlas: 1.



vetëm Ai është i përkryer në të gjitha cilësitë dhe veprat e Tij.

اللَّهُ الصَّمَدُ (٢)

## **2. Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim<sup>343</sup>.**

Ikrime ka transmetuar prej Ibn Abasit se ka komentuar: "Es-Samed është Ai të Cilit i drejtohen të gjitha krijesat për nevojat dhe kërkesat e tyre<sup>344</sup>."

Ali Ibn Talha ka transmetuar prej Ibn Abasit se ka komentuar: "Es-Samed është Zoti që zotëron çdo gjë në mënyrë të përkryer; Ai është Fisniku i përkryer në fisnikërinë e Tij; Ai është i Madhërishmi absolut që është i përkryer në Madhështinë e Tij; Ai është i Buti i përkryer në butësinë e Tij; Ai është i Dijshmi i përkryer në diturinë e Tij; Ai është i Urti i përkryer në urtësinë e Tij. Ai është Allahu, që është i pastër nga çdo e metë, veç Tij nuk mund t'i ketë askush tjetër këto veti. Ai nuk ka rival dhe asgjë nuk i përngjan Atij. Qoftë i lartësuar Allahu, që është një i vetëm dhe Sundues i çdo sendi<sup>345</sup>."

"Samed" ka disa kuptime<sup>346</sup>:

- I pavarësuar nga çdo gjë, për të ka nevojë çdokush.
- Ai që vepron çfarë të dëshirojë dhe gjykon çfarë të dojë.

<sup>343</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

<sup>344</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VIII, fq. 520.

<sup>345</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 692.

<sup>346</sup> E-sheukani, "Fethul Kadir", vëll. V, fq. 698.

- I ploti në cilësitë e Tij, pa të meta.
- Ai që ka njëshmëri absolute.
- I Përjetshmi.
- I Papërshkrueshmi.
- Ai që nuk ka brendësi.

لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ (٣)

### 3. *Ai as nuk lind, as nuk është i lindur*<sup>347</sup>.

Do të thotë se Allahu nuk ka as fëmijë, as prindër dhe as grua. Në pjesën e parë "*Ai as nuk lind*<sup>348</sup>" mohohet që Allahu të ketë djalë dhe në të njëjtën kohë u përgjigjet idhujtarëve që supozonin se engjëjt janë bijat e Zotit, u përgjigjet çifutëve që supozonin se Uzejri është i biri i Zotit, u përgjigjet edhe të të krishterëve që thoshin se Isai është i biri i Zotit. Ndërsa në pjesën e dytë "*as nuk është i lindur*<sup>349</sup>", mohon që Allahu të ketë prind<sup>350</sup>.

Imam Buhariu ka transmetuar në "Sahihun" e tij hadithin: "Askush nuk është më durimtar se Allahu për ofendimet që dëgjon. Ata i përshkruajnë Allahut fëmijë, ndërkaq Ai i furnizon dhe u jep shëndet<sup>351</sup>."

وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ (٤)

---

<sup>347</sup> Kur'an, Ihlas: 3.

<sup>348</sup> Kur'an, Ihlas: 3.

<sup>349</sup> Kur'an, Ihlas: 3.

<sup>350</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsiru-l Munir", vëll. XV, 868.

<sup>351</sup> Buhariu, "Fethu-l Bari", vëll. XIII, fq. 372.

#### 4. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!<sup>352</sup>

Domethënë askush nuk është i njëjtë me Allahun, me të gjitha atributet që ka. Allahu ka mohuar për Vetën e Tij që të ketë prind, fëmijë apo që dikush të jetë i barabartë me Të<sup>353</sup>.

Askush nuk është i barabartë me Të, as krahasohet dhe nuk bën pjesë me Të në diçka<sup>354</sup>.

Askush nuk është i barabartë me Allahun në emrat, cilësitë dhe veprat e Tij<sup>355</sup>. Ky ajet zhvlerëson doktrinën e idhujtarëve arabë, se Allahu ka ortakë në veprimet e Tij, pasi ata merrnin për zota të tyre engjëjt dhe idhujt si ortakë të Allahut për të ndërmjetësuar tek Ai<sup>356</sup>. Muxhahidi ka komentuar se fjalët e të Lartmadhërishtit: *“Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!”*<sup>357</sup> kanë kuptimin “Ai nuk ka bashkëshorte”. Në këtë kuptim janë edhe fjalët e të Lartmadhërishtit:

بَدِيعُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ ۖ أَنَّىٰ يَكُونُ لَهُ وَلَدٌ وَلَمْ تَكُن لَّهُ  
صَاحِبَةً ۖ وَخَلَقَ كُلَّ شَيْءٍ ۖ وَهُوَ بِكُلِّ شَيْءٍ عَلِيمٌ

<sup>352</sup> Kur'an, Ihlas: 4.

<sup>353</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 350.

<sup>354</sup> El-Eshkar "Zubdet Tefsir", fq. 826.

<sup>355</sup> Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan", fq. 866.

<sup>356</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsiru-l Munir", vëll. XV, fq. 868.

<sup>357</sup> Kur'an, Ihlas: 4.

*“Ai (Allahu) është që krijoi (pa kurrfarë shembulli) qiejt dhe tokën (e duke qenë i tillë), e si do të ketë Ai fëmijë kur nuk pati bashkëshorte? Çdo send e krijoi Ai dhe është më i dijsmimi për të gjitha sendet e krijuara<sup>358</sup>.”*

Kuptim i kësaj është se Allahu është sundues dhe krijues i çdo sendi, prandaj si mund të ketë ortakë nga krijesat që Ai Vetë i ka krijuar dhe si mund të ketë ndonjë të afërt që mund të krahasohet me Të?! Allahu është i lartësuar dhe i pastër nga këto. Në këtë kontest janë edhe ajetet:

وَقَالُوا اتَّخَذَ الرَّحْمَنُ وَلَدًا (٨٨) لَقَدْ جِئْتُمْ شَيْئًا إِدًّا (٨٩) تَكَادُ  
السَّمَاوَاتُ يَنْقَطِرُنَ مِنْهُ وَتَنْشَقُّ الْأَرْضُ وَتَخِرُّ الْجِبَالُ هَدًّا (٩٠) أَنْ  
دَعَوْا لِلرَّحْمَنِ وَلَدًا (٩١) وَمَا يَنْبَغِي لِلرَّحْمَنِ أَنْ يَتَّخِذَ  
وَلَدًا (٩٢) إِنْ كُلُّ مَنْ فِي السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ إِلَّا آتَى الرَّحْمَنِ  
عَبْدًا (٩٣) لَقَدْ أَحْصَاهُمْ وَعَدَّهُمْ عَدًّا (٩٤) وَكُلُّهُمْ آتِيهِ يَوْمَ الْقِيَامَةِ  
فَرْدًا

88. *"Ata thonë: "I Gjithëmëshirshmi ka një bir".*

89. *Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme!*

90. *Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s'çahet e malet sa s'rrëzohen të thërrmuar,*

91. *nga që ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit.*

92. *Kurrë nuk i shkon (madhërisë së) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir.*

<sup>358</sup> Kur'an, En'am: 101.

93. *S'ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit.*

94. *Sigurisht që Ai e njuh mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht.*

95. *Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij<sup>359</sup>.*

Imam Buhariu ka kumtuar prej Ebu Hurejrës se i Dërguari i Allahut ka thënë: *"Allahu i Madhërishëm ka thënë: "Më ka përgënjeshtuar i biri i Ademit (njeriu), e nuk i ka takuar ta bëjë këtë. Më ka fyer i biri i Ademit, e nuk i ka takuar ta bëjë këtë. Më ka përgënjeshtuar me fjalët "Allahu nuk mund të më ringjallë ashtu si më ka krijuar herën parë", ndërkohë që për Mua janë të njëjta si krijimi i parë ashtu edhe ringjallja. Ndërkaq më ka fyer me fjalët: "Allahu ka fëmijë", ndërkohë që Unë jam një, i vetëm, Ai të Cilit i drejtohet çdo krijesë, nuk kam lindur askënd dhe nuk jam i lindur prej askujt dhe askush nuk është i barabartë me Mua<sup>360</sup>."*

Mësimë<sup>361</sup>

Surja Ihlas shpalos njohjen e Allahut me emrat dhe

---

<sup>359</sup> Kur'an, Merjem: 88-95.

<sup>360</sup> Buhariu "Fethu-l Bari", vëll. VIII, fq. 611-612.

<sup>361</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet

cilësitë e Tij, është konfirmim i njëshmërisë së Allahut, zhvlerëson doktrinën se Allahu ka djalë.

- Kjo sure është përmbledhëse e besimit në emrat e bukur të Allahut dhe cilësitë e përsosura të Tij.
- Është surja më madhështore në Kur'an, e cila nuk është përsëritur me kuptimet e saj që përmban. Në Kur'an janë pesë sure që kanë filluar me: “Kul-Thuaj”. Ato janë: Kafirun, Ihlas, Felek, Nas dhe surja Xhin. Fjala “Kul-Thuaj” në Kur'an është përmendur gjithsej 321 herë.
- Kjo sure e shkurtër përmban pohim dhe mohim në të njëjtën kohë. Sqaron se Allahu është një, i vetëm në Qenien e Tij i pastër nga çdo anë dhe mohon çdo lloj të shumësit me fjalën ***“Thuaj: “Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!”***<sup>362</sup>
- Sqaron se Allahu është i pastër në Qenien e Tij, Fisnik, i Mëshirshëm, për Të kanë nevojë të gjitha krijesat për t'i realizuar kërkesat e tyre jetësore. Është

---

“Mealim Et-Nzil”, Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanij, “Fethu El-Kadir”; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, “Ed’uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur’an bi El-Kur’an”; Nasir Es-Sadij, “Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan”; Salih El-Uthejmin, “Tefsir El-Kur’an El-Kerim Xhuzi Amme”; Muhamed Sulejman El-Eshkar, “El-Kur’ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir”; Ebij Bekër El-Xhezairij, “Ejser Et-Tefasir Likelam el-Allij El-Kebir”; Uehbe Ezuhejli, “Et-Tefsir El-Munir”; Dr. Aid El-Karni, “Et-Tefsir El-Mujeser”; El Vahidij, “Esbabul En-Nuzul”; Muhamed El-Gazali, “Komenti tematik i Kur’anit Famëlartë”; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, “Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur’an El-Adhim”; Seid Kutb, “Fi Dhilali-l Kur’an”; Ebij El-Izi Eddimeshkij, “Sherh Akide Et-Tahauije”; Shejh Islam ibn Tejmije, “Ubudije”; Ibn Kajim El-Xhevzijek, “Zadul Mead”; Ibn Kajim El-Xhevzijek, “Feuaid”; Emin Bahrami, “Përkhimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase”.

<sup>362</sup> Kur’an, Ihlas: 1.

i cilësuar me cilësi të plota dhe mohon çdo lloj varësie për të tjerët me fjalën *"Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim"*<sup>363</sup>.

- Fjala e Tij: *"Një dhe i vetëm!"*<sup>364</sup> zhvlerëson doktrinën dyshe, sipas së cilës mendohet se gjithësia ka dy zota, dritën dhe terrin. Fjala e Tij: *"Allahu është Absoluti"*<sup>365</sup> zhvlerëson doktrinën se ekziston zot tjetër pos Allahut.
- Fjala e Tij: *"Ai as nuk lind, as nuk është i lindur"*<sup>366</sup> zhvlerëson doktrinën e çifutëve, se Uzejri është i biri i Zotit, të të krishterëve se Isai a.s. është i bir i Zotit, doktrinën e trinitetit dhe atë të idhujtarëve, se engjëjt janë bijat e Allahut. Fjala e Tij: *"Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"*<sup>367</sup> zhvlerëson doktrinën e idhujtarëve për shkak se ata i bëjnë Allahut ortak në adhurim.
- Dijetarët kanë përmendur se kjo sure flet për të drejtën e Allahut ashtu siç flet surja Keuther për të drejtën e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Fyerja ndaj Pejgamberit ishte kur ata thanë se "ai është farësosur", në kaptinën Keuther, ndërsa fyerja ndaj Allahut është kur thanë se Allahu ka djalë. Mospasja fëmijë për njeriun llogaritet mangësi, ndërsa Allahu nuk ka nevojë për bij.

---

<sup>363</sup> Kur'an, Ihlas: 2.

<sup>364</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

<sup>365</sup> Kur'an, Ihlas: 2.

<sup>366</sup> Kur'an, Ihlas: 3.

<sup>367</sup> Kur'an, Ihlas: 4.

Këtu ka thënë “Thuaj” që ta mbrojnë Allahun, ndërsa në suren Keuther nuk është përdorur “Thuaj”, por Allahu e ka mbrojtur Vetë të Dërguarin e Tij.

- Teuhidi (besimi në Allahun një) konsiderohet shpirti i Islamit dhe thelbi i Kur'anit. Atributet të cilat Allahu i përshkruan Vetes bëjnë që çdo gjë pos Tij të jetë rob i pafuqishëm, që s'ka mundësi t'i sjellë as vetvetes e as të tjerëve dobi apo dëm.
- Kur e lexonte Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) këtë sure? Këtë sure Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e lexonte në rekatin e dytë në sunetin e sabahut<sup>368</sup>, në sunetin e akshamit<sup>369</sup>, në rekatin e dytë të tavafit<sup>370</sup> dhe e lexonte në namazin e vitrit<sup>371</sup>, ngase përmban sinqeritet të plotë ndaj Allahut dhe për këtë edhe quhet surja Ihlas.
- Kjo sure është dëshmi dhe konfirmim për besimin islam ashtu sikurse Kafirun mohon çdo përngjasim mes besimit islam dhe besimit politeist. Dhe çdo njëra e shëron besimin nga një kënd. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të), siç transmetohet në transmetime të sakta, e hapte dhe e mbyllte ditën me këtë sure. Në sunetin e namazit të sabahut lexonte suren Kafirun dhe Ihlas, edhe në

---

<sup>368</sup> Shënon Muslimi, 98/726.

<sup>369</sup> Shënon Tirmidhiu, 431, dhe ka thënë se hadithi është garib. Ibn Maxhe, 1166.

<sup>370</sup> Shënon Muslimi, 147/1218.

<sup>371</sup> Shënon Termidhiu, 463.



mbrëmje kur shkonte në shtrat e lexonte suren Ihlas nga tri herë.

- Allahu e do atë person që e lexon suren Ihlas. Buhariu ka transmetuar me zinxhirin e tij të transmetuesve prej Aishes, Allahu qoftë i kënaqur me të, se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka dërguar një person t'i prijë një ekspedite dhe ai kur falej si imam me shoqëruesit namazin e përfundonte me suren Ihlas. Kur u kthyen, shoqëruesit e tij ia treguan këtë të Dërguarit të Allahut e ai u tha: *"Pyeteni, pse e bën këtë?"* Ata e pyetën dhe ai u tha: "Kjo sure flet për vetitë e Bamirësit të Përgjithshëm, prandaj dhe dua ta lexoj". I Dërguari i Allahut tha: *"Lajmërojeni se Allahu i Lartmadhëreshëm e do atë"*<sup>372</sup>.
- Surja Ihlas është një e treta e Kur'anit: Buhariu ka transmetuar prej Ebu Sei'dit se një person e ka dëgjuar një tjetër duke lexuar *"Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!"*<sup>373</sup> dhe këtë e ka përsëritur disa herë. Në mëngjes ka shkuar tek i Dërguari i Allahut dhe ia ka treguar këtë rast. Ai mendonte se kjo sure është e vogël, mirëpo i Dërguari i Allahut i tha: *"Pasha Atë në dorë të të Cilit është shpirti im, kjo sure është sa një e treta e Kur'anit"*<sup>374</sup>.

---

<sup>372</sup> Ibn Rexheb, "Fer'hul-Bari", vëll. XIII, fq. 360. Muslimi, vëll. I, fq. 557, dhe Nesaiu në "Kubra", vëll. VI, fq. 177.

<sup>373</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

<sup>374</sup> Ibn Rexheb, "Fer'hul-Bari", vëll. II, fq. 298.

- Shpërblimet për leximin e kësaj sureje: Imam Maliku ka kumtuar nga Ubejd ibën Hunejni se ka thënë: "E kam dëgjuar Ebu Hurejrën duke thënë: "Isha duke shkuar me të Dërguarin e Allahut dhe dëgjoji një person duke lexuar **"Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!"**"<sup>375</sup> I Dërguari i Allahut kur e dëgjoji, tha: "*U bë obligim*". Unë i thashë: "Çfarë u bë obligim?" Tha: "*U bë obligim për të xheneti*"<sup>376</sup>."
- Leximi i kësaj sureje për mbrojtje: Buhariu ka përcjellë prej Aishes se i Dërguari i Allahut për çdo natë kur ka rënë në shtrat, i ka mbledhur grushtet, pastaj ka fryrë lehtë në to dhe ka lexuar "Ihlas, Kul eudhu bi rabil-Felek, Kul eudhu bi rabi-Nas"<sup>377</sup>. Pastaj me dy pëllëmbët prekte sa të mundej trupin duke filluar prej kokës dhe fytyrës e më poshtë trupit. Këtë e bënte tri herë<sup>378</sup>."
- Lutje me emrat e Allahut që janë përmendur në këtë sure: Nesaiu ka transmetuar prej Abdullah ibën Burejdes e ky prej babait të vet se ka hyrë me të Dërguarin e Allahut në xhami. Kur kanë hyrë, kanë gjetur një person duke u falur dhe duke u lutur si vijon: "O Allah, unë të lutem me atë se dëshmoj se nuk ka zot tjetër pos Teje, Ti je Një, tek i Cili gjen strehim çdo gjë (el-ehadu es-samedu), nuk ke lindur kë dhe nuk je i lindur dhe askush nuk është i bara-

---

<sup>375</sup> Kur'an, Ihalas: 1.

<sup>376</sup> Imam Maluku, "Muveta'", vëll. I, fq. 208.

<sup>377</sup> D.m.th. ka lexuar suren Ihlas, Felek dhe Nas.

<sup>378</sup> Ibn Rexheb, "Fet'hul-Bari", vëll. VIII, fq. 679.

bartë me Ty". Kur i Dërguari i Allahut dëgjoji këtë lutje, tha: *"Pasha Atë në dorë të të Cilit gjendet shpirti im, vërtet e ka lutur Allahun me emrin e Tij më të madh, me të cilin kur i kërkohet diçka, jep, dhe kur lutet, përgjigjet*<sup>379</sup>."

*"O Allah, unë të lutem me atë se dëshmoj se nuk ka Zot tjetër pos Teje, Ti je një, tek i Cili gjen strehim çdo gjë (el-ehadu es-samedu), nuk ke lindur kë dhe nuk je i lindur dhe askush nuk është i barabartë me Ty*<sup>380</sup>."

---

<sup>379</sup> Shënon Nesaiu në "El-Kubra", "Tufetu-l-eshtarf", vëll. II, fq. 90. Ebu Davudi, nr. 1493. Termidhiu, nr. 3475 dhe Ibn Maxhe, nr. 3857.

<sup>380</sup> Termidhiu ka thënë se hadithi është i mirë, i panjohur, hasenun garib.

## SURJA SURJA EL-FELEK (AGIMI)

Lloji: Mekase, nr. 113, ajete 5

Përmbajtja: Kërkimi i mbrojtjes nga Allahu prej të këqijave të krijesave.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (١) مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (٢) وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (٣) وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (٤) وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (٥)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!*

- 1. Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit,*
- 2. që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar*
- 3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri*
- 4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)<sup>381</sup>*
- 5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë<sup>382</sup>. "*

<sup>381</sup> Vargu bën fjalë për një formë magjie të zezë, që praktikohej shumë në Arabinë paraislamike.

<sup>382</sup> Syri i keq që vjen si pasojë e smirës është sigurisht njëra nga format me ndikim më të fortë negativ që mund të gjenden. Nuk mund të mohohet se ky është një instrument të cilin e përdor shejtani për të realizuar ndikime të ndryshme dhe të rënda të njerëzimit: tek ata që e pësojnë, pa i kuptuar dhe pa i njohur shkaqet e "shqetësimit" të tyre; tek ata që përpiqen ta shërojnë "syrin" me praktika të tjera magjike dhe tek ata që e shkaktojnë, duke u bërë kështu bashkëpunëtorë objektivë ose subjektivë të intrigave djallëzore kundër njerëzimit. Për t'u ruajtur nga shejtani, shërben lutja "E'ūdhu bil-lāhi min-esh shejtān-irr raxhīm" (Strehohem tek Allahu kundër shejtanit të mallkuar), por është mirë të kujtohet edhe vargu 99 i sures 16:

## Emërtimi

Quhet surja "Felek-Agimi", është medinase sipas një transmetimi të Ibn Abasit dhe Katades, por mekase sipas shumicës, si Hasenit, A'taut, Ekremes dhe Xhabirit.

Qëndrimi i Ibn Mes'udit ndaj dy sureve "Felek" dhe "Nas": Imam Ahmedi ka transmetuar prej Zer ibn Hubjshit se ka thënë: "Ubej ibn Ka'bit i thashë: -Ibn Mes'udi nuk i shkruan në mus'hafin e tij suret Felek dhe Nas?" Ai më tha: "Dëshmoj se i Dërguari i Allahut më ka lajmëruar se Xhibrili i ka thënë: *"Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit"*<sup>383</sup> dhe unë e thashë. Pastaj më tha *"Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve"*<sup>384</sup> dhe unë e thashë edhe këtë.

Ne shqiptojmë atë që e ka shqiptuar i Dërguari i Allahut."

## Shkaku i zbritjes

Komentatorët kanë thënë: "Një djalosh hebre i shërbente Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Iu afruan atij çifutët dhe e bindën të merrte flokë nga koka e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe krehrin me të

---

**"Në të vërtetë, djalli nuk ka kurrfarë pushteti mbi ata që besojnë dhe mbështeten tek Zoti i tyre".**

<sup>383</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

<sup>384</sup> Kur'an, Ihlas: 1.

cilën ai krihte flokët dhe t'ua jepte atyre. Ata pastaj i bënë magji.

Ai që e mori përsipër ishte çifuti Lebijd ibën Asam, pastaj e fshehu në pusin e fisit Zurejk, që quhej Dhervan. Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) u sëmur dhe kështu qëndroi gjashtë muaj. I dukej sikur u afrohej bashkëshortëve të tij (sikur kishte kontakte intime), si pasojë e së cilës ishte fakti se atij i dukej sikur kishte vepruar gjëra të cilat në fakt nuk i kishte bërë.

Buhariu ka transmetuar në "Sahihun" e tij prej Aishes se ka thënë: "Të Dërguarit të Allahut iu bë magji (sihër) dhe çështja arriti deri në atë masë sa që i dukej se kishte pasur kontakt intim me gratë e veta, ndërkaq në fakt nuk kishte pasur." Sufjani ka thënë: "Kur është në këtë gjendje, kjo është forma më e rëndë e magjisë." Aishja ka vazhduar: "I Dërguari i Allahut më tha: *"O Aishe, a e di se Allahu më dha zgjidhje për atë që e luta? Më erdhën dy njerëz, njëri u ul te koka, kurse tjetri te këmbët e mia. Ai që u ul te koka i tha tjetrit: -Çka ka ky njeri? I është bërë magji! I pari përsëri e pyeti: -Po kush i ka bërë magji? Tjetri ia ktheu: -Lebijd bin Asami, një person prej fisit Benij Zurejk, një hipokrit që është aleat i çifutëve. I pari pyeti: -Me çka i ka bërë? Tjetri ia ktheu: -Me krehër dhe me flokë. I pari e pyeti: -E ku janë ato? Tjetri ia ktheu: -Në pusin Dhervan, në lëvoren e një filizi mashkullor të palmës, nën një pllakë."* Aishja ka thënë:

"I Dërguari i Allahut shkoi te ky pus, i nxori gjërat që ishin në të dhe tha: *"Ky është pusi që pashë në ëndërr."* Uji i mbledhur që kishte mbetur në të ishte si këna e tretur, ndërkaq drunjtë e hurmës përreth tij ishin si kokat e djallit." Aishja ka thënë: "I thashë: Pse nuk i shpërndave? I Dërguari i Allahut tha: *"Pasha Allahun, pasi Allahu më shëroi nga kjo, nuk dua që ndonjë njeriu t'i bëjë dëm"*<sup>385</sup>."

## Kuptimi i ajeteve

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ (١)

**Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit"**<sup>386</sup>

Që ka kuptimin: Thuaj o i Dërguar i Allahut, kërkoj mbrojtje, mbështetje, strehim tek Zoti i agimit, tek Allahu i Madhërisëm, për shkak të madhërisë dhe fuqisë së Tij<sup>387</sup>. Fjala "felek" ka kuptimin ndan, çan, kris<sup>388</sup>. Zexhaxhi thotë: "Ngase çahet errësira dhe vjen mëngjesi"<sup>389</sup>. Në këtë kontekst janë fjalët e të Lartmadhërisë:

***"Me të vërtetë, Allahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë."***<sup>390</sup>

<sup>385</sup> Ibn Rexhebi, "Fer'hu-l-Bari", vëll. X, fq. 243.

<sup>386</sup> Kur'an, Felek: 1.

<sup>387</sup> Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Tefasir", vëll. V, fq. 630.

<sup>388</sup> Shih Fjalori Arabisht-Shqip Sylejman Tomçini, fq. 715.

<sup>389</sup> E-sheukaniji, "Fer'hul Kadir", vëll. V, fq. 702.

<sup>390</sup> Kur'an, En'am: 95.

Ibn bin Hatimi ka transmetuar prej Xhabirit se ka komentuar: "Fjala felek do të thotë agim<sup>391</sup>."

Kështu ka transmetuar edhe Ibn Abasi sipas transmetimit të El-A'ufij<sup>392</sup>. Koment i këtillë është transmetuar edhe prej Muxhahidit, Sei'd in Ka'ëb el-Kuredhijut, Ibn Zejdit dhe Zejd ibn Elslemit<sup>393</sup>.

El-Kuredhiu, ibn Zejdi dhe ibn Xheriri kanë thënë: "Në këtë kontekst janë edhe fjalët e të Lartmadhërishmit:

فَالِقُ الْإِصْبَاحِ

**"Ai është krijues i dritës së mëngjesit."**<sup>394</sup>

Imam Kurtubiu<sup>395</sup> sjell disa kuptime të tjera të fjalës "felek", si: "Është transmetuar nga Ibn Abasi se ka thënë: "Fjala felek është burgu në xhehenem."

Kelbiu thotë: "Është luginë në xhehenem<sup>396</sup>."

Ubej ibn Ka'bi thotë: "Është shtëpi në xhehenem dhe sa herë që hapet dera e saj, dëgjohen britmat e banorëve të xhehenemit."

Abdullah bin Omeri thotë: "Është pemë në xhehenem."

Se'id bin Xhubejri thotë: "Është pus në xhehenem."

مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ (٢)

---

<sup>391</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 700.

<sup>392</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq.701.

<sup>393</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 700-701.

<sup>394</sup> Kur'an, En'am: 96.

<sup>395</sup> "Tefsir Kurtubij", "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 474.

<sup>396</sup> Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagauj", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. II, fq. 1038.



### *që të më mbrojë nga sherri i gjithçkaje që Ai ka krijuar*<sup>397</sup>

Pra, nga të këqijat e të gjitha krijesave. Thabit el-Bunani dhe El-Hasen el-Basri kanë komentuar se në këtë ajet aludohet për mbrojtjen prej xhehenemit, Iblisit dhe trashëgimtarëve të tij. Ibn Uthejmini thotë<sup>398</sup>: “Nga e keqja e çdo krijese edhe prej së keqes së vetes tënde, ngase këtu në radhë të parë bën pjesë vetja jote, ngase nefsi shpie në të keqe dhe siç thuhet në “hutbetul haxhe”, kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej të këqijave të vetvetes dhe të veprave tona<sup>399</sup>.” Ky ajet përshin djajtë, njerëzit, xhindët, kafshët dhe krijesat e tjera<sup>400</sup>. Allahu i Madhëruar pasi na ka treguar që të kërkojmë tek Ai strehim nga të gjitha krijesat, ka veçuar tre lloje, duke na tërhequr vërejtjen për shkak të rrezikut të madh dhe dëmit që mund t’i sjellin krijesës njeri nga e keqja që përmbajnë dhe thotë:

Lloji i parë

وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ (۳)

### *3. dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri*<sup>401</sup>

<sup>397</sup> Kur'an, Felek: 2.

<sup>398</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi amme", fq. 353.

<sup>399</sup> Shënon Ahmedi në "Musned", 1/302.

<sup>400</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir xhuzi amme", fq. 353.

<sup>401</sup> Kur'an, Felek: 3.

Fjala “gasik” është komentuar si nata, dielli, hëna, yjet.

Muxhahidi ka komentuar se këtu është për qëllim terri i natës që mbulon pasi perëndon dielli. Këtë koment prej tij e ka përcjellë Imam Buhariu<sup>402</sup>.

Po ashtu, edhe Ibn Abasi, Muhamed ibn Ka'ëb El-Kuredhiu, Dahaku dhe Katade kanë komentuar se këtu aludohet për errësirën që kaplon kur vjen nata<sup>403</sup>.

Në këtë kontest është edhe ajeti:

أَقِمِ الصَّلَاةَ لِذُلُوكِ الشَّمْسِ إِلَىٰ عَسَقِ اللَّيْلِ

***"Fale namazin kur zbret (nga zeniti) dielli, e deri në errësirën e natës."***<sup>404</sup>

Nata është koha kur shtohen rreziqet e kafshëve, insekteve dhe njerëzve shpirtlig, keqbërësve e kriminelëve<sup>405</sup>.

Zuhriu ka komentuar se ky ajet aludon për diellin kur perëndon. Ndërkaq është transmetuar prej Ebu Hurejrës se në këtë ajet aludohet për yjet<sup>406</sup>.

Ibën Xheriri ka përmendur se disa kanë komentuar se këtu aludohet për hënën. Ata e kanë mbështetur këtë koment në hadithin të cilin e ka transmetuar Imam Ahmedi prej Aishes, se ka thënë: “I Dërguari i Allahut më mori për dore, ma tregoi hënën kur doli

---

<sup>402</sup> Ibn Rexhebi, "Fet'hu-l-Bari", vëll. VIII, fq. 613.

<sup>403</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XII, fq. 748-749.

<sup>404</sup> Kur'an, Isra: 78.

<sup>405</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsir-l- Munir", vëll. XV, fq. 876.

<sup>406</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XII, fq. 149.

dhe më tha: *"dhe nga sherri i natës, kur kaplon terri"*<sup>407</sup>.<sup>408</sup> Këtë hadith e kanë transmetuar edhe Termidhiu dhe Nesaiu<sup>409</sup>.

Por kuptimi i vërtetë është më gjithëpërfshirëse sesa njëra prej këtyre krijesave, pra ka për qëllim natën e errët.

Lloji i dytë

وَمِنْ شَرِّ النَّفَّاثَاتِ فِي الْعُقَدِ (٤)

*4. dhe nga sherri i falltarëve, që fryjnë në nyje (duke bërë magji)*<sup>410</sup>.

Ikrime, El-Hasen, Katade dhe Dahaku kanë komentuar se këtu janë për qëllim magjistarët<sup>411</sup>. Muxhahidi ka komentuar: "Bëjnë magji duke fryrë në nyja." Këto janë gratë magjistare, që fryjnë në nyja apo diçka tjetër për të bërë magji. Fryjnë duke lexuar dhe përmendur emra të djajve në çdo nyjë që lidhin dhe këtë e përsëritin disa herë. Ato kanë shpirt të ligë, synojnë ndonjë person të caktuar dhe kjo magji ndikon tek ai për shkakun që është bërë. Allahu këtu ka përmendur gratë e jo burrat ngase zakonisht këtë lloj magjie e bëjnë gratë<sup>412</sup>.

<sup>407</sup> Kur'an, Felek: 3.

<sup>408</sup> Ahmedi, vëll. VI, fq. 61.

<sup>409</sup> Termidhiu, nr. 3366.

<sup>410</sup> Kur'an, Felek: 4.

<sup>411</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XII, fq. 750-751.

<sup>412</sup> Ibn Uttejmini, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 353.

Ebu Ubejde thotë: "Ajeti aludon për bijat e Lebijd bin es-Samit, të cilat i kanë bërë magji Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)<sup>413</sup>."

Fryrja këtu është pa pështymë, siç veprohet nëse i bëhet dikujt rukje<sup>414</sup>. Për atë disa dijetarë kanë ndaluar edhe gjatë rukjes të fryhet. Ikrime thotë: "Gjatë rukjes nuk duhet të fryhet". Por Tradita Profetike tregon të kundërtën, se Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) e vepronte një gjë të tillë, siç kumtohet nga nëna e besimtarëve, Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të<sup>415</sup>.

Në një hadith theksohet se Xhibrili erdhi tek Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) dhe i ka thënë: "O Muhamed, diçka të mundon?" I Dërguari i Allahut i ka thënë: "Po." Xhibrili i ka thënë: "Me emrin e Allahut të shëroj nga çdo sëmundje që të mundon. Allahu të shëron nga sherri i çdo ziliqari dhe nga syri i keq<sup>416</sup>."

Lloji i tretë

وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ (٥)

**5. dhe nga sherri i smirëziut, kur vepron me smirë<sup>417</sup>**

---

<sup>413</sup> Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagauj", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. II, fq. 1039.

<sup>414</sup> Rukje sherije është leximi i ajeteve kur'anore apo lutjeve profetike që lexohen për vete apo dikujt në rast se njeriu është i sëmurë apo ankohet prej mësyshit apo magjisë.

<sup>415</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 477.

<sup>416</sup> Muslimi, nr. 2186.

<sup>417</sup> Kur'an, Felek: 5.

Ziliqar është ai që e urren begatinë që Allahu i ka dhuruar dikujt dhe vuan nëse dikush ka pasuri, post, fëmijë, dituri apo diçka tjetër.

Ziliqari është dy llojesh.

E para, kur dikush ka zili, por atë urrejtje për tjetrin e mban në zemrën e tij, nuk i bën dëm tjetrit sepse nuk vepron me zilinë që ka. Ndërsa e keqja dhe belaja është e llojit të dytë, ai që vepron sipas smirës së vet. Për të ka ardhur urdhri që të kërkojmë strehim tek Allahu nga sherri i smirëziut kur vepron me smirën e tij, e cila është mësyshi.

Kur ziliqari arrin në gjendje që ta urrejë tjetrin pse Allahu e ka begatuar nga të mirat e Tij apo pse ai nuk e ka një gjë të tillë, aktivizohet shpirti i tij i ligë, që e godet njeriun dhe që quhet goditje nga syri apo mësyshi, të cilën ne nuk dimë ta përshkruajmë sepse është diçka e fshehtë, por realiteti dhe dëmi i mësyshit është prezent dhe efektiv në kuptimin negativ sepse personi që ka mësysh mund të sëmuret dhe të vdesë prej saj, madje mësyshi ndikon edhe në objekte të ngurta. Mësysh është diçka që nuk e shohim, madje mund të vijë nga njerëzit më të dashur që ke<sup>418</sup>.

---

<sup>418</sup> Ibn Utthejmini, "Tefsir xhuzi Amme", fq. 353-354.

Imam Bagaviu thotë se këtu aludohet për çifutët sepse ata e kishin zili Pejgamberin (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të)<sup>419</sup>.

Allahu i Madhëruar ka përmendur dhe ka kërkuar nga ne që të kërkojmë strehim tek Ai nga këto lloje sepse belaja, e keqja dhe rreziqet vijnë nga këto lloje që janë të fshehta për ne.

Mësim<sup>420</sup>

- Vlera e dy sureve "Felek" dhe "Nas":

1. Imam Muslimi ka transmetuar në "Sahihun" e tij prej Ukbe ibn Amrit se ka thënë: "I Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi

---

<sup>419</sup> Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. II, fq. 1039.

<sup>420</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi, "Kur'ani i madhërishtëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanijji, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Utnejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Alij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-l Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkij, "Sherh Akide Et-Tahauije"; Shejh Islam ibn Tejmije, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Zadul Mead"; Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Feuaid"; Emin Bahrami, "Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase".

- të) ka thënë: *"A nuk sheh se sonte janë shpallur ajete si të cilat kurrë nuk janë parë: "Felek", "Nas".<sup>421</sup>"*
2. Nesaiu ka transmetuar prej Ukbe ibn Amirit se i Dërguari i Allahut (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "Njerëzit nuk kanë mundur të kërkojnë mbrojtje me diçka tjetër sikurse me këto dy sure, "Felek" dhe "Nas"<sup>422</sup>.
  3. Nesaiu ka transmetuar prej Ibn Abas el-Xhuhenijut se i Dërguari i Allahut i ka thënë: *"O i biri i Abasit, a të tregoj se cila është mënyra më e mirë për njerëzit që të kërkojnë mbrojtje?"* Ai ka thënë: "Gjithsesi o i Dërguari i Allahut." I Dërguari i Allahut ka thënë: *"Të lexojnë suret "Felek"."* Dhe unë e thashë. Pastaj më tha: *"Nas"*<sup>423</sup>.
  4. Imam Maliku ka transmetuar prej Aishes se i Dërguari kur ankohej nga ndonjë sëmundje, lexonte suret "Felk" dhe "Nas" dhe e frynte veten, mirëpo kur iu përkeqësua sëmundja, unë ia lexoja lutjet me të cilat kërkonte mbrojtje dhe me dorë e prekja trupin e tij duke shpresuar në bekimin e lutjeve"<sup>424</sup>.
  5. Është transmetuar prej Ebu Sei'dit se i Dërguari i Allahut ka kërkuar mbrojtje me lutje prej dy syve,

---

<sup>421</sup> Muslimi, vëll. I, fq. 558.

<sup>422</sup> Ed-Dulabi, "El-Kuna", vëll. I, fq. 106.

<sup>423</sup> Nesaiu, vëll. VIII, fq. 251.

<sup>424</sup> Imam Maliku, "El'Muveta", vëll. II, fq. 942. Shënon Buhariu në "Fet'hul-Bari", vëll. VIII, fq. 679; Ebu Davudi, vëll. IV, fq. 220; Nesaiu në "Kubra", vëll. IV, fq. 867 dhe Ibn Maxhe, vëll. II, fq. 1166.

të xhindëve dhe njerëzve. Mirëpo kur janë shpallur këto dy sure, ai kërkonte mbrojtje me këto dhe i la lutjet e tjera<sup>425</sup>.”

- Kjo kaptinë fisnike është mësonjëtorja se si duhet të kërkohen strehim njerëzit nga çdo e keqe në dynja dhe ahiret, nga e keqja e njerëzve, xhindëve, shejtanëve, kafshëve, egërsirave, mikrobeve, baktereve, insekteve, zjarrit, mëkateve, pasioneve, nga e keqja e veprave dhe nga çdo gjë e krijuar që mund të na dëmtojë, ngase jeta e kësaj bote ndonjëherë është plot të këqija.
- Kaptina na obligon për kërkim strehimi nga Allahu çdo herë dhe kërkim strehimi që të na largojë nga çdo rrezik që njeriu nuk mund ta dijë (është i panjohur për të), apo nuk ka mundësi të mbrojë veten.
- Allahu i Madhërisëm e di dobësinë tonë, pamundësinë tonë për rreziqet që na rrethojnë, qofshin të fshehta apo të qarta, dhe për këtë i drejtohet Pejgamberit të Tij e më pas edhe besimtarëve duke i thirrur tek strehimorja e Tij, e cila na mbron nga çdo e keqe dhe nga armiqtë tanë. Këtu është pra siguria, qetësia dhe paqja.

---

<sup>425</sup> Termidhiu, "Tuhfetu-l-hvedhij", vëll. fq. 218; Nesaiu, vëll. VIII, fq. 271 dhe Ibn Maxhe, vëll. II, fq. 1161.



- Pse jemi të urdhëruar në ketë sure që të kërkojmë mbrojtje nga këto tri gjëra? Sepse të gjitha të këqijat e kanë burimin nga këto.
  1. Nata kur bie errësira: Ashtu si ka përmendur Imam E-Razij, natën dalin egërsirat dhe insektet nga vendet e tyre. Është e qartë se nata dhe errësira janë një skenë e vjedhësve, kriminelëve dhe të ligjve që cenojnë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.
  2. Magjistarët që fryjnë në nyja (bërja magji): Magjia është kufër (mosbesim) dhe njeriu i cili bën magji ndëshkohet me vdekje në Islam. Dijetari i shquar Ibn Hazmi (shkolla juridike dhahirije) është i mendimit se “sihri” është çështje jo e vërtetë, por mashtrim dhe vegim. Sipas kësaj shkolle, masa e gjerë e popullit ka paragjykitime të shuma nga të cilat duhet pasur kujdes i madh.
  3. Njeriu duhet të kërkojë mbrojtje tek Allahu edhe nga smira (hasedi). Hasedi është një e ligë e cila reflekton dëshirën e madhe për t'i parë njerëzit të varfër dhe pa të mirat e kësaj bote. Njerëzit që vuajnë nga kjo e keqe thurin lloj-lloj intrigash dhe kurthesh. Hasedi është ndër krimet (apo sëmundjet) më të përhapura në mesin e njerëzve. Hasedi reflektohet edhe përmes syrit. Është një shikim i keq i së mirës. Njerëzit thurin lloj-lloj të pavërtetash rreth saj. Mbështetja tek Allahu në çdo moment dhe në çdo kohë e mbron besimtarin e

vërtetë nga dëmet dhe të këqijat e të tjerëve, nga dëmet që ndodhin dhe që priten të ndodhin. Është një sëmundje që e shtyu të birin e Ademit për ta vrarë vëllanë e tij, kurse vëllezërit e Jusufit që t'i bëjnë kurth atij. Është mëkati i parë në qiell që bëri Iblisi ndaj Allahut, që nuk iu përul urdhrit të Tij dhe Kabili ndaj vëllait të tij, Habilit.

- Cila është rruga për t'u mbrojtur nga këto tri gjëra?
  1. Lidhja e zemrës së besimtarit me Allahun xhele xhelahu.
  2. Mbështetja tek Allahu.
  3. Leximi i surve kur'anore dhe lutjeve gjatë ditës.
  
- Shumica e dijetarëve e lejojnë mjekimin me anë të rukjes<sup>426</sup>, ngase Pejgamberi sal-lAllahu alejhi sel-lem është ankuar dhe i shkoi Xhibrili alejhi selam dhe i bëri rukje dhe tha: "Në emër të Allahut, po të lexoj nga çdo gjë që të dëmton. Allahu të shëroftë!"
  
- Magjia që i është bërë të Dërguarit të Allahut nuk bie në kundërshtim me shpalljen hyjnore, ngase Allahu i Madhëruar thotë: "***Allahu të garanton mbrojtjen prej njerëzve (prej armiqve).***"<sup>427</sup> Magjia ishte një sprovë që goditi të Dërguarin e Allahut. Nëse dikush pyet pse?, përgjigjja do të ishte se nuk ka sprovë të

---

<sup>426</sup> Rukje sheriye është leximi i ajeteve kur'anore apo lutjeve profetike që lexohen për vete apo dikujt në rast se njeriu është i sëmurë apo ankohet prej mësyshit ose magjisë.

<sup>427</sup> Kur'an, Maide: 67.

kësaj bote që nuk e ka prekur të Dërguarin e Allahut sepse ai është shembëlltyra dhe modeli më i mirë për njerëzimin.

- Çfarë ndodhi me magjistarin Lebid bin Asam?  
Nuk dihet nëse ndaj tij u morën masa. Dijetarët komentojnë se një gjë e tillë u bë për shkaqet në vijim:
  - a) Lebid bin Asami hiqej si musliman e në fakt ishte hipokrit dhe kjo e ndalte Pejgamberin e Allahut ta vriste sepse njerëzit përreth Medinës mund të thoshin: "Muhamedi po vret shokët e tij". Kësaj propagande Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) i ruhej.
  - b) Pejgamberi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ishte shëruar nga ndikimi i magjisë dhe zakonisht nuk hakmerrej për veten e tij, siç dihet. I tillë ishte rasti i beduinit që iu vërsul me shpatë apo edhe gruas çifute e cila kishte helmuar ushqimin e tij.

O Mëshirues, tek T'i kërkojmë çdo herë strehim nga të këqijat që i dimë dhe nuk i dimë!

## SURJA EN-NAS<sup>428</sup> (NJERËZIT)

Lloji: Mekase, nr. 114, ajete 6

Përmbajtja: Kërkimi i mbrojtjes nga Allahu prej djajve, xhindëve dhe njerëzve.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (١) مَلِكِ النَّاسِ (٢) إِلَهِ النَّاسِ (٣) مِنْ شَرِّ  
الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ (٤) الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (٥) مِنَ  
الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ (٦)

*Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit,  
Mëshirëplotit!*

- 1. Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve,*
- 2. Sundimtari i njerëzve,*
- 3. i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve,*
- 4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)*
- 5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve,*

---

<sup>428</sup> Sipas disa transmetimeve nga Ibn Abasi dhe Aishja, një magjistar hebre me emrin Lebijd, që jetonte në Medinë, ishte ngarkuar t'i bënte Profetit Muhamed (a.s.) një magji vdekjeprurëse. Magjistari arriti të siguronte disa fije nga flokët e Profetit (a.s.) dhe me to bëri njëmbëdhjetë nyje. Bijat e tij frynin në secilën prej këtyre nyjave, duke thënë mallkime të frikshme. Pastaj, magjinë e mbështollën duke i shtuar një filiz palme hurmash dhe e hodhën në një pus. Profeti (a.s.) filloi të ndiente shqetësime të çuditshme, si: humbje të kujtesës, dobësi, humbje të oreksit etj. dhe gjendja e tij po përkeqësohej, derisa Allahu i Madhëruar ia zbuloi në ëndërr shkakun e shqetësimeve të tij dhe vendin ku ishte fshehur magjia. Kur Profeti (a.s.) u zgjua, atij i erdhi Xhebraili (a.s.) dhe i dha dy sure, njëra me pesë vargje dhe tjetra me gjashtë. Profeti (a.s.) dërgoi Aliun te pusi me detyrën për të lexuar këto dy sure. Ndërsa ai lexonte suret, nyjat zgjidheshin njëra pas tjetrës dhe Muhamedi (a.s.) rifitonte forcat dhe kthjelltësinë e humbur. Dy suret në fjalë janë ato me të cilat mbyllet Kur'ani i Madhërishëm. Këto sure kanë një rëndësi të madhe rituale dhe muslimanët i recitojnë ato shpesh për t'u ruajtur nga çdo e keqe, fizike apo shpirtërore qoftë.

## 6. (qoftë ai djall) prej xhindëve apo njerëzve!”

### Emërtimi

Quhet surja “En-Nas-Njerëzit” ngase dhe fillon me këtë fjalë. **“Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve”<sup>429</sup>**. Fjala “en-nas” është përsëritur pesë herë. Ka zbritur së bashku me suren paraprake, “El-Felek”.

### Shkaku i zbritjes

Shkaku i zbritjes së sures “En-Nas” është i njëjtë me atë të zbritjes së sures “El-Felek”, ngase këto dy sure zbritën njëkohësisht.

### Kuptimi i ajeteve

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ (١)

**Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve”<sup>430</sup>**

Thuaj o i Dërguari i Allahut, kërkoj mbështetje dhe strehim tek Zoti i njerëzve me kujdesin dhe mbikëqyrjen e Tij.

Ai është Allahu i Madhërishëm, Zoti i njerëzve, i engjëjve dhe xhindëve. Zoti i qiejve, tokës, diellit,

---

<sup>429</sup> Kur'an, Nas: 1.

<sup>430</sup> Kur'an, Nas: 1.

hënës. Zoti i çdo gjëje, por këtu ka veçuar Zoti i njerëzve<sup>431</sup>.

Fjala nas-njerëzit është përsëritur për sqarim dhe dukje. Allahu ka thënë: **“Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve”<sup>432</sup>**, edhe pse është Zot i njerëzve dhe i të gjitha krijesave të tjera, por është veçuar emri “njerëzve” për shkak të nderimit ngase kërkimi i mbrojtjes është për njerëzit<sup>433</sup>.

Përmendja e nocionit “njerëz” këtu bën që ata të ndihen në afërsi të pozicionit të mbrojtjes dhe strehimit<sup>434</sup>.

مَلِكِ النَّاسِ (٢)

### ***Sundimtari i njerëzve*<sup>435</sup>**

Ai është Allahu, që është sundimtar i gjithëfuqishëm mbi çdo gjë, sundimtar që ka sundim të lartë dhe veprim mbi njerëzit<sup>436</sup>.

إِلَهِ النَّاسِ (٣)

### ***i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve***

Ai është Allahu, i Adhuruari që adhurojnë njerëzit. Emri Zot është i veçantë për Allahun, nuk bën pjesë askush në të, ndërsa sundimtari mund të jetë Zoti apo dikush tjetër<sup>437</sup>. I Adhuruari është Ai, i Vërteti,

---

<sup>431</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 355.

<sup>432</sup> Kur'an, Nas: 1.

<sup>433</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsir Munir", vëll. XV, fq. 885.

<sup>434</sup> Seid Kutb "Fi Dhilalil Kur'an", tefsir i sures Nas, fq. 2.

<sup>435</sup> Kur'an, Nas: 3.

<sup>436</sup> Ibn Uthejmini, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 355.

<sup>437</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsiru Munir", vëll. XV, fq. 885.

nga i Cili anojnë zemrat, e duan dhe e madhërojnë, Ai është Allahu<sup>438</sup>. Në këto dy ajete Allahu u kujton njerëzve që në këtë botë janë sundimtarë se Allahu është sundimtari i njerëzve dhe i atyre që adhurojnë dikë pos Allahut, se i Adhuroar i vetëm është vetëm Allahu. Për këtë tek Ai duhet të ktheheni dhe nga Ai, xhele xhelalehu, duhet të kërkon mbrojtje e jo nga sundimtarët dhe njerëzit me pozitë në këtë botë dhe vetëm Atë duhet ta adhuroni<sup>439</sup>. Këtu përmenden tri cilësi të Zotit të Madhërishëm: "Er-Rububije", të qenët e Allahut Zot dhe krijues i çdo sendi; "El-Mulk", të qenët e Allahut sundues absolut; "El-Uluhiye", të qenët e Allahut i vetmi i denjë për adhurim. Pra, Allahu i Madhërishëm është Krijues, Sundues dhe Zot i çdo sendi. Të gjitha gjërat i ka krijuar Ai dhe janë pronë e robër të Tij. Allahu i Madhërishëm i urdhëron njerëzit që të kërkojnë mbrojtje nga Ai që i posedon këto cilësi, që t'i mbrojnë prej sherrit të cytësit që fshihet, i cili është shejtani që e përcjell njeriun. Çdo njeri ka shoqëruesin e vet nga djajtë, që ia zbukuron gjërat e neveritshme dhe me çdo kusht mundohet ta shpjerë në mëkate. I mbrojtur është ai që e ka mbrojtur Allahu<sup>440</sup>.

مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ (٤)

---

<sup>438</sup> Ibn Utthejmin, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 355.

<sup>439</sup> Kurtubiu, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an", vëll. X, fq. 410.

<sup>440</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim" vëll. VII, fq. 527.

#### ***4. nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)<sup>441</sup>***

Sei'd ibn Xhubejri ka transmetuar se Ibn Abasi përkitazi me fjalët e të Lartmadhërishmit: “...nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)<sup>442</sup>”, ka komentuar: “Shejtani gjuan dhe i vardiset zemrës së njeriut. Nëse njeriu harron dhe bëhet mospërfillës, shejtani i hedh mendime të këqija, e nëse e përmend Allahun, ai fshihet<sup>443</sup>.” Kështu e kanë komentuar edhe Muxhahidi edhe Katade<sup>444</sup>.

El'Mutemir ibn Sulejmani ka transmetuar prej babait të vet se ka thënë: “Më është përmendur se shejtani cytës hedh mendime të këqija në zemrën e njeriut, kur njeriu është i brengosur dhe kur është i gëzuar. Nëse e përmend Allahun, shejtani zbrapset dhe fshihet<sup>445</sup>.”

El-Aufiju ka transmetuar prej Ibn Abasit se ka thënë: “El vesvas” (cytës) është shejtani kur urdhëron, e nëse i dëgjohen urdhrat, fshihet<sup>446</sup>.”

“El-hanas” ai që fshihet me qëllim që të bëjë dëm dhe të sjellë të keqen, ai që e shfrytëzon rastin për të sulmuar dhe për të vepruar fshehurazi në cytje.

---

<sup>441</sup> Kur'an, Nas: 4.

<sup>442</sup> Kur'an, Nas: 4.

<sup>443</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 709.

<sup>444</sup> Taberiu, “Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”, vëll. XXIV, fq. 710.

<sup>445</sup> Po aty.

<sup>446</sup> Po aty.



Cytësi është i lig, i fëlliqur, ndaj edhe duhet pasur kujdes nga ai<sup>447</sup>.

Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin Famëlartë:

وَكَذَلِكَ جَعَلْنَا لِكُلِّ نَبِيٍّ عَدُوًّا شَيَاطِينَ الْإِنْسِ وَالْجِنِّ يُوحِي بَعْضُهُمْ إِلَىٰ بَعْضٍ زُخْرُفَ الْقَوْلِ غُرُورًا ۗ وَلَوْ شَاءَ رَبُّكَ مَا فَعَلُوهُ ۗ فَذَرْهُمْ وَمَا يَفْتَرُونَ

*“Kështu, çdo Profeti Ne i kemi caktuar armiq djajtë e njerëzve dhe të xhindëve, të cilët e frymëzojnë njëri-tjetrin me fjalë boshe të zbukuruara për mashtrim. Por, sikur të donte Zoti yt, ata nuk do të bënin kështu, prandaj lëri ata dhe trillimet e tyre<sup>448</sup>.”*

Ibn Uttejmini thotë: “El vesvese” (cytje) është ajo që e godet zemrën nga mendimet, fantazitë, imagjinatë, iluzionet që nuk kanë të bëjnë me realitetin”. Ndërsa “el-hanas” është djalli, i cili fshihet, humbësi, që ikën kur përmendet Allahu<sup>449</sup>.”

Djalli është “vesvas” kur njeriu është i pakujdesshëm ndaj përmendjes së Allahut dhe është “hanas” kur robi e përmend Allahun<sup>450</sup>.

الَّذِي يُوسُّوسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ (٥)

*5. e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve<sup>451</sup>*

<sup>447</sup> El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë", fq. 709.

<sup>448</sup> Kur'an, En'Amë: 112.

<sup>449</sup> Ibn Uttejmini, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 355.

<sup>450</sup> Shinkiti, "Edvau-l Bejan", vëll. VI, fq. 387.

<sup>451</sup> Kur'an, Nas: 5.

Për pyetjen nëse ky ajet përfshin vetëm njerëzit apo përfshin edhe njerëzit edhe xhindët janë dhënë dy mendime.

Sipas mendimit të parë, me nocionin en-nas-njerëz nënkuptohen vetëm njerëzit, ngase ky është kuptimi i qartë i kësaj fjale.

Sipas mendimit të dytë, me këtë nocion nënkuptohen dhe njerëzit edhe xhindët. Ibn Xheriri ka thënë: "Për xhindët është përdorur shprehja "njerëz nga xhindët", për atë nuk është aspak habi që termi "njerëz" të përdoret edhe për xhindët<sup>452</sup>."

Disa kanë komentuar se këtë ajet "*e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve*"<sup>453</sup> e ka sqaruar me ajetin vijues: "*(qoftë ai djall) prej xhindëve apo njerëzve*"<sup>454</sup>!"

Ky shpjegim përforcon mendimin se nocioni "njerëz" përfshin njerëzit dhe xhindët<sup>455</sup>. Imam Bagaviu thotë: "Me fjalë të fshehta, që janë të kuptueshme për zemrat, pa qenë nevoja për t'i dëgjuar<sup>456</sup>". Djalli shpërndan dyshime dhe sherr në gjokset e njerëzve, mbjell fëlliqësira, gjëra irrituese dhe lajthitje<sup>457</sup>.

Ai është djalli që hedh mendime të këqija dhe sherr në zemra. Përdor gjokset ngase përmbajnë zemrat

---

<sup>452</sup> Taberiu, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an", vëll. XXIV, fq. 711.

<sup>453</sup> Kur'an, Nas: 5.

<sup>454</sup> Kur'an, Nas: 6.

<sup>455</sup> Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim", vëll. VII, fq. 529.

<sup>456</sup> Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagavi", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", vëll. II, fq. 1039.

<sup>457</sup> Ebij Bekër El-Xhezairij, "Tefsir-l Mujeser", fq. 923.

dhe se vendi i mendimeve është zemra siç, është e njohur në gjuhën arabe<sup>458</sup>.

Djalli është esenca e çdo të keqeje, ngase edhe brumi i së keqes është si pasojë e joshjeve dhe së keqes që vjen nga ai. Ai bën cytje në gjokset e njerëzve, ua hijeshon të keqen duke ua paraqitur atyre me një pamje të mirë dhe aktivizon vullnetin e tyre për të vepruar.

I pengon nga të vepruarit e veprave të mira duke ua paraqitur jo në pamjen reale.

Ai çdo herë është në këtë gjendje dhe fshihet<sup>459</sup>.

Buhariu dhe Muslimi kanë transmetuar prej Enesit se i Dërguari i Allahut derisa kishte qenë në xhami duke qëndruar në itikaf, kishte shkuar ta vizitonte gruaja e tij, Safija. Më pas ai kishte dalë natën që ta çonte në shtëpi. Në rrugë e sipër, atë e kishin takuar dy burra medinas (ensarë), të cilët posa e kishin parë të Dërguarin e Allahut kishin filluar të nxitonin. I Dërguari i Allahut u kishte thënë: *"Më ngadalë, kjo është Safija, bija e Hujejit."* Ata të dy thanë: *"Qoftë i lartësuar Allahu, si mund të dyshojmë te ti o i Dërguar i Allahut?!"* I Dërguari i Allahut u ka thënë: *"Djalli qarkullon nëpër trupin e njeriut si gjaku, e unë pata frikë se mos djalli hedh në zemrat tuaja ndonjë dyshim."* Apo tha: *"ndonjë sherr"*<sup>460</sup>.

---

<sup>458</sup> Uehbe Ezuhejli, "Tefsir-l Munir", vëll. XV, fq. 886.

<sup>459</sup> Nasir Es-Sadijj, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan", fq. 867.

<sup>460</sup> Buhariu, "Feth-l Bari", vëll. IV, fq. 2167.

Pastaj Allahu i Madhëruar ka sqaruar se ai që hedh këto dyshime mund të jetë nga njerëzit apo xhindët.

مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ (٦)

**6. (qoftë ai djall) prej xhindëve apo njerëzve!**<sup>461</sup>

Kelbiu thotë: "Allahu në ajetin paraprak **"e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve"**<sup>462</sup> sqaron se nocioni en-nas-njerëzve përfshin njerëzit dhe xhindët.

Xhindët janë quajtur njerëz, ashtu siç janë quajtur burra në suren xhin<sup>463</sup>."

وَأَنَّهُ كَانَ رِجَالٌ مِّنَ الْإِنسِ يَعُوذُونَ بِرِجَالٍ مِّنَ الْجِنِّ فَزَادُوهُمْ رَهَقًا  
**"Dhe se ka pasur burra prej njerëzve që kërkonin ndihmë prej burrave nga xhindët dhe ashtu ua shtonin atyre edhe më shumë arrogancën"**<sup>464</sup>."

Siç duket, djajtë që janë nga mesi i njerëzve nxisin kënaqësinë e veprimeve, kurse djajtë që janë nga mesi i xhindëve e pëlqejnë (dhe nxisin) konfuzionin e njerëzve dhe i lënë në rrugë të gabuar, ashtu siç vepron edhe Iblisi. Kështu Allahu bën që ata ta kompletojnë njëri-tjetrin. Siç është e ditur, djajtë janë për të mënjanuar, hutuar dhe krijuar konfuzion. Ai që u

---

<sup>461</sup> Kur'an, Nas: 6.

<sup>462</sup> Kur'an, Nas: 5.

<sup>463</sup> Bagaviu, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", fq. 1039.

<sup>464</sup> Kur'an, Xhin: 6.

përgjigjet këtyre cytjeve nuk mund të arsyetohet, sidomos pasi të paralajmërohet<sup>465</sup>.

Ata që hedhin dyshime tek njerëzit janë nga xhindët dhe vetë njerëzit. Nga xhindët dyshimet janë të dukshme sepse ai kalon përmes gjakut të birit të Ademit. Ndërsa sa u përket dyshimeve që vijnë nga njerëzit janë aq të shumta, madje edhe me petkun e këshilltarit, i cili nuk mbjell tek ti pos dyshime dhe sherr duke i zbukuruar këto derisa e merr duke menduar se është këshillë, por kjo nuk do të sjellë gjë tjetër vetëm se sherr<sup>466</sup>. Në këto tre ajetet e fundit së pari përmendet atributi i tyre, pastaj veprimi e pastaj lloji.

Mësimë<sup>467</sup>

---

<sup>465</sup> El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit famëlartë", fq. 709.

<sup>466</sup> Ibn Utthejmini, "Tefsir Xhuzi Amme", fq. 356.

<sup>467</sup> Sherif ef Ahmeti, "Kur'ani - Përkthim me komentim në gjuhën shqipe"; Prof. Hasan I. Nahi "Kur'ani i madhërishtëm", (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam); Ibn Kethiri, "Tefsir El-Kur'an El-adhim"; El-Kurtubi, "El-Xhami Liahkam El-Kur'an"; Taberij, "Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an"; Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, "Tefsiru El-Xhelalejn"; Imam El-Bagauij, "Muhtesar Tefsir El-Bagauij", ose siç njihet "Mealim Et-Nzil", Imam El-Bagauij; Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukanijji, "Fethu El-Kadir"; Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, "Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an"; Nasir Es-Sadij, "Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan"; Salih El-Utthejmin, "Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme"; Muhamed Sulejman El-Eshkar, "El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir"; Ebij Bekër El-Xhezairij, "Ejser Et-Tefasir Likelam el-Allij El-Kebir"; Uehbe Ezuhejli, "Et-Tefsir El-Munir"; Dr. Aid El-Karni, "Et-Tefsir El-Mujeser"; El Vahidij, "Esbabul En-Nuzul"; Muhamed El-Gazali, "Komenti tematik i Kur'anit Famëlartë"; Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, "Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim"; Seid Kutb, "Fi Dhilali-l Kur'an"; Ebij El-Izi Eddimeshkijj, "Sherh Akide Et-Tahauije"; Shejh Islam ibn Tejmije, "Ubudije"; Ibn Kajim El-Xhevzjeh, "Zadul Mead"; Ibn

- Kjo sure rekomandon kërkimin e mbrojtjes së Allahut nga djajtë që bëjnë pjesë në mesin e njerëzve dhe xhindëve si dhe prej së keqes për të cilën ia mbushin mendjen njeriut.
- Kjo sure flet për rrezikun e influencave (ideve dhe paragjykimeve) shpirtërore dhe influencave psikike dhe domosdoshmërinë dhe nevojën e shpëtimit prej tyre.
- Obligueshmëria e kërkimit të strehimit tek Allahu për mbrojtje nga shejtanët njerëz dhe xhindë. Konfirmimi i akides rububije dhe uluhije.
- Sqarimi i fjalës “Eudhubilahi” ashtu siç është përmendur në hadithet e Pejgamberit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). “Eudhu bilahi mine shejtani raxhim - Kërkoj mbrojtje tek Allahu nga djalli i mallkuar”.
- Të përsëriturit etributeve të Allahut në këtë sure ka për qëllim shprehjen e nevojës që kemi për Të, pranimin se vërtet jemi të vobektë, se duhet të mbështetemi vetëm tek Allahu i Plotfuqishëm.
- Në këto tre ajetet e fundit së pari është përmendur atributi i tyre: **“nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt)”**<sup>468</sup> pastaj veprimi: **“e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve”**<sup>469</sup>, pastaj lloji: **“(qoftë ai djall)”**

---

Kajim El-Xhevziqeh, “Feuaid”; Emin Bahrami, “Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul-Fatihase”.

<sup>468</sup> Kur’an, Nas: 4.

<sup>469</sup> Kur’an, Nas: 5.

*prej xhindëve apo njerëzve*”<sup>470</sup>. Kjo radhitje bën që të ndiejmë një zgjuarsi dhe tërheqje të vëmendjes që sqaron realitetin e djallit, cytjet dhe atributet e tij, të kuptojmë metodologjinë përmes së cilës realizohet e keqja e tij dhe të përgatitemi për mbrojtje.

- Vesveset nga njerëzit janë të shumta dhe shpeshherë janë më të rrezikshme se vesveset e djallit.

a) Shoku i keq mbjell në zemrën tënde të keqen dhe ti nuk e kupton sepse e konsideron shok dhe mendon se je i sigurt prej tij.

b) Këshilltarët e këqij të cilët bëjnë intriga për çdo njeri që ka post dhe pozitë duke e lënë të jetojë si mizor e shkatërrimtar duke shkatërruar çdo gjë mbi sipërfaqen e tokës.

c) Nemam është ai që bart fjalë duke i hijeshuar, derisa të duket para të tjerëve se është i sinqertë.

Por ka edhe shumë lloje të tjerë, të cilët mundohen të bëjnë vesvese tek njerëzit për të realizuar qëllimet e tyre të këqija. Allahu e udhëzon njeriun dhe në të njëjtën kohë i tregon mënyrën e mbrojtjes nga diçka që natyrshmëria e njeriut nuk mund ta kuptojë pa shpalljen hyjnore.

- Vërehet se në suren “Felek” ai tek i cili duhet të strehohemi e të kërkojmë mbrojtje (Allahu) është përmendur me një atribut “Rabu-lfelek”, kurse ajo nga e cila kërkohet mbrojtje është tre llojesh: gasik, nefathat, hasid. Në suren “Nas” Allahu i Madhëruar

---

<sup>470</sup> Kur’an, Nas: 6.

është përmendur me tre attribute: Rab, Melik dhe Ilah, ndërsa ajo nga e cila kërkohet mbrojtje është një lloj dhe është vesvesi. Shkaku i kësaj ndarje është se në suren Felek kërkohet siguria për vetveten dhe trupin, ndërsa në suren Nas siguria e fesë. Dëmi në fe, edhe nëse është i paktë, është më i rrezikshëm se dëmi që mund të pësojmë në dynja, edhe kur është i madh<sup>471</sup>.

- A ka çdo njeri djall? Në një hadith autentik theksohet se Muhamedi (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të) ka thënë: "*Çdonjëri nga ju e ka shoqëruetin e tij (nga shejtanët)*". Disa e pyetën: "Edhe ti o i Dërguari i Allahut?" Tha: "*Po, edhe unë e kam, por Allahu më ndihmoi ta mund dhe kaloi në Islam. Ai më urdhëron vetëm për mirë*"<sup>472</sup>.

- Për metodologjinë e shejtanit Ibn Kajimi ka përmendur gjashtë shkallë, të cilat shejtani i përdor për devijimin e njerëzve.

*Shkalla e parë:* Mundohet ta fusë njeriun në kufër apo shirk. Nëse ky njeri është besimtar, kalon tek shkalla tjetër.

*Shkalla e dytë:* Shkalla e bidatit, duke u munduar ta fusë njeriun në bidate, që t'i praktikojë ato. E, nëse ky njeri është nga pasuesit e Sunetit, kalon në shkallën e tretë.

---

<sup>471</sup> "Tefsir Err'Razij", 32/199.

<sup>472</sup> Muslimi, vëll. IV, fq. 2167.



*Shkalla e tretë:* Shkalla e mëkateve të mëdha. Kjo është shkalla ku mundohet ta fundosë njeriun në mëkatet e mëdha. E, nëse ky person është nga njerëzit që Allahu e ka mbrojtur nga këto mëkate, shejtani nuk dëshpërohet.

*Shkalla e katërt:* Shkalla e mëkateve të vogla. Nëse edhe prej tyre është i mbrojtur, fillon ta preokupojë me metoda të tjera djallëzore.

*Shkalla e pestë:* E preokupon njeriun me gjërat e lejuara në esencë, që njeriu ta kalojë kohën e tij në këto gjëra e të mos preokupohet me gjëra serioze, me të cilat jemi të obliguar.

*Shkalla e gjashtë:* Kjo është shkalla ku e preokupon njeriun me gjëra të dobishme, duke e larguar nga ato që janë edhe më të dobishme. E preokupon me gjëra të mira duke e larguar nga ato që janë edhe më të mira dhe më të bukura.

E nëse dështojnë këta hapa, djalli do të mundohet ta preokupojë me shtimin në fe, me teprimin në atë që feja nuk ia kërkon.

Kjo është metodologjia që përdor shejtani në thirrjen e tij, ashtu siç na ka paralajmëruar Allahu i Madhëruar:

وَلَا تَتَّبِعُوا خُطُوَاتِ الشَّيْطَانِ ۚ إِنَّهُ لَكُمْ عَدُوٌّ مُّبِينٌ

**"E mos ndiqni gjurmët (rrugët) e shejtanit, pse ai është armik juaj i hapët."**<sup>473</sup>

---

<sup>473</sup> Kur'ani, En'am: 142.

Shejtani orvatet, në fillim dalëngadalë, derisa ta arrijë qëllimin e tij. Ai hyn te të gjitha shtresat e njerëzve me mënyrën që u përshtatet atyre; hyn tek dijetari nga dera e diturisë dhe tek injoranti nga dera e injorancës.

Besimtari që e ka gjithmonë ndër mend Allahun, i cili tregohet i qëndrueshëm në rrugën e Tij, në përm-bushjen e të drejtave dhe detyrave që ka ndaj Allahut, jeton brenda mureve të cilat vazhdimisht e mbrojnë nga mendimet e liga, nga djajtë dhe cytjet e tyre. Buhariu ka transmetuar prej Aishes se i Dërguari i Allahut për çdo natë kur binte në shtrat, mbliidhte grushtet, frynte lehtë në to dhe thoshte suret Ihlas, Kul eudhu bi rabil-Felk, Kul eudhu bi rabi-Nas<sup>474</sup>, pastaj me dy pëllëmbët prekte sa të mundej trupin duke filluar prej kokës dhe fytyrës e më poshtë. Këtë e bënte tri herë<sup>475</sup>.

Falënderimet i takojnë Zotit të njerëzve, sundimtarit të njerëzve, të Adhuruarit të njerëzve, Ai është i vetmi që dhuron suksesin dhe me vullnetin dhe dashjen e tij përfundohen veprat e mira.

Allahun e lusim të na plotësojë begatitë e Tij, të na falë mëkatet tona, të cilat janë pengesë mes nesh dhe begative të Allahut, të na falë edhe gabimet që na

---

<sup>474</sup> D.m.th. ka thënë suret Ihlas, Felek dhe Nas.

<sup>475</sup> Buhariu, "Fet'hul – Bari", vëll. VIII, fq. 679.

kanë larguar nga meditimimi i fjalëve të Tij subhanehu ue teala.

Shpresojmë tek Madhëria e Tij të mos na privojë nga të mirat e Tij për shkak të veprave tona të liga. Nuk e humb shpresën nga mëshira e Allahut pos populli mosbesimtar.

Lavdërimi dhe shpëtimi qofshin mbi Pejgamberin tonë, familjen, shokët dhe mbi gjithë besimtarët që ecin sipas hapave të tij deri në Ditën e Gjykimit.

## LITERATURA E KONSULTUAR

- Sherif ef Ahmeti, *“Kur'ani - Përktim me komentim në gjuhën shqipe”*,
- Prof. Hasan I. Nahi *“Kur'ani i madhërisbëm”*, Prof. Hasan I. Nahi (Përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam).
- Ibn Kethir, *“Tefsir El-Kur'an El-adhim”*.
- El-Kurtubi, *“El-Xhami Liabkam El-Kur'an”*.
- Taberij, *“Xhami El-Bejan an teuil aje El-Kur'an”*.
- Xhelaludin Ahmed El-Mehalij dhe Xhelaludin Ahmed El-Sujuti, *“Tefsiru El-Xhelalejn”*.
- Imam El-Bagauij, *“Muhtesar Tefsir El-Bagauij”*, ose siç njihet *“Mealim Et-Nzil”*, Imam El-Bagauij.
- Muhamed Alij bin Muhamed E-sheukaniji, *“Fethu El-Kadir”*.
- Muhamed Emin bin Muhamed El-Muhtar Esh-Shenkitij, *“Ed'uau El-Bejan fij Ijdahi El-Kur'an bi El-Kur'an”*.
- Nasir Es-Sadijj, *“Tefsir El-Kerim Er-Rahman fi Tefsir Kelam El-Menan”*.
- Salih El-Uthejmin, *“Tefsir El-Kur'an El-Kerim Xhuzi Amme”*.
- Muhamed Sulejman El-Eshkar, *“El-Kur'ani El-Kerim ue bil Hamish Zubdet Et-Tefsir min Feth El-Kadir”*.
- Ebij Bekër El-Xhezairij. *“Ejser Et-Tefasir Likelam el-Alijj El-Kebir”*.
- Uehbe Ezuhejli, *“Et-Tefsir El-Munir”*.
- Dr. Aid El-Karni, *“Et-Tefsir El-Mujeser”*.
- Elvahidij, *“Esbabul En-Nuzul”*.

- Muhamed El-Gazali, *“Kommenti tematik i Kur'anit Famëlartë”*.
- Muhamed Fuad Abdul El-Bakij, *“Muxhem El-Mufehres Elfadh El-Kur'an El-Adhim”*.
- Sejd Kutb, *“Fi Dhilali-l Kur'an”*.
- Ebij El-Izi Eddimeshkijj, *“Sherh Akide Et-Tahauije”*.
- Ibn Kajim El-Xhevzijeh, *“Zadul Mead”*.
- Ibn Kajim El-Xhevzijeh, *“Feuaid”*.
- Emin Bahrami, *“Përkthimi dhe komentimi i el-istiadhes, el-besmeles dhe i suretul- Fatihasë”*.
- Mr. Qazim Qazimi, *“Gramatika e gjuhës arabe”*.
- Sylejman Tomçini, *“Fjalor Arabisht-Shqip”*.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, *“Fjalor i Shqipes së sotme”*.

## PËRMBAJTJA

FJALA E RECENSENTIT .....	5
HYRJE .....	8
KOMENTIMI I “EL-ISTIADHETU” DHE “BESMELE-S” .....	11
Sqarimi i fjalëve .....	11
Kuptimi i istiadhes.....	16
Përmendja e istiadhes në Kur'an .....	17
Prej dobive të istiadhes.....	19
Metodat mashtruese të shejtanit .....	22
Mënyra të tjera të istiadhes sipas haditheve autentike .....	23
Komentimi i “Besmele-s” .....	23
Sqarimi i fjalëve .....	24
Kuptimi i besmeles .....	27
Vlera e besmeles.....	28
Besmelja pëlqehet të thuhet në fillim të çdo pune.....	28
Leximi i besmeles në namaz.....	30
Shprehja e besmeles para therjes dhe gjuetisë.....	30
Besmelja para marrjes së abdestit .....	31
Disa raste ku thuhet besmelja .....	31
SURJA EL-FIL (ELEFANTI).....	32
Emërtimi .....	33

Shkaku i zbritjes.....	33
Kuptimi i ajeteve .....	39
SURJA KUREJSH (KUREJSHËT) .....	52
Emërtimi .....	53
Shkaku i zbritjes.....	54
Kuptimi i ajeteve .....	56
SURJA EL-MA'UN (NEVOJTARËT) .....	66
Shkaku i zbritjes.....	68
Kuptimi i ajeteve .....	69
SURJA EL-KEUTHER (TË MIRAT E SHUMTA).....	84
Emërtimi .....	85
Shkaku i zbritjes.....	85
Kuptimi i ajeteve .....	86
SURJA EL-KAFIRUN (JOBESIMTARËT) .....	101
Emërtimi .....	102
Shkaku i zbritjes.....	102
Kuptimi i ajeteve .....	103
SURJA EN-NASR (FITORJA) .....	112
Emërtimi .....	113
Shkaku i zbritjes.....	113
Koha e zbritjes .....	115
Kuptimi i ajeteve .....	117

SURJA EL-MESED (FLAKA) .....	129
Emërtimi .....	130
Shkaku i zbritjes.....	130
Kuptimi i ajeteve .....	131
SURJA EL-IHLAS (SINQERITETI).....	142
Emërtimi .....	142
Shkaku i zbritjes.....	143
Kuptimi i ajeteve .....	144
SURJA SURJA EL-FELEK (AGIMI).....	156
Emërtimi .....	157
Shkaku i zbritjes.....	157
Kuptimi i ajeteve .....	159
SURJA EN-NAS (NJERËZIT) .....	172
Emërtimi .....	173
Shkaku i zbritjes.....	173
Kuptimi i ajeteve .....	173
LITERATURA E KONSULTUAR .....	188